

Per scoprire le radici dell'albero genealogico bisogna essere muniti di conoscenza e coraggio, cose che a noi albanesi non mancano. «Le stelle non si vergognano di sembrare lucciole, ma anche le lucciole si onorano di sembrare stelle».

# RRËNJËT

## LE RADICI

GIORNALE INDIPENDENTE

Te zbuloshë rrenjet e trungut gjënetik patjetër duhet të jesh i paisur me dituri e kurajo, të cilat në shqiptare nuk na mungojnë. «Yjet nuk e kanë për turp të duken si xixellonja, por dhe xixellonjat e kanë për nder të duken si yjet».

✱ Anno 15  
✱ Numero 5  
✱ Dicembre 2017

✱ Mensile di attualità e cultura italo-albanese ✱  
Direttore editoriale: Hasan Aliaj

✱ Distribuzione gratuita in:  
Albania, Australia,  
Belgio, Canada, Germania,  
Grecia, Francia, Italia,  
Stati Uniti e Svizzera

## Note Epirotiche

Di ANTONIO BALDACI

Nel 1913-1914 la Conferenza degli Ambasciatori a Londra cercò di sistemare tutte le questioni che derivavano dalle guerre balcaniche. Evitando ogni discussione retrospettiva intorno all'andamento dei lavori di quella Conferenza, è anche superfluo discutere i compromessi che scaturirono in seguito alla Grande Guerra per l'assetto adriatico e per la costituzione dello Stato albanese.

La risultanza fu che il Patto di Londra nacque morto e i confini dell'Albania furono tracciati in mondo così obliquo che non rispondevano ad alcuna esigenza, perché attraversavano a capriccio laghi, bacini fluviali, creste e valichi, come se gli spartiacque non esistessero, cos che i diritti della Grande Albania, invocati dai patrioti albanesi e dal diritto delle genti vennero calpestati nel modo più clamoroso e vergognoso, ottenendosi soltanto quella piccola Albania attuale, che risulta un non senso di fronte alla realtà.

(segue a pagina 3)



## Shënime Epirotike


(Lexoni në faqen 3)

## Antichi culti Solari nella penisola Balcanica

Di RAFFAELE PETTAZZONI  
(Accademico d'Italia)

Molta acqua è passata sotto i ponti dell'Indo, dell'Iliss, e del Tevere da quando la "mitologia comparata", inteso il mito come una malattia del linguaggio, si era illusa di poter ricostruire, a forza di etimologie e di "nomina agentis", il primitivo patrimonio ideale dei popoli indoeuropei, riducendo la mitologia indiana (vedica), la greca e l'italica ad una larga, possente, ma univoca sinfonia sopra pochi motivi fondamentali, o piuttosto variazioni di un unico grande tema: il Sole

(segue a pagina 4)



## Poezi, skica dhe tregime nga:

XHEVAHIR SPAHIU, LINA LURASCHI, VASO PAPAJ HAMIT ALIAJ, ARBEN KURTESHI, MYRTEZA MARA, FESTIM LITI, ANA BISHOLLA, IZMIT M IMERI, REMZI LIMANI, SETI PEZAKU VLADI, STELO SOKO, NIKOLLE LOKA, VANGJELIA VERORI(MEHMETAJ), NIKOLIN SH. LËMEZHI, ARJAN TH. KALLÇO, ALEKSANDËR ÇIPA, LAURETA PETOSHATI, NIKOLIN SH. LËMEZHI, HYDA ISMAILI, VULLNET MATO, SOKRAT HABILAJ, KELA BILBILI, MUSA JUPOLLI, ZEF MULAJ, ANILA TOTO, ZIHNI NDREGJONI, LUAN RAMA, PERPARIM HYSI, THEODHORI PROKO, IRMA KURTI, NDUE LAZRI, OLTJONA SELAMAJ, SKËNDER LAZAJ, ZHANETA LAZRI, RAKELA ZOQA, MIMOZA ÇEKIÇI RISTA, ILJAZ BOBAJ, NASE JANI, TEUTA HAZIRI, BARDHA MANCE, JOSIF GEGPRIFTI, ASTRIT BLLACA, LUMO KOLLESHI, SHEFIK ARIFI, AGIM BULGARECI, KRISTAQ TURTULLI, LUAN CIPI, KUJTIM AGALLIU, KOSTAQ DUKA, GENC DEMIRAJ, SKËNDER KAMBERI

## Le origini di San Dana dalla scomparsa di Vereto

Di ANTONIO BIASCO

Le vicende di un paesino non appartengono esclusivamente a questo, non sono indipendenti dall'ambito in cui si trova. Ogni suo sviluppo, ogni suo moto, sono correlativi all'itinerario storico della zona da cui dipende; il suo evolversi e armonicamente inserito nello svolgimento della realtà storica dell'ambiente di cui fa parte. Per

studiare un momento di scoria del nostro paesino, quello quale che corrisponde alle sue origini, bisogna tener presente il contemporaneo momento del Capo di Leuca, alla cui vita questo paesino è intimamente legato in comuni travagli, comuni aspirazioni, esperienze. Questa estrema parte d'Italia, lambita dalle onde dello stesso mare che fu solcato dai pionieri della civiltà, accolse in se il magnifico operato dell'uomo sin dai tempi pia remoti.

(segue a pagina 5)

## Ekspozita 105-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë në Muzeun Historik Kombëtar

Nga Dr. DORIAN KOÇI  
Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar

Më 28 nëntor 2017, në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar u çel ekspozita "105-vjetori i shpalljes së Pavarësisë", e cila u organizua nga Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Qendrën Mbarëkombëtare të

Koleksionistëve të Shqipërisë. Objekti kryesor i kësaj ekspozite tematike ishte pena, me të cilën është nënshkruar Akti i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ndonëse është një objekt i vogël pena ka një rëndësi mjaft të madhe për historinë e shqiptarëve.

(Vijon në faqen 10)

## Scoperto anno di nascita del poeta albanese sangiorgese Giulio Variboba

Di COSMO LUDONE

La ricerca dello scrittore - giornalista Cosmo Laudone, arbereshe di San Giorgio Albanese in provincia di Cosenza, non finisce mai di stupire. Presidente emerito della pro

loco sangiorgese "Jul Variboba", nonché autore di decine di pubblicazioni, il Cavaliere dell'Ordine al Merito della Repubblica Italiana, Cosmo Laudone, ha rintracciato importanti fonti documentali presso archivi pubblici e privati sulla comunità di appartenenza.

(segue a pagina 13)

### NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

- Dardania e pazbuluar
- Udhëtim në Karaburun – Gjuhën e Zezë
- Kontributi i Teologut Theofan Popa në shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtarë
- Në Muzeun Historik Kombëtar çelet ekspozita "Unë jam shqiptar"
- Disidencë në kohën e Visarit
- Unë jam nga Shqipëria
- Në qendër të Maceratës mësohet gjuha shqipe
- Toka e djegur, shpirti i përvëlur...
- Një libër poemë për Prishtinën
- Historia e priftit shqiptar At Stath Melani dhe komandant çete
- In memoriam për specialistin në mjekësi, Adrian Abazaj nga Vlora
- Një lutje të dëshpëruar Nënë Terezës!
- Zbulohet viti i lindjes së poetit me origjinë shqiptare "Sangiorgiorgese" Giulio Variboba
- Pena të arta franceze për shqiptarët
- Beteja e Backes si Beteja e "Termopileve"
- Nuk ka një treg të mirëfilltë arti të strukturuar apo kodifikuar
- Ullinjët e Beratit në Uells
- I pelasgi e la loro lingua
- Pellazgët dhe gjuha e tyre
- Për mësuesit-mesazh i mrekullushëm
- Fjala e Lamtumirës për Aleksandër Lalon
- Flamuri dhe stema arbërore
- Krijimtaria e shkrimtarit Ramazan Hushi dhe qyteti i Kavajës
- "Kongresi i Manastirit, ngjarje përcaktuese në rrugëtimin shqiptar "Një komb-një gjuhë"
- KONGRESI 3<sup>o</sup> NDËRKOMBËTAR I MJEKËSISË, AKTIVITET SHKENCOR MULTIDISCIPLINOR I SPITALIT AMERIKAN
- Guri i vendlindjes

2018



Redaksia e gazetës "Rrënjët" ju uron Gëzuar Krishtlindjen e lumturi në Vitin e Ri 2018!  
Redazione di giornale "Le radici" vi augura Buon Natale e Felice Anno Nuovo 2018!

Nga **FATBARDHA DEMI**

*E vërteta asnjëherë nuk mund të zbresë në nivelin e atij që e kërkon, përkundrazi për ta marrë, i takon kërkuesit të ngjitet në nivelin që ajo gjendet. Rruga më e mirë për të përcjellë një të vërtetë është një lloj komunikimi që i kapercen kufijt e fjales : është të kuptuarit intuitiv. (Helena Balvatsky)*

### DARDANIA EMËR PARAHISTORIK?

Emri Dardania është fjalë e përbërë, nga rrënja *dard* + *an* (ia), ku "*an*" nuk është mbarese por fjalë që dëshmon së nga vjen (psh- jam nga këto anë ; shkrodran, lezhian etj). Fjala "*dard*" gjendet në fjalorin e sotëm të shqipëtarëve (2002, internet), vetëm në formën e fjalës "*dardallë*" për një shkop të gjatë, të përdorur në peshkim. Duke e zgjeruar hapësirën gjeografike edhe në travat e banuara nga fiset pellazge të lashtësisë, fjalën "*dard*" e gjejmë :

Dard - në gjuhën katalane (Spanjë) - shigjetë.

Dardo - në gjuhën spanjolle (Spanjë) - shigjetë

Dardu - në gjuhën korse (Korsika) - shigjetë

Dard- në gjuhën franceze - shigjetë apo heshtë druri me majë hekur.

Dardar - si ndajfolje në gjuhën franceze - shumë shpejt, pa kthim.


Dar-dar - shigjetë, në fjalorin e fiseve në Tibet dhe kjo ka arësytën e vet që do trajtohet më vonë.

Këto të dhëna dëshmojnë se fjala « *dard* » emëron shigjetën apo heshtën . Nuk mund të themi se kjo fjalë nuk ka qënë edhe në gjuhën tonë, sepse Fjalori i botuar i gjuhës shqipe nuk përfshin të gjithë leksikon dialektor (gegë dhe tosk), e sidomos atë të vjetër, as atë të shqipëtarëve në trevat autoktone, të arbëreshëve të Italisë dhe kolonive shqiptare, ku janë ruajtur shumë fjalë të lashta. Megjithatë, ne kemi mundësi ta vërtetojmë origjinën arbërore të fjalës « *dardë* = shigjetë/ heshtë » me mjete të tjera : nëpërmjet BESIMIT dhe HISTORISË. Sipas Petro Zhejit (Shqipja dhe sanskritishtja) "Gjuhët e para kanë qënë simbolike. Duke qënë kështu, ne me të drejtë e kërkojmë shpjegimin e fundit të një fjale, jo tek një koncept, por tek një simbol". Të nisur nga ky fakt, ne do të nisim gjurmimin në periudhën më të hershme të historisë, në kohën kur u krijua gjuha dhe do të vërejmë rolin besimtar që zinte shigjeta tek ta.

Gjurmët më të hershme të përdorimit të harkut me shigjeta i përkasin kohës së Paleolitikut të hershëm (nga 120.000 deri në vitet 20.000). Studiuesi nga Presheva, Ibrahim Kelmendi (Prej miteve deri në Butmir) pohon se kultura më e vjetër e Europës mendohet të ketë qënë kultura Vinka, qëndra e së cilës përfshinte hapësirën prej Thesalisë deri në Pruth, Starçevo , duke u përhapur më vonë në të gjitha anët e Europës. Në vitin 1866 A. Arcelin dhe A. Ducrost, zbuluan një shpellë të Niaux de Ariège (France) në vizatimet e së cilës janë pasqyruar shumë shigjeta.

Në fig.1 duken qartë dy shigjeta mbi trupin e bizontit. Në fig.2 vërehet se shigjeta përdorej nga njeriu primitiv i kulturës Vinka me një kuptim të caktuar. Çuditërisht pamja grafike e shigjetës së njeriut të shpellave është pothuajse e njëjtë me atë të shekullit 21. Megjithatë, kanë një dallim jashtzakonisht të madh midis tyre. Shigjeta e jonë është "një mjet" që e kemi trashëguar dhe

# Dardania e pazbuluar



a) Niaux de Ariège (Carsac, Dordogne) b- vizatime në objektet arkeologjike të kulturës Vinka. (29)

e përdorim për të trëguar drejtimin, ndërsa ajo e stërgjyshërve tanë të shpellave është prodhim original i një botkuptimi zanafillor praktik, filozofik dhe besimtar (simbolik). George Dumézil (La religione romana arcaica Miti, leggende, realta) duke folur për besimin e romakëve , pohon se idea e "shpirtit" në zanafill, nuk lidhet me vdekjen, por me "energjinë - magjike" të përjetëshme tek sendet. Njëriu primitiv habetej se si shigjeta mund "të fluturonte dhe të vriste " dhe i shikonte këto veti si shprehje e "shpirtit" hyjnor të saj . Fakti që shigjeta "e ndihmonte dhe e mbronte", mendon E.Cassirer (Sprache und Mythos) ishte origjina nga buroi më vonë idea e Zotit. Ky fakt dëshmohet në studimet e bëra mbi shoqëritë e lashta. G. Dumézil pohon se përpara se të bëhej Marsi Perëndi e luftës, adhurohej kultu i heshtës dhe kur vendosej ndonjë marrëveshje, betimi bëhej mbi të.

Rëndësia e veçantë e shigjetës dhe heshtës, për bashkësitë fisnore dhe mbretëritë, diktohej nga fakti se, që nga periudha e gurit e deri në kohën kur filluan të përdoren armët e zjarrit (shk 12-të, Dinastia Song), ishte ARMA kryesore goditëse në largësi, gjatë gjuetisë dhe luftimeve. Sidomos me zbulimin e metaleve, shigjeta dhe heshta u bënë mjete më praktike se sa gurët apo topuzët prej druri, të përdorura në zanafill. Sipas Homerit, armatimi kryesor i Grekëve në kohët e fundit ka qënë heshta së cilës në kohët heroike i vendosej një kokë metalike. (Hom. Il. 2; v. 320; Eustath.). Duhet vënë në dukje se ngjarjet dhe emërtimet pellazge të lashtësisë, shkruesit latinë në Fjalorët historik, i kanë emërtuar "greke". Rënditem këtë biografi të shkurtër të shigjetës, për të kuptuar vëndin shumë të rëndësishëm që ka zënë në besimin e lashtë dhe arësytën, se përse mbretërit

përdorur këtu si simbol besimtar dhe fustanella shqipëtare, tregon përkatsinë fisnore dardane . Historiani latin i shk 3 p.K, Marcus Junianus Justinus në veprën e tij (Epitome of Pompeius Trogus) shkruan :» Dakët janë pasardhës të Getëve". Constantin C. Giurescu (Formarea populului român.) duke u mbështetur tek trashëgimia gjuhësore, pohon se "Ata (Dakët dhe Gjetët) janë dy emra të të njëjtit popull [...] të ndarë në një numër të madh fisesh". Që Gjetodakët janë fise dardane e dëshmon edhe qeshja në monedhën e prodhuar në Daki.(fig.2 lartë) Përdorimi i emrit "dakë" dhe përfshirja e të gjitha fiseve veriore ballkanike nën emrin "ilir", besoj se është pasojë e administratës romake , e cile donte ta fshinte emrimin "dardan" nga dokumentet e tyre , për telashtet e mëdha që u kishin shkakuar këto fise , sidomos nën udhëheqjen e Burebistrës. Faktet e mësipërme mbi emrin "dard =shigjetë", mbështeten edhe nga mitet, sipas të cilave, shpikës i harkut mbahet Apolloni Ipeboreal figura e të cilit lidhet me vëndin e Ipeborealëve, që sipas përshkrimit të Strabonit (Gjeografia, 11, 6, 2), ndodhet pikërisht në zonën gjeografike të Dardanisë së lashtë . Për të mbështetur mendimin tonë për emrin e Mbretit- shigjetë (Dard), që krijoi bashkësinë e parë të organizuar të fiseve dhe të prftërinjve fat-thënës, emrin e të cilit e trashëgoi krahina e Dardanisë dhe shqipëtarët e Kosovës, do të lidhim disa fakte të zbuluara në fushën e historisë, gjuhësisë dhe miteve më të hershme.

(vazhdon ne numrin e ardhshem)



a- Mbretëria e mbretit dardan Burebistra ; b- Monedha Trajane në Dakinë romake 107 p.K.

Në tempujt kushtuar shigjetës, zhvilloheshin rite të ndryshme si psh në rastet e vdekjes së mbretit apo familjarëve të tij. Romuli betohej për heshtën e tij.

Në të gjitha besimet e lashta, shigjeta ishte arma me të cilën Perënditë dënonin njerëzit, si Zeusi dodonas, Athina, Artemisi, Apolloni, Rudra indiane, perëndia egjiptiane Sikhmet, etj . Sipas shkrimeve të Kuranit (V.3) në Babiloninë e lashtë, shigjeta përdorej nga orakujt për të parashikuar fatin dhe ishte simbol i pushtetit dhe mbretërimin. Në fig.1, (poshtë) shigjeta në gurvarr është përdorur pikërisht si simbol besimtar . Trekëndëshi, gjysëm-hëna dhe ylli brënda saj në formën e tophit, dëshmojnë besimin hënor të Kartaginasve. Poshtë është Perëndesha hënore Tanit.

më të fuqishëm të mitologjisë, e kanë patur kultin apo emrin e saj dhe është nderuar si Perëndi.

Sipas Mircea Eliadës: "Emrat e shumë popujve në lashtësi ishin të perëndive të tyre" . Më qënëse "dardha" nuk ka patur ndonjë kult, nxjerrim pëfundimin së emri Dardania dhe i dardanëve i pohuar nga Straboni, e ka origjinën nga emri i Mbretit Shigjetë (Dard) dhe ishte Orakulli i Zotit në atë vënd. Hahni e pohoi këtë fakt , si nga ana gjuhësore edhe mitike dhe nuk e kuptoj se, përse e lidhi emrin e Dardanisë dhe banorëve të saj me pemën e dardhës. Në veprën e tij "Studime shqipëtare" Hahni shkruan : "Jemi të mendimit që kuptimi i vërtetë i emrave të fiseve të sigunëve (Herodoti, V,9) dardanasve , kuretëve, kuiritëve, samnitëve dhe sabinëve vjen nga arma kryesore e tyre. Kjo fjalë (Dard-an) nga tingulli i ngjan fjalës italiane, spanjolle « *dard* » dhe angleze « *dart* » : « heshtë ».

Një fakt tjetër është emri Gjetë, i një prej fiseve dardano-iliere. Ky emër, sikurse edhe i shumë emërtimeve të fiseve të gadishullit Pellazgik, gjen kuptimin vetëm në gjuhën shqipe dhe është forma e shkurtuar e emrit "shigjetë". "Armët më të preferuara të Herkulit, ashtu si tek Gjetët, ishin harku dhe shigjetat- pohon studiuesi francez Eduard Shnajder- Gjet vjen nga "shgjet", që në shqip bën shigjet, prandaj ato popuj (skithët dhe gjetët-shën im) ishin pellazg". Kur flasim për fiset e Gjetëve, këtu futen edhe fiset Dake.

Gur-varrë ilire në Bosnjë . Simboli i zik-zakut, i rrethit dhe dora , dëshmojnë besimin hënor të popullsisë. Harku me shigjetë (djathtas lart), i



a-Gur varri e Kartagenjës (British Museum) shk 2-1 p.K.; b-Kopia romake e Pallade Athinës; c- Amuletë argjendi me figurën e majës së shigjetës shk 5-3p.K.; d- maja të heshtave të kohës së luftës trojane. (36)



Mensile di attualità e cultura  
italo-albanese  
Anno 15 = Numero 5 = Dicembre 2017

Direttore editoriale: Hasan Aliaj  
Sede operativa presso: Hasan Aliaj  
via Filippo Coridoni 23, 00046  
Grottaferrata (Roma) Tel. +39/333591236  
Hasan.ali@tiscali.it  
Redazione: rrenjet@yahoo.com  
editoriarrenjet@hotmail.it  
Capo Redattore: Andrea Llukani

Hanno collaborato: Antonio Biasco, Aulona  
Arapi, Ylli Polovina, Ana Biscolla, Gezim  
Llojdia, Maria Teresa Carnevali, Saimir Ljola,  
Gezim Alpion, Vitore Stefa Leka  
Traduttrice: Edi Xhyheri, Ana Bisholla  
Direttore responsabile: Massimo Marciano  
Proprietario ed editore: Università Popolare dei  
Castelli Romani

Direzione, redazione e amministrazione: via Cavour n.  
21, 00044  
Frascati (Roma). Tel. 0689012752, fax  
0662276721, e  
-mail mediaservice@massimomarciano.it  
Registrazione del Tribunale civile di Velletri n.  
11/2003 del 25/6/2003  
Përkujdesja grafike: Bujar Karoshi  
Tel. 00355 4 22 33 283 / 00355 69 20 68 603

# Shënime Epirotike *Note Epirotiche*

Nga ANTONIO BALDACI

Në vitet 1913-1914, Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, u përpoq të sitemojë të gjitha çështjet që kishin prejardhje nga luftërat ballkanike. Duke iu shmangur çdo diskutimi retrospektiv në lidhje me zhvillimin e punimeve të asaj Konference, është edhe e kotë të diskutohen kompromiset që buruan në vijim të Luftës së Madhe për qëndrimin adriatik dhe për kushtetutën e Shtetit shqiptar.

Rezultati që se Marrëveshja e Londrës lindi e vdekur dhe kufijtë e Shqipërisë u skicuan në një mënyrë kaq të shtrembër, sa që nuk i përgjigjeshin asnjë nevojë, sepse përshkonin sipas mendjes së tyre liqenet, pellgjet lumore, kreshta dhe kalime, sikurse ujëndarëset të mos ekzistonin, kështu që, të drejtat e Shqipërisë së Madhe, të kërkuara nga patriotët shqiptarë dhe nga të drejtat e popujve, u shtypën në mënyrën më të bujshme dhe të turpshme, duke nxjerrë vetëm atë Shqipërinë e vogël aktuale, që rezultoi pa kuptim përballë realitetit.

Në çdo drejtim dhe në çdo kuptim duken sot mospërputhje të dënueshme, të kryera kryesisht nga Franca dhe nga Anglia në dëm të kombësisë së vogël shqiptare. Konstatimet që mund të bëhen për këto krime etnike janë të dukshme gjithkund, qoftë ndaj Jugosllavisë, qoftë ndaj Greqisë, ku masat shqiptare të shpëputura nga Mëmëdheu, bëhen, të mbledhura së bashku pothuajse sa trefishi i popullsisë së Mbretërisë së Shqipërisë.

Në jugun e Shqipërisë politike krahina e mbajtur prej Greqëve, që përbente pjesën më të madhe të "vilajetit" të vjetër turk të Janinës dhe që përfaqëson më shumë se dy të tretat e Epirit, popullohet nga një shumicë shqiptarësh, që nën sundimin e Gjysmëhënës vazhdonin të mbanin të gjallë e të fortë kombësinë e tyre. Edhe sot, megjithë shpërbërëzimin me detyrim që e ka bërë propaganda greke, gjithë vendi përshkohet nga Kallamata (Tiamis) në Perëndim të Janinës drejt detit, është i zënë nga masa të konsidereshme shqiptarësh që kanë treguar kundër çdo fyerjeje të jashtme se t'i qëndrojnë besnikë rracës së tyre. Edhe në atë pjesë, kufiri i Shqipërisë aktuale, ndërsa nuk i qëndron çfarëdolloji prove as nga një këndvështrim gjeografik, as nga ai etnik, bie ndesh, sidoqoftë, edhe në aspektin administrativ, ekonomik, politik dhe ushtarak, në çdo kuptim, qoftë ndaj Jugosllavisë, qoftë ndaj Greqisë. Në Shqipërinë e Jugut, kufijtë e Kazasë së vjetër turke të Korçës, që do të duhej të përbënin kufirin shqiptar, u ndryshuan me detyrim: nga Grami deri tek gjiri i Ftelisë, kufiri prej kompromisi, i studiuar nga Komisioni i vitit 1913, u detyrua të lërë krejtësisht pasdore ndarjet administrative. Për të cituar një shembull, periferia e madhe e Konispolit, që sundon nga lart mbi kanalin e Korfuzit, është i ndarë nga deti, që menjëherë është më poshtë, nga një kufi jo i natyreshëm. Duke kujtuar Komisionin e viteve 1922-1926, për caktimin e kufijve shqiptarë, dhe duke i dhënë meritën se është përpjekur gjithmonë t'i u lërë zonave të banuara afër një frymëmarrje të vazhdueshme për të nxjerrë ushqime dhe për t'u lejuar fshatarëve të paktën përdorimin e fushave të domosdoshme për mbajtjen e tyre, brenda shtetit ku bëjnë pjesë rezultatet e liga, që ngatërresat diplomatike i krijuan, bënë që në Shqipëri të caktohet një kufi i zi, si ai ekzistues mes Bullgarisë dhe Jugosllavisë, me fjalë të tjera, një kufi andej të cilit dhe këndeje të cilit ishte e pamundur që të mund të jetohej pa guerilje sapo ndonjë re më e dendur do të mund ta errësonte qiellin që kurrë nuk kishte paqe. Në lidhje me këtë, qeveria shqiptare, për të mbrojtur aspiratat e saj të drejta kombëtare (në tratatet e paqes, Franca dhe Anglia, caktojnë që t'i njihet Shqipërisë vetëm një e treta e bazës së saj etnike), ishte përpjekur, qoftë edhe "pro forma", që ta mbajë të hapur udhën për të ardhmen. E kështu, megjithëse Dibra, Kosova dhe nënprefektura e Çamërisë gjendeshin jashtë Shtetit, u mbajtën idealisht me qëllime nacionaliste Prefekturat shqiptare të Dibrës dhe të Kosovës dhe Nënprefektura e Çamërisë. Natyrisht, kundër këtyre dimostrimeve, u ngritën me dhunë aspiratat jugosllave dhe greke, të cilat, në kompleksin e tyre, po të ishin realizuar, do ta



kishin shtypur krejtësisht Shtetin shqiptar dhe do ta kishin katandisur në atë organizëm mikroskopik që qe propozuar në fillim nga Franca, nga Anglia dhe nga Rusia. Ai mezi do të kishte zënë rajonin e Durrësit dhe të Tiranës dhe kjo që të mbaheshin të gjalla dhe të plotësoshin aspiratat e Greqisë që ishte çuar peshë deri më sot për një linjë që kalon përgjatë Vjosës deri përtej Këlcyrës, ku do të ishte drejtuar për tek liqenet e Ohrit dhe të Prespës. Kjo linjë ishte sidoqoftë kufizuese sipas propagandas panhelenike, e cila kishte për synim që të arrinte në të djathtën e Shkumbinit për t'u takuar në të djathtën e atij lumi me Jugosllavinë. Nga ai këndvështrim ushtarak është e dukshme se, kushtet e Shtetit shqiptar, lidhur me sigurinë e tij përballë pushtesit, ishin shumë të vështira. Dalja nga Jugosllavia në Shkodër thjeshtësohej nga afërsia e menjëhershme e kufirit, kryesisht në Jug të liqenit. Vërshimi në zemër të Shqipërisë (kjo është vërtetuar edhe nga hyrja me dhunë e Zogut në prag të Krishtlindjes së vitit 1924, kur vërshoi me forcat jugosllave Brenda Shqipërisë dhe ia doli të shtie në dorë Shtetin) ishte bërë i lehtë përmes pellgjeve të Drinit të Bardhë dhe të Drinit të Zi, pjesët më malore të të cilëve gjendeshin në dorën jugosllave dhe janë larg nga Dibra në Tiranë për rreth 65 Km linjë ajrore. Edhe dalja jugosllave në Korçë ishte e lehtësuar në afërsi të kufirit pranë Shën Naumit, nga rruga e përshtatshme për mjete me rrotta Pogradeç-Korçë. Në lidhje me Greqinë e, d.m.th., me Epirin verior (duke pasur ajo në duart e saj kreun e një dege të Devollit) kishte mundësi me shumë lehtësi të zbriste nga Florina gjatë rrugës që çon në Korçë. Nga Janina, pastaj, ishte e mundur të synohej duke ndjekur luginat e Vjosës dhe të Zrinit, në Berat, në Vlorë e në bregun e Sarandës në vetë Vlorën, siç u bë tashmë me antartëj sapo qe formuar Shteti shqiptar. Ia vlen, ndër të tjera, të konstatohet se, në lidhje me Greqinë, meqenëse kufijtë e Shqipërisë arrinin në gjirin e Ftelias, ata copëtonin në ndonjë mënyrë njësinë e zotërimit helen të kanalit të Korfuzit në hyrjen e tij veriore; rëndësia e kësaj rrethane ishte, në fakt, e madhe, meqenëse pengonte që ai kanal të mund të bëhej që nga koha e paqes një bazë e pashqetësuar ofensive kundër Italisë, por nëse qëndronte e dukshme siguria jonë, me ndarjen e kanalit të Korfuzit në greko-shqiptar, kjo siguri humbiste me bazën që Helenët dhe miqtë e tyre mund të stabilizonin në labirintin e Ishujve Jonianë dhe mbi bregun epironik deri në hyrje të gjirit të Ambracias apo të Artës. Kjo është arsyeja kulminuese e politikës italiane, e cila kishte nevojë që Shqipëria të kishte edhe mushkëritë e saj detare me fuqi të plota, sa në veri, aq në jug, që të mos rrezikojë që të gjendet në mëshirën e armikut në atë të njëjtë det që me kaq xhelozzi qe mbajtur dhe ruajtur nga Venecia.

(Përkthet:Nikolin Sh. Lëmezhi)

Di ANTONIO BALDACI

Nel 1913-1914 la Conferenza degli Ambasciatori a Londra cercò di sistemare tutte le questioni che derivavano dalle guerre balcaniche. Evitando ogni discussione retrospettiva intorno all'andamento dei lavori di quella Conferenza, è anche superfluo discutere i compromessi che scaturirono in seguito alla Grande Guerra per l'assetto adriatico e per la costituzione dello Stato albanese.

La risultanza fu che il Patto di Londra nacque morto e i confini dell'Albania furono tracciati in mondo così obliquo che non rispondevano ad alcuna esigenza, perché attraversavano a capriccio laghi, bacini fluviali, creste e valichi, come se gli spartiacque non esistessero, cos che i diritti della Grande Albania, invocati dai patrioti albanesi e dal diritto delle genti vennero calpestati nel modo più clamoroso e vergognoso, ottenendosi soltanto quella piccola Albania attuale, che risulta un non senso di fronte alla realtà.

In ogni direzione e in ogni senso appaiono oggi le incongruenze deprecabili commesse specialmente dalla Francia e dall'Inghilterra a danno della piccola nazionalità albanese. Le constatazioni che si possono fare per questi delitti etnici sono evidenti dappertutto, sia verso la Jugoslavia, sia verso la Grecia, dove le masse schiappare avulse dalla madre patria, sommano, riunite insieme quasi al triplo della massa inclusa nel Regno d'Albania.

A mezzogiorno dell'Albania politica la regione tenuta dai Greci, che costituiva la più grande parte dell'antico "vilayet" turco di Jannina e rappresenta oltre i due terzi dell'Epiro, è abitata in maggioranza da Albanesi che sotto il dominio della Mezzaluna continuavano a tener viva e forte la loro nazionalità. Anche oggi, nonostante la forzata snazionalizzazione che ne ha fatto la propaganda greca, tutto il paese è attraversato dal Càlama (Thyamis) a ponente di Jannina verso il mare, è occupato da rilevanti masse albanesi che hanno dimostrato contro tutti gli insulti esteriori di volersi mantenere fedeli alla loro razza. Anche in quella parte il confine dell'Albania attuale mentre non regge a qualsiasi esame né dal punto di vista geografico, né da quello etnico, urta, dovunque, anche sotto l'aspetto amministrativo, economico, politico e militare, in ogni senso, sia verso la Jugoslavia, sia verso la Grecia. Nell'Albania meridionale i confini dell'antico cazà turco di Corcia, che avrebbe dovuto costituire la frontiera albanese, vennero forzatamente alterati: dal Grammo alla baia di Ftelia, il confine di compromesso, studiato dalla Commissione del 1913, dovette completamente trascurare le divisioni amministrative. Per citare un esempio, il grosso borgo di Conispoli, che domina dall'alto il canale di Corfù, è separato dal mare, immediatamente sottostante, da una frontiera innaturale. Venendo alla Commissione del 1922 - 26, per

la fissazione dei confini albanesi, e rendendole il merito di avere sempre cercato di lasciare agli abitati vicini un respiro sufficiente per procurarsi gli alimenti e consentire ai contadini almeno l'uso dei campi indispensabili al loro sostentamento, entro lo stato di cui fanno parte le risultanze inique, che i litigi diplomatici vennero a creare, portarono a fissare in Albania una frontiera nera, come quella esistente tra la Bulgaria e la Jugoslavia, ossia una frontiera al di là e al di qua della quale era impossibile poter vivere senza la guerriglia appena qualche nube più densa avesse oscurato il cielo mai tranquillo. In relazione a ciò il governo albanese per salvaguardare le sue giuste aspirazioni nazionali (nei trattati di pace la Francia e l'Inghilterra imposero di riconoscere all'Albania soltanto un terzo della sua consistenza etnica), aveva cercato, sia pure "pro forma", di tenersi aperta la via per il futuro. E così, benché il Dibrano, il Cossovo e la sottoprefettura della Ciàmide si trovassero fuori dello Stato vennero mantenute idealmente ai fini nazionalisti le Prefetture albanesi di Dibra e del Cossovo e la Sottoprefettura della Ciàmide. Beninteso, contro queste dimostrazioni, insorsero violenti le aspirazioni iugoslave e greche, le quali, nel loro complesso, se avessero potuto risolversi, avrebbero soppresso interamente lo Stato albanese e lo avrebbero ridotto a quel microscopico organismo che venne proposto inizialmente dalla Francia, dall'Inghilterra e dalla Russia. Esso avrebbe occupato allora appena la regione di Durazzo e di Tirana e ciò per mantenere vive e soddisfare le aspirazioni della Grecia che si era agitata fino a oggi per una linea svolgentesi lungo la Voiussa oltre Clissura, donde avrebbe dovuto volgere ai laghi di Ohrida e Prespa. Questa linea era tuttavia restrittiva per la propaganda panellenica, la quale intendeva di arrivare alla sinistra dello Shcumbi per incontrarsi sulla destra di quel fiume con la Jugoslavia. Da quel punto di vista militare è evidente che le condizioni dello Stato albanese rispetto alla sua sicurezza di fronte all'invasore erano assai difficili. Lo sbocco iugoslavo su Scutari veniva facilitato dalla immediata vicinanza del confine, soprattutto a Sud del lago. L'invasione nel cuore dell'Albania (ciò è dimostrato anche dall'irruzione dello Zog alla vigilia di Natale del 1924, quando irruppe con forze iugoslave dentro l'Albania e riuscì ad impossessarsi dello Stato) era resa facile attraverso i bacini del Drino Bianco e del Drino Nero, le cui parti più montane si trovavano in mano jugoslava e distano da Dibra a Tirana appena 65 Km in linea retta. Lo sbocco iugoslavo su Corcia era pure facilitato nella vicinanza del confine presso San Naum, dalla rotabile Pogradez - Corcia. Nei riguardi della grecia e quindi dell'Epiro settentrionale (avendo essa nelle sue mani la testata di un affluente del Devoli) poteva con ogni facilità scendere da Florina lungo la rotabile che conduce a Corcia. Da Jannina, poi, si poteva pure puntare seguendo le vallate della Voissa e dello Zrino, su Berat, su Vallona e sulla costa dei Santi Quaranta a Vallona stessa, come venne già fatto con gli antarti appena fu costituito lo Stato albanese. Giova peraltro constatare che, rispetto alla grecia, giungendo i confini albanesi alla baia di Ftelia, essi rompevano in qualche modo l'unità di possesso ellenico del canale di Corfù nel suo ingresso settentrionale; l'importanza di questa circostanza di fatto era grande, poiché impediva che quel canale potesse diventare sin dal tempo di pace un'indisturbata base offensiva contro l'Italia, ma se restava notevole la nostra sicurezza, con la divisione del canale di Corfù in greco-albanese, questa sicurezza veniva completamente a mancare con la base che i greci e i loro amici potevano stabilire nel dedalo delle isole Ionie e sulla costa epironica fino all'entrata del golfo di Ambracia o di Arta. Questo il motivo culminante della politica italiana, la quale aveva bisogno che l'Albania avesse anche i suoi polmoni marittimi in piena efficienza, tanto al nord, quanto al sud, per non correre il rischio di trovarsi alla mercé del nemico in quello stesso mare che fu tanto gelosamente tenuto e vigilato da Venezia.

# Kulte të lashta Diellore në gadishullin Ballkanik Antichi culti Solari nella penisola Balcanica

Nga RAFFAELE PETTAZZONI  
(Akademik i Italisë)

Shumë ujë ka kaluar nën urat e Indit, të Ilisit dhe të Teveres që kur “mitologjia krahasese”, pasi e ka kuptuar mitin si një sëmundje të gjuhës, ishte gënjyer se do të mund të rindëronte, duke u bazuar në mitologji dhe në “nomina agentis”, trashëgiminë ideale primitive të popujve indoevropianë, duke e kufizuar mitologjinë indiane (vedike), greke dhe italiane në një sinfonie të gjerë, të fuqishme, por të njëkuptimshme mbi pak motive themelore, ose më mirë variacione të një teme të madhe të vetme: Dielli.

Sot çështja paraqitet në një mënyrë krejtësisht tjetër: jo në planin e njësisë së postular proto indoevropiane, por në historinë fetare të popujve indoevropianë të marrë veç e veç, dhe jo aq si problem mitologjik (mite diellore) sa si problem historiko-fetar (kulti i Diellit).

Reagimi i shkollave të reja historike kundër diellimit të Max Muller triumfoi mbi të gjithë linjën. Sot sapo ka filluar të ndihet se ajo mbase ka shkuar përtej shenjës.


Në fenë romake kulti i Diellit (dhe i Hënës), sipas G. Wissowa, nuk zë fill në fazat më të lashta. Përkundrazi, Dielli kishte një tempull në Quirinale si “Sol Indiges” (Dielli që lind – shënim i përkthyesit); por kjo nuk vlen për të provuar se ai ishte një prej hyjnive vendase të fesë tejet antike. Tradita, (Varrone, “De lingua, V. 74”), ia lë futjen e kultit të Diellit (dhe të Hënës) në Romë sabinasit Tito Tazio; por të dhënat më të vjetra i përkasin shekullit III dhe II para K., dhe zbulojnë ndikimin grek, ashtu sikurse pastaj në epokën perandorake, edhe kultet diellore të Lindjes që patën përparësi në Romë, derisa morën jo vetëm pranimin zyrtar, por lartësimin e Diellit si Zoti më i lartë i Shtetit (Aureliani). Teza e Wissowa-s kundërshohet rrënjësisht në punimin e C. Koch, Gestirverehrung in altem Italien: Sol Indiges und der di indigetes, Frankfurt, 1993.

Kur në botën greke, është një fakt – shkruan M. P. Nilsson – që “Dielli dhe Hëna nuk kishin pothuajse kurrfarë kulti në epokën e Greqisë së lashtë e në atë klasike, me përjashtim të Elios dhe Rodit, me dyshimin se kanë një zanafilë të huaj”. Aristofani në veprën “Paqe” (rreth vitit 406 e në vijim) ua lë Grekëve kultin e Hyjnive Olimpikë, ndërsa kultin e Diellit dhe të Hënës ua lë Barbarëve, duke nënkuptuar, siç rezultojnë nga shënimi, Persianët. Edhe Platoni në “Cratylo” (fq. 397), bën që Sokrati të thotë: “Më duket se njerëzit e parë që zunë vend në Greqi nuk kishin hyjni (perëndi) të tjera përveç atyre që aktualisht besohen në tillë prej Barbarëve, ashtu si dielli dhe hëna dhe toka dhe yjet dhe qielli”. Edhe këta “Barbarë” (në kuptimin e vërtetë të popujve që nuk i përkasinin gjuhës greke) ka gjasë të ishin Persianët, feja e të cilëve përshkruhet nga Herodoti (I, 131) në këtë mënyrë: “(Persianët) Nuk besojnë që perënditë të kenë formë njerëzore, siç mendojnë Grekët: (Persianët) kanë për traditë t’i flijojnë “Zeusit” (domethënë, hyjit të tyre supreme që në greqisht korrispondon me Zeus) mbi majat më të larta të maleve, duke e quajtur “Zeus” tërë kupën qiellore, e në të njëjtën mënyrë i flijojnë diellit, hënës, tokës, zjarrit, ujit dhe erërave”.

Por, “Barbarë” adhuroes të Diellit nuk kishte vetëm në Azi: kishte edhe në Evropë, dhe pikërisht ndër fqinjët më të afërt të Grekëve nga ana e veriut, dua të them mes popujve të gadishullit ballkanik, që jo vetëm gjeografikisht kufizoheshin me Grekët, por në kohën e Platonit kishin hyrë tashmë pak a shumë në orbitën e qytetërimit grek dhe të historisë greke.

## PEONËT (ILIRËT)

Maksimi i Tirit, filozof platonik – ose më mirë sofist eklektik – i epokës së Antoninëve, në një kompozim të titulluar “Nëse duhet t’u ndërtojme statuja hyjnive”, na bën të dimë se Peonët adhurorin Diellin në formën anikonike të një disku të vogël i lartësuar mbi një purtekë të gjatë. Peonët kishin ngulur në krahinën malore mes Aksios (Vaedar) dhe Strymon (Struma), në Veri të Maqedonasve, duke pasur Ilirët në Perëndim dhe Trakasit në Lindje. Opinioni i G. Beloch, se ata janë Grekë, nuk ka pasur sukses. Peonët nga shumica konsiderohen si një popull i hershëm me origjinë ilire, i shtrirë në zanafilë edhe në jug (me degëzime, me sa duket, edhe në vetë Greqinë), pastaj i detyruar nga shtrirja e Maqedonasve të tkurret në selitë e tij historike. Edhe monedhat, të përdorura nga G. Svoronos, në shërbim të një teze që favorizon kërkesat politike të Greqisë në kohën e luftës botërore, përkundrazi, furnizojnë argumente për tezën ilire, për përputhjen e jashtëzakonshme (në peshë, në kompozimin metalik,



etj.) mes disave prej tyre dhe të atyre prej disa nga qytetet e Ilirisë (Damastion, Pelagia). Në monedhat e Lypepeios, mbreti i Peonisë, që qe aleat i Ilirëve dhe i Trakasve kundër Filipit të Maqedonisë, gjendet shpesh koka me kurorën prej dafine e Apollit, hyji diellor i personifikuar. Në mënyrë të jashtëzakonshme ajo shoqërohet nga legjenda Derronaiois që me sa duket përmban emrin e hyjnisë (diellore) vendëse (Darron), e riprodhuar në “Interpretatio graeca” me Apollin. Po ashtu në mënyrë të ngjashme duhet të kuptohen Apolli Oteudanos dhe Eteudanikos me dy shkrime të gjetura në Peoni në territorin e Monastirit.

## MAQEDONASIT

Tregon Livio (XI, 21-22) që mbreti Filip i Maqedonisë u ngjiti (në vitin 181 para K.) me birin e vet Perseun në një majë të malit Haemo, jo sigurisht thjesht për një pasion alpinistik, por me qëllim strategjik, për të studiuar planin e një zbritjeje në Itali nga qafat alpine, nëse ishte e vërtetë që nga atje lart shikimi shtrihet, siç thuhej, nga Danubi tek Alpet e nga Deti i Zi deri në Adriatik. I zhgënjyer nga prijta e tij nga mjegulla që errësonte panoramën, mbreti zbriti me nxitim pasi kushtoi fli mbi dy altare, njëri kushtuar Jovit (Jupiterit) dhe tjetri Diellit.

Shtëpia mbretërore e Maqedonisë kishte prejardhje nga Perdika, themelues i mbretërisë në shekullin VII para K. Sipas një legjende, që i referohet Herodotit (VIII, 137), Perdika ishte vëllai më i vogël nga tre vëllezër që nga Iliria e nga Argu (Argu në Oristid pastaj i ngatërruar në traditë me Argun e Peleponezit) kishin kaluar, të arratisur, në tokën maqedonase, duke u vënë në shërbim, si roje bagëtitsh, tek “mbreti” i Lebijës. Dhe ndodhi që, ndërsa mbretëresha po gatuante bukën, ajo e Perdikes rritej çdo herë dyfish: I frikësuar nga ky prestigj dhe parashikues, mbreti i dëbon tre vëllezërit. Ata kërkojnë t’u rrogën për të cilën kishin bërë marrëveshje. Mbreti ua mohon, dhe duke drejtuar gishtin nga dielli që në atë moment po hynte me rrezet e tij në shtëpi nga çatia, thotë: “Kjo është paga që meritonit!”. Kësaj Perdika i përgjigjet: “Dhe ne e Pranojmë!”, dhe me një thikë që rastësisht e kishte në dorë shënoi në terren rrethin e diellit (vjen në mendje disku diellor i adhuruar nga Peonët), pastaj për tri herë futet në gjurin “e atij dielli” të vizatuar në tokë dhe largohet me vëllezërit. Veprimi që në pamje të jashtme ka karakter magjik, merr plotësisht efektin e tij, sepse kur Perdika zotëron gjithë Maqedoninë, bëhet edhe pronar i Lebijës. Legjenda dëshmon në mënyrë jo të drejtpërdrejtë për një kult të lashtë të diellit që ekzistonte tek Maqedonasit, dhe më saktësisht në klasën sunduese.

## TRAKËT

Trakët ishin adhuroes të Diellit. Sofokliu, në një tragjedi që nuk na ka mbërritur, Tereusi, vë në gojë të Orfeut këtë klithmë: “O Diell, yll tejet i nderuar për Trakët dashuroes të kuajve!”. Orfeu është, në fakt, një trak. Sipas një miti të dramaturgëve në një tragjedi, edhe ajo e humbur, e Eskilit – Basaridet -, Orfeu, zgjohej natën për t’u ngjitur përpara agimit në majë të Pangeut që të përshëndesë diellin në shfaqjen e tij të

(Vijon numrin e ardhshëm)

Di RAFFAELE PETTAZZONI

(Accademico d'Italia)

Molta acqua è passata sotto i ponti dell’Indo, dell’Iliss, e del Tevere da quando la “mitologia comparata”, inteso il mito come una malattia del linguaggio, si era illusa di poter ricostruire, a forza di etimologie e di “nomina agentis”, il primitivo patrimonio ideale dei popoli indoeuropei, riducendo la mitologia indiana (vedica), la greca e l’italica ad una larga, possente, ma univoca sinfonia sopra pochi motivi fondamentali, o piuttosto variazioni di un unico grande tema: il Sole

Oggi il problema si pone in tutt’altro modo: non sul piano della postulata unità proto indeuropea, ma nella storia religiosa dei singoli popoli indoeuropei, e non tanto come problema mitologico (miti solari) quanto come problema storico-religioso (culto del Sole).

Le reazioni delle nuove scuole storiche contro il solarismo di Max Muller trionfò su tutta la linea. Appena oggi si comincia ad avvertire che essa è andata forse al di là del segno.

Nella religione romana il culto del Sole (e della Luna) secondo G. Wissowa non risalirebbe alla fase più antica. Il Sole aveva bensì un tempio sul Quirinale in qualità di “Sol Indiges”; ma ciò non varrebbe a provare che egli fosse uno dei di indigetes della religione antichissima. La tradizione (Varrone, “De lingua, V. 74) attribuisce la introduzione del culto del Sole (e della Luna) in Roma al sabino Tito Tazio; ma i dati più antichi sono del III e II sec. A. C., e rivelano l’influsso greco, come poi in epoca imperiale furono, a loro volta, i culti solari dell’Oriente che prevalsero in Roma, fino ad ottenere non solo il riconoscimento ufficiale, ma la esaltazione del Sole a Dio supremo dello stato (Aureliano). La tesi di Wissowa è radicalmente oppugnata nel lavoro di C. Koch, Gestirverehrung in altem Italien: Sol Indiges und der di indigetes, Francoforte, 1933.

Quando al mondo greco, è un fatto – scrive M. P. Nilsson – che “il Sole e la Luna non avevano quasi nessun culto nell’età greca arcaica e nella classica, ad eccezione di Elios a Rodi, a ragione sospettato di origine straniera”. Aristofane nella “Pace” (vers. 406 e sgg.) assegna ai Greci culto degli Dei Olimpici, il culto – invece – del Sole e della Luna ai Barbari, intendendo – come risulta dallo scholio – i Persiani. Anche Platone nel “Cratylo” (p. 397), fa dire a Socrate: “Mi sembra che i primi uomini stanziati in Grecia non avessero altri iddii se non quelli che attualmente sono creduti tali dai Barbari, come il sole e la luna e la terra e gli astri e il cielo”. Anche questi “Barbari” (nel senso genuino di popoli di lingua non greca) potrebbero essere i Persiani, la cui religione, la cui religione è da Erodoto (I, 131) caratterizzata nel modo seguente: “Non credono (i Persiani) che gli dei abbiano forma umana, come pensano i Greci: usano (i Persiani) fare sacrifici a “Zeus” (cioè al loro iddio supremo corrispondente al greco Zeus) su le più alte cime dei monti, chiamando “Zeus” la intera volta del cielo, e del pari sacrificano al sole, alla luna, alla terra, al fuoco, all’acqua e ai venti”.

Ma di “Barbari” adoratori del Sole non ce n’erano soltanto in Asia: ce n’erano anche in Europa, e proprio fra i vicini più prossimi dei Greci dalla parte

di settentrione, voglio dire fra i popoli della penisola balcanica, che non solo geograficamente confinavano coi Greci, ma al tempo di Platone erano già entrati più o meno nell’orbita della civiltà greca e della storia greca.

## PEONI (ILLIRI)

Massimo di Tiro, filosofo platonico – o piuttosto sofista eclettico – dell’epoca degli Antonini, in un componimento intitolato “Se si debbano erigere statue agli dèi”, ci fa sapere che i Peoni adoravano il Sole sotto la forma aniconica di un piccolo disco issato sopra una lunga pertica. I Peoni erano stanziati nella regione montuosa fra l’Axios (Vaedar) e lo Strymon (Struma), a Nord dei Macedoni, avendo gli Illiri ad occidente e i Traci a oriente. L’opinione di G. Beloch, che essi fossero etnicamente dei Greci, non ha avuto fortuna. I Peoni sono considerati dai più come un antico popolo di origine illirica, esteso originariamente anche a sud (con propaggini, a quanto pare, nella Grecia stessa), poi costretto dalla espansione dei Macedoni a restringersi nelle sue sedi storiche. Anche le monete, adottate da G. Svoronos in servizio di una tesi favorevole alle rivendicazioni politiche della Grecia al tempo della guerra mondiale, forniscono invece argomenti alla tesi illirica, per la straordinaria concordanza (nel peso, nella composizione metallica ecc.) fra alcune di esse e quelle di talune città dell’Illiria (Damastion, Pelagia). Nelle monete di Lypepeios re di Peonia, che fu alleato degli Illiri e dei traci contro Filippo di Macedonia, ricorre sovente la testa laureata di Apollo, dio solare per eccellenza. Eccezionalmente essa è accompagnata dalla leggenda Derronaiois che verosimilmente contiene il nome della divinità (solare) indigena (Darron), resa nella “Interpretatio graeca” con Apollo. Analogamente sarà da intendere l’Apollo Oteudanos ed Eteudanikos di due iscrizioni trovate in Peonia nel territorio di Monastir.

## MACEDONI

Racconta Livio (XI, 21- 22) che il re Filippo di Macedonia fece (nel 181 a. C. con suo figlio Perseo l’ascensione di una vetta del monte Haemo, non certo per pura passione alpinistica, ma a scopo strategico, per studiare il piano di una eventuale calata in Italia dai valichi alpini, se era vero che di lassù lo sguardo spaziava, come si diceva, dal Danubio alle Alpi e dal Mar Nero fino all’Adriatico. Deluso nella sua aspettativa per la nebbia che offuscava il panorama, il re discese in fretta dopo aver sacrificato su due altari, uno dedicato a Giove e l’altro al Sole.

La casa regnante di Macedonia discendeva da Perdicca, fondatore del regno nel secolo VII a. C.. Secondo una leggenda riferita ad Erodoto (VIII, 137), Perdicca era il minore di tre fratelli che dall’Illiria e da Argo (Argo nell’Orestide poi confuso nella tradizione con l’Argo del Peloponneso) erano passati, fuggiaschi, in terra macedone, mettendosi a servizio, come mandriani, presso il “re” di Lebaia. Ora avvenne che cuocendo la regina il pane, quello di Perdicca cresceva ogni volta del doppio: Intimorito da questo prestigio e presagio, il re scaccia i tre fratelli: Essi chiedono la mercede pattuita. Il re la nega, e indicando il sole che in quel momento entrava coi suoi raggi nella casa per l’apertura del tetto, dice: “Questa è la mercede che voi meritate”. Al che Perdicca risponde: “E noi l’Accettiamo”, e con un coltello che casualmente stava maneggiando traccia sul terreno il contorno del sole (viene in mente il disco solare adorato dai Peoni), indi per tre volte prende e si mette in seno “di quel sole” disegnato sul suolo e se ne va coi fratelli. L’operazione di manifesto carattere magico, ottiene pienamente il suo effetto, perché quando Perdicca si impadronisce di tutta la Macedonia diventa anche padrone di Lebaia. La leggenda testimonia indirettamente di un antico culto del sole esistente presso i Macedoni, e precisamente nella classe dominatrice.

## TRACI

I Traci erano adoratori del Sole. Sofocle in una tragedia che non ci è pervenuta, il Tereus, pone in bocca ad Orfeo questa invocazione: “O Sole, astro veneratissimo per Traci amanti di cavalli”. Orfeo è infatti un trace. Secondo un mito sceneggiato in una tragedia, anch’essa perduta, di Eschilo – Le Bassaridi -, Orfeo si svegliava di notte per salire avanti l’alba in cima al Pangeo a salutare il sole al suo primo apparire: per lui il Sole era la divinità suprema, e per ciò Dioniso lo punì facendolo squartare dalle Bassaridi.

(segue nel prossimo numero)

# Origjina e Shën Danaktit nga zhdukja e Vereto-s

## Le origini di San Dana dalla scomparsa di Vereto

Nga ANTONIO BIASCO

Ngjarjet e vendit nuk i përkasin ekskluzivisht kësoj, nuk janë të pavarura në fushën në të cilën gjendet. Çdo zhvillim i saj, çdo moto e saj, janë të lidhura me itinerarin historik të zonës nga e cila varet; evolimi i saj është i përfshirë harmonikisht në zhvillimin e realitetit historik të ambientit ku bën pjesë. Për të studiuar një moment të historisë së vendit tonë, atë që i korrespondon origjinave të tij, duhet të kemi parasysh njëkohësisht Capo di Leuca, me jetën e të cilit rezulton shumë e lidhur në rrugëtime të përbashkëta, frymëzime të përbashkëta, eksperiencë. Kjo pjesë ekstreme e Italisë, e lagur nga dallgët e të njëjtët det që qe rrudhur nga pionierët e qytetërimit, mbledh në vetvete veprën e mrekullushme të njeriut që nga kohët më të lashta.

Vereto-Leuca ishte një qendër që ka rrezuar që nga antikiteti, dhe dokumentimet e njeriut antik janë të dukshme në çdo pjesë të zonës sonë. Kepi Iapigio, porti i parë duke ardhur nga Lindja, i kënduar nga poetët e lavdisë së pavdekshme (1), është kodra e shenjtë e feve të ndryshme, popujve të ndryshme, epokave të ndryshme, dhe akoma ruan, të papërdhosur bukurinë mistike të së shenjtës, nga mijëra vjet. Ngjyra e thellë e qiellit dhe e detit e permbledh në një mbështjellje që e mbron dhe e mban të virgjër, në një magji që është poezia. Dyndjet myslimane dhe fatet e reja të Lindjes, që ishin të mbyllura, gjithmonë, tokat tona, percaktojnë një fazë të re në historinë e Capo di Leuca.

Vereto ra viktimë e shkatërrimeve; banorët e mbijetuar marrin strehim në brendësi duke zgjedhur vendet më pjellore duke punuar pyjet e gjera dhe duke braktisur aktivitetin marinar. Pak familje, në grupe, nganjëherë, të drejtuar nga murgjit e arratisur nga Lindja, që këtu gjejnë shteg, përhapen nëpër Capo. E deri sa stuhija e furishme e grabitësve myslimanë nuk pushon të grabujë në rrënjë qendrat e bnimit të reja dhe të shumta, këto familje janë gjithmonë të impenjuara të spostohen. Shumë vende qenë të banuara në këtë periudhë dhe pastaj të braktisura nga presioni i shkatërrimeve: Misciano e Plusano në Gagliano, San Demetrio, pothuajse në bregdet, pas shenjtërores së Leuca; Criminno i arritshëm nga SS.275 në afërsi të Leuca; Cassandra në mjediset e Salve; Vereto e lashtë mbrapa Patù.

Ndërkohë që shumë shtëpi zhdukem, të tjera ngrihen në rrënojat e të parave. Të tjera mbijetojnë, të shpërndara si në një qerdhe ajo që fantazia popullore do të donte të shpjegonte duke thënë që Krijuesi, arritur në afërsi të detit, në toke, e pa të nevojshme të sistemojë vendet e mbetura pranë njëri tjetrit. Ndërsa tokat me kërpuha të këtyre vendeve, kemi parë që, vjen si pasojë e rrethanave të mirëpërcaktuara, sidomos dedikimi ndaj agrikultures që kërkonte stabilitet mbi vendet që duheshin kultivuar.

Në këtë fazë historike të Capo di Leuca renditet dhe lindja e fshatit tonë, që shfaqet pikërisht si një bërthamë bujqësore, aktiviteti intensiv i së cilës është gjerësisht i dokumentuar. Janë të shumtë, në fakt, mullinjtë antik dhe mullinjtë e gërmuar në shkëmb që kanë mbetur, gropat për ruajtjen e grurit për sheshin aktual, furrat për pjekjen e bukës, fermat.

Për të hedhur dritë mbi origjinën e Shën Danës është edhe një legjendë vendore, nëse merret në konsideratën e duhur, që tregon për një qytet të madh, të pasur dhe të rëndësishëm përreth, më shumë se cdo tjetër, i shkatërruar pastaj nga Turqit. Është e pabesueshme që antiku Shën Dana ka qenë qytet kaq i rëndësishëm, me siguri legjenda aludon për një qytet tjetër, atë me prejardhje nga promëti banues në shtëpi, të cilët me krenari të madhe ju tregonin fëmijëve te tyre ngjarjet dhe lavditë të atdheut të humbur, për ta trasmetuar kështu deri te ne.

### CILI QYTET MUND TË ISHTE KY NËSË S'ËSHTE VERETO ANTIK?

Origjina veretine e banorëve të parë të Shën Danës është në përgjithësi e besuar nga studiues të historisë lokale. Në faqen 63 të "Leuca dhe zonat përreth" Rosafio shkruan: "besohet gjerësisht i ngritur (Sën Dana) në shekullin e dhjetë nga shkatërrimi i Veretos". Dhe në fakt vendi që patjetër lehtësisht i thirrur për grupet raminghe të veretinëve në kërkim të zonve të reja për tu stabilizuar në afërsi të territoreve pjellore, dhe larg nga deti për të mos qenë pre e lehtë e



ANTONIO BIASCO. E' nato e vive a San Dana (frazione del comune di Gagliano del Capo, in Provincia di Lecce, dove ricopre la carica di Consigliere comunale). Laureato in Psicologia presso l'Università degli Studi di Padova. Svolge l'attività di Dirigente Psicologo nel servizio di Neuropsichiatria infantile della locale Azienda Sanitaria (ASL/LE). Ha sempre dimostrato interesse per la storia, la cultura e la realtà sociale del suo territorio. Soprattutto nell'approfondimento della ricerca storica su San Dana, il Santo di Valona venerato nel suo paese. Altrettanto attento alla riscoperta delle comuni radici tra il Salento ed il popolo albanese e alle opportunità di estendere e rinsaldare i reciproci rapporti di amicizia e proficua collaborazione tra i due popoli. In ogni numero del nostro giornale ci sarà parte del suo libro "San Dana nella storia del Capo di Leuca".

Di ANTONIO BIASCO

Le vicende di un paesino non appartengono esclusivamente a questo, non sono indipendenti dall'ambito in cui si trova. Ogni suo sviluppo, ogni suo moto, sono correlativi all'itinerario storico della zona da cui dipende; il suo evolversi e armonicamente inserito nello svolgimento della realtà storica dell'ambiente di cui fa parte. Per studiare un momento di scoria del nostro paesino, quello quale che corrisponde alle sue origini, bisogna tener presente il contemporaneo momento del Capo di Leuca, alla cui vita questo paesino è intimamente legato in comuni travagli, comuni aspirazioni, esperienze. Questa estrema parte d'Italia, lambita dalle onde dello stesso mare che fu solcato dai pionieri della civiltà, accolse in se il magnifico operato dell'uomo sin dai tempi pia remoti.

Vereto-Leuca era il centro che radiava dall'antichità, e documentazioni dell'uomo antico sono rinvenibili in ogni dove della nostra zona. Il Promontorio Iapigio, primo porto venendo dall'Oriente, e cantato da poeti di gloria immortale (1), e il colle sacro a diverse religioni, diversi epoche, e ancora conserva, mai profanato, il suo misterioso, mistico fascino del sacro, da millenni.

L'immenso azzurro del cielo e del mare lo racchiude in un involucro che lo protegge e lo mantiene vergine, in un incanto che e poesia. Le invasioni musulmane e le nuove sorti dell'Oriente, cui erano vincolate, da sempre, le nostre terre, determinano una nuova fase nella storia del Capo di Leuca. Vereto cade vittima delle distruzioni; gli abitanti superstiti si rifugiano nell'entroterra scegliendo le località pin fertili, dissodando gli estesi boschi e abbandonando le attività marine. Poche famiglie, in gruppi, soccorse, a volte, e guidate da monaci fuggiaschi dall'Oriente, che qui

trovano scampo, si spargono per il Capo. E fino a che la furiosa tempesta dei saccheggi musulmani non smette di rastrellare sul nascere i nuovi e numerosi centri abitati, queste famiglie sono sempre impegnate in continui spostamenti.

Diverse località furono abitate in questo periodo e poi abbandonate sotto la pressione delle distruzioni: Misciano e Plusano presso Gagliano; San Demetrio quasi sulla litoranea, dietro il santuario di Leuca; Criminno, raggiungibile dalla SS. 275, nelle vicinanze di Leuca; Cassandra nei dintorni di Salve; l'antichissima Vereto alle spalle di Path. Mentre molti casali scompaiono, altri sorgono dalle rovine dei primi, altri sopravvivono, disseminati come in un vivaio; ciò che la fantasia popolare vorrebbe spiegare col dire che il Creatore, giunto in prossimità del mare, ai fini bus terrae, si vide costretto a sistemare i paesi rimasti uno accanto all'altro. La fungaia di questi paesi invece, abbiamo visto, e dovuto a circostanze storiche ben precise; soprattutto la dedizione all'agricoltura che esigeva stabilita sui luoghi da coltivare. In questa fase storica del Capo di Leuca si colloca la nascita del nostro paesino, che sorge proprio come nucleo agricolo, la cui intensa attività e ampiamente documentata. Sono molti, infatti, gli antichi frantoi e mulini scavati nella roccia che ci rimangono, i palmenti e le aie sparse nelle campagne, le fosse per la conservazione del frumento disseminate per l'attuale piazzetta, i forni per la cottura del pane, le masserie. A far luce sulle origini di San Dana e anche una locale leggenda, se presa nella dovuta considerazione, che narra di una grande città, ricca e importante nei dintorni pia di ogni altra, poi distrutta "dai Turchi".

Non può credersi che l'antico San Dana fosse stato città così importante; certamente la leggenda allude a un'altra città, quella di provenienza dei promi abitanti del casale, i quali con grande vanto narrarono ai figli le vicende e le glorie della patria perduta, così da tramandarla fino a noi. Quale città poteva essere questa se non l'antica Vereto? L'origine veretina dei priori abitanti di San Dana e comunemente creduta dagli studiosi di storia locale. A pag. sessantatré di Leuca e dintorni" il Rosafio scrive: Si crede (S. Dana) comunemente sorto nel secolo decimo dalla distruzione di Vereto". E, infatti, il luogo fu senz'altro di facile invito a gruppi raminghi di veretini in cerca di nuove zone per stabilirsi in prossimità di fertili terreni, e lontani da mare per non essere facile preda delle tanto selvagge invasioni. E può risultare ancora più evidente tenendo presente che ivi già si erano stabiliti i monaci basiliani, che spesso furono di valido aiuto per le nostre popolazioni, in quei momenti così tristi della storia del Salento.

Ora, con la dedizione all'agricoltura e l'abbandono della vita del mare, Vereto non ha ragione di esistere. Per questo non risorge dalle sue rovine, nonostante la fama della sua passata grandezza e la fiera di suoi abitanti, e da vita, invece, a molti piccoli e nuovi centri. San Dana, infatti, non è l'unico paese che trae le origini dalla distruzione di Vereto, avvenuta, sembra, tra il 914 e il 924 (vedasi il Rosafio); Patù, Giuliano, Morciano e quasi tutti i paesi del nostro Capo pigliano le origini dalla città messapica.

(1) Virgilio fa una bellissima descrizione del posto parlando del viaggio di Enea verso l'Italia: « si scopre il porto vicino e il tempio a Minerva sul monte. Caliamo le vele, volgiamo ai lidi le prore. Ad arco il porto s'incurva, sicuro dei flutti di Euro, le rupi di fronte spumeggiano in salso fervore, scogli turriti che in basso distendono le braccia simili a duplice muro lo coprono ai lati e indietro il tempio scompare alla vista dal lido". Già Eleno aveva indicato queste terre "abitate dai Greci malvagi". Per cui «Compiuti di seguito i voti solenni per ordine, volgiamo subito al mare le antenne e le vele, lasciamo i campi sospetti e le case dei Greci.. (Eneide - Libro Terzo).

Si conserva ancora un'ara su cui venivano offerti sacrifici a Minerva.



# Udhëtim në Karaburun – Gjuhën e Zezë

*Kur Krushovi do të vendoste raketat në Karaburun*

Nga GËZIM LLOJDIA

Mali i Karaburunit ndodhet në gjirin e Vlorës në një zonë ku gjeografikisht shtrihen 19 km gjatësi dhe 16 km gjerësi. Emërtimi mendohet nga kohët më me mjegull, mal i zi apo qafë e zezë dhe kjo ndoshta për shkakun e thjeshtë, mbulesën drunore, ndërkaq emërtimi i përket kohës së osmanllinjëve. Aktualisht në vendet e thelluara ku pjesa drunore ende nuk është e kërcënuar nga zjarret apo ripërtëritja e saj është bërë në një garë me kohën, qartazi dallon ngjyrën që merr mali. Nëse do ti hedh një sy këtij vargmali do të shquash masivin e dheut, shkëmbit, drurit e cila shpalos në gjithë gjerësinë nga Kepi i Gjuhëz që është shenjë referimi për gjun e Vlorës deri në Jon. Të thelluara dhe të dala, faqe të pjerrtë, zigakee në formë ulluqesh, por e gjitha e prerë si me një spat deri aty ku ndahet kufiri i kënetës. Më pastaj lartësia rritet ndërsa tisi gri ruhet. Format e çuditshme që ka vargmali ruajnë dhe një hije misterioziteti. Përsipër re bardhoshe me forma misterioze. Nën këmbët e tij përkunden dy dete me dy emra. Jon dhe Adriatik. Një lagunë me madhësi 2.4 km, 1.8 km gjerësi. Fusha e Dukatit 160 ha. Gadishulli formon një hark të madh e ku ndan gjirin detar të Vlorës nga Kanali i Otrantos dhe ka një gjatësi prej rreth 16 km, me një gjerësi që shkon deri në 4.5 km. Ndërsa një ushtarak madhor, më konfirmoi atë që do ta quaja interesante, lidhet me trashësinë e masivit shkëmbor. Ai mund të jetë vetëm 1.5 km diku pranë kishës së bardhë të Mariës. Përse aty? Nuk kama arsyezim shkencor për një përgjigje. Dhe çfarë mund të ngjasi aty? Besoj tek thënia e dikujt se mund të shpohet për një tunel që do ta nxirte udhëtarin në pjesën më piktoreske të Ballkanit dhe kështu mendohet se një ditë, ky projekt do të jetë i jetizuar bukurisht. Prej andej turisti, do të udhëtojë si nëpër ëndërr, mes parajsës, ngjyrës blu, bardhësisë së reve pulpore, ëmbëlsisë së klimës, ashpërisë së masivit shkëmbor dhe ëndrra është një realitet, udhëton nëpër kohë dhe hapësirë.

## TOPONIM

Gjiret më të njohur të këtij vargmali janë: "Gai i Ariut, Dafinës, Raguzës, Ravenës, Shën Janit, Shën Vasilit. Ravena është një pllajë mali. Karaburunit me një lerë të madhe ndërtuar në kohën e monizmit. Kam gjezdisur nëpër përkrahime të ndryshme dhe kam gjetur të dhëna për këtë zonë që thonë se: Në skajin veriperëndimor të Karaburunit ndodhet Kepi i Gjuhëzës, pika më perëndimore e Shqipërisë. Kepi i Gjuhës, aty ky mbretëri e frikës ka ngritur shtëpinë e saj të përherëshme. Aty ky masivi ujon dhe shkëmbor pikëzohen egërsisht. Është humbëtira ujqore e kripur. Vendi ku godasin



## ATJE KU KRUSHOVI DO TË VENDOSTE RAKETE KUNDËR FLOTËS AMERIKANE

Ruga për në Ravenë është copë dhe vetëm Rforistrada ngjitet dhe zbrite ndër gurët e shumtë. Aty ndërtesat u ngritën nga rusët në vitet kur vendi ynë ishte pjesë e Traktatit të Varshavës. Betoni i hedhur për raketat që do tu binte flotës amerikane që gjendej në Mesdhe e ka burimin tek vizita e ministrit të mbrojtës së BS të asaj kohe dhe të Krushovit në bazën e Pashalimanit. Flitej për vendosje të nëndetësve bërthamore. Fushën e Dukatit si aerodrom për avionët e Traktatit të Varshavës. Nëse sot aktualisht gjenden 3 nëndetëse të ankoruar në bazën e tyre të vjetër, asokohe ishin 12 nëndetëse. Nëndetëset u sollën nga Bazën detare të Baltiskut. Ishin plot katër nëndetëse së bashku me bazën e tyre lundruese "Nemčinov", e cila më vonë mori emrin "Tomorri". Duke sjellë fakte për gjitarët e detit: fillimi i vitit 1960, bazës së Pashalimanit, respektivisht Brigadës së Nëndetësve të vendosur aty, iu shtuan edhe tetë nëndetëse të tjera, po të projektit C 613 së bashku me bazën lundruese "Katjelnikov". Kësisoj, brigada e nëndetësve u kompletua me 12 anije të tilla të tonazhit të mesëm dhe dy baza lundruese.

## FAUNA DHE FLORA

Një studim, që sollën zvicëranët e Universitetit të Gjenevës, për florën dhe faunën ishte më interes se ende në këtë zonë sidomos pjesa mes kënetës dhe rrënoja të Orikut jeton ende një ndër llojet e hershme të bimësisë, që në rajonin e Mesdheut është zhdukur prej kohësh nga hartat. Madje edhe për lagunën legjendat kanë folur për ngjalat të cilat në kohë shtegtimi nisen drejt vendeve të Afrikës veriore, ku shumohen dhe atje ngordhin, ndërsa të voglat e pjellura aty rikthehen në lagunë nëpërmjet një rruge që nuk dihet se si është e shënuar ne tenien e trurit të moluskut. Si fenomen në kohë shtegtimi ato grupohen dhe mblihdhen lëmsh për të pasur humbje sa më pak. Një fenomen tjetër është në kohë stinë dimri. Rosa, bajza deri pelikanë dhe një llojshëmri zogjsh mblihdhen në lagunë ku dimërojnë deri nga mesi i prillit. Bajzat i kam parë vetë kur ato mblihdhen rreth anëve të lagunës detare me një thellësi deri në 4 m, futen në kallamishte për të lëshuar vezët. Pas shumimit të vegjlit dalin deri sa mësojnë fluturimin për tu rikthyer në vend-origjinën e tyre. Një ndër dukurit e njohura është nuhatja e tyre nga rreziku. Gjahtarët e paligjshëm, shpesh gjuajnë bajza dhe rosa. Mirëpo ato kanë kuptuar se sa të rrezikuara gjenden në brigje. Mërgojnë deri në mes dhe në thellësi për të mos i kapur plumbi dhe dora njeriut. Dimrin e shkuar, laguna zbardhëronte nga bajzat, rosat. Sivjet ishin pakësuar. Çfarë po ndodhe me to? Kur ushqimi aty është i sigurt. Përse erdhën gjysmat dhe me pjesën tjetër, çfarë ngjau? Do të kthehen vitin e ardhshëm. Ky fenomen u vrejt edhe tek zogjtë shtegtarë. Ishin mijëra një vit më parë dhe pas një viti, u përgjysmuan. Çfarë ka ndryshuar itinerarin e tyre, apo çfarë ka pasur turma shtegtare e tyre? Çfarë ka ngjarë në arealin e tyre? Ndërkaq a është koha e alarmit se mos areali i tyre është përgjysmuar? A është koha për

të thënë se miqtë e vjetër shtegtar ikën dhe më s'kthehen sepse ndotja, prerja e pyjeve, tharja e ujërave i largoi përgjithmonë apo ka ndryshuar itinerari dhe grafika e shtegimit për në vise të tjera më të mbrojtura që ka ujë, ushqim dhe pyje? Sidoqoftë ende tek ne universitetet tona nuk po krijojnë një monitorim të këtyre lagunave ashtu siç ndodh me, universitetet e dëgjura të perëndimit. Dua të përmend se grupi zvicëran i Universitetit të Gjenevës që gërmon në Orik çdo vit, mes arkeologëve, studentëve, historianëve ka edhe biolog, ekspertë të faunës, florës dhe mjedisit të cilët monitoruan në mënyrë shkencore, llojet e faunës dhe florës. A e dimë se sa lloje kishim, sa kanë mbetur ende gjallë dhe të rrezikuara? Areali i dërrit të egër është, por rreziku i tij që quhet 97 kur u sulmua me kallash, mitraloz, belçik e gjithfarë armësh që gjendeshin jashtë depove në duar të pasigurta, po e zhduk këtë specie të rrallë e cila i ruhet tmerrsisht njeriut egërsirë. Duke folur për këtë vargmal që ka maja të lartësuar mund të përmend Koreta 826 m, dhe maja e Ilqes me 733 m. Si e përcaktojnë studiuesit e fushës gjeologjike, ata shkruajnë se përbëhen nga gëlqerorë të Kretakut, Poleogjenit dhe mergele të miocenit. Dhe sipas tyre shqyrtohet kështu dukurinë aq të përhapur të Karstit, e cila e bën gadishullin të pabanueshëm për shkak të mungesës së ujit të pijshëm. Këtë dukuri duhet ta shqyrtojmë me këtë mundësi të tillë: Ujërat si në të gjithë globin pëlcasin pra, formohen gjithmonë në lindja dhe derdhën gjithmonë në perëndim. Kurse këtu gjendemi në perëndim të perëndimit. Bregu perëndimor i Karaburunit është spektakolar me gjire dhe plazhe te vogla e te izoluara, me ujera te thelle dhe shume te pastër. Ne veri te gadishullit gjendet shpella detare e Haxhi Alisë (lundëtar ulqinak i shek XVII) Kjo është shpella me e madhe detare e Shqipërisë, thonë disa burime të tjera.

## UDHËTIM NË GADISHULLIN SHQIPTAR

Një udhëtim në Karaburun. Foristrada Njgeci mes gurëve dhe u nisëm në këmbë. Shfaqen gurë dhe kullota. Ka faqe të zhveshura një pyll me dru. Krahu që bie përmbi det dhe lartësia që formohen tregojnë si bimësi të lartë, valanidhin është një bimë e njohur si dhe lisi Gurët janë pjesë e masivit shkëmbor. Masivi i Karaburunit, në tërësi, është i varfër në bimësi, por i pasur në kullota. Në pjesën më të ulët dhe më të ngushtë të tij, ndodhet pllaja e Ravena. I përket si pasuri banorëve të fshatit Dukat. Në Ravena do të ndërtoheshin bazat e rusëve kundër flotës amerikane, që dislokohej shpesh në Mesdhe. Po të shikosh nga demontimi kanë mbetur ende minat detare. Ato kurthuan detin nga Korfuzi në Sazan. Të rrumbullakëta kanë pasur një mbushje deri në 280 kg barut, më kishte treguar një ditë një ushtarak marine. Të tjerat në formë vezake i përkasin, dragaminave pra mjetit luftarak, që lëshonte këto mina përmbi nëndetëset të cilat zor se mund ti shpëtonin, duke siguruar vdekjen e tmerrshme nën ujë. Një histori që pleks bazën fortifikuar nga kohët e antikitetit e përmendur tek libri: "Belli Civilis" i Cezarit, shqipëruar: "Lufta civile": "Çezari zbarkoi ushtrinë po atë ditë u nis për në Orik. Këtu Luc Torkuati, që sundonte në qytet me urdhër të Pompeut mbylli portat dhe u mat të mbronte qytetin, duke urdhëruar grekët të hipnin në mure, dhe të rroknin armët. Por këta nuk donin të luftonin kundër Romës, bile qytetarët përpiqeshin të pranoin Çezarin vullnetarisht. Atëherë Torkuati çeli portat dhe u dorëzua tek Çezari me gjithë qytet".

## NJË E DHËNË E VEÇANTË HISTORIKE

Sipas studiuesit I.Cjika, historia Ana Skomnena në librin e saj «Aleksada», na jep këtë dëshmi interesante mbi sulmin Norman në Vlorë. «Boemundi pushtoi Kaninën, Jerihon (Orikum) dhe Krahinën përreth. Më pas ai u nis në Butrint ku takoi të atin. Dhe kur të dy u nisën drejt Durrësit, Boemundi i tokë dhe Roberti me det, në vëndin e quajtur Gjuhë (Karaburun), stuhia e goditi keq flotën Normane. Pas kësaj Guiskardi u strehua në Gllavinicë ku qëndroi shtatë ditë dhe pasi priti përforcimet u nis drejt Durrësit».



Zbukurimi më i madh është ndërgegjeja e pastër

Ciceroni

Nga LUAN CIPI

Dhimiter Rrumbullaku e njoha kur ai ishte në moshë të thyer. Usta Mitë, siç i thërrisnin të gjithë, aso kohe ishte përgjegjësi teknik e administrativ i Repartit të Shtypshkronjës, i përfshirë në veprimtarinë e Ndërmarrjes Lokale të Prodhimeve të Ndryshme të Vlorës, ku edhe unë punova për gati 10 vjet. Në stabilimentin, ku drejtonte Mitë, ishin vendosur makineri e pajisje të grumbulluara nga katër shtypshkronja, pra aq sa ishin në rrethin e Vlorës para lufte. Atje, shtypej gazeta “Zëri i Vlorës”, libra dhe broshura lokale, si dhe të gjitha shtypshkrimet dhe formularët për nevojat e ndërmarrjeve, institucioneve dhe kërkesave publike të Qarkut të Vlorës, ku përshihej rrethi i Vlorës dhe i Fierit

Korpusin e makinerive të kësaj shtypshkronje, me emrin e madh “Atdheu” e përbënin: Një thikë prerëse, që punonte me elektromotor, me volant e gjerësi një metër; fondi i shkronjave, rrigetave dhe bocetave, me shumëllojshmëri të të gjitha tipave dhe madhësi, kompletuar me stampa e lule-lajle gjithfarëshe; një linotip që formonte shkronja të reja të derdhura plumbi; dy makina tipografike, pedalim po me elektromotor; një makinë tipografike e madhe; makina rrotative tipografike e gazetës, etj

Usta Mitë kishte qenë një nga punonjësit kryesor të kësaj shtypshkronje, qysh nga koha e Zogut e deri në vitin 1947, kur u shtetëzua. Ishte i pranishëm gjithnjë, në qendër të veprimtarisë së shtypshkronjës, duke qenë njëherazi pronar i saj, përfashuar një periudhë dy vjeçare, gjatë luftës, kur e internuan në kampet e përqendrimit, së bashku me pesëqindtë burra të tjerë nga Vlorë. Mit Rrumbullaku i ri, pat qenë krenaria e djalerisë vlonjate, pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë sportive dhe kulturore të qytetit.

Në shtypshkronjën ”Atdheu” punonin 12 punëtorë, me stazh të gjatë pune. Disa prej tyre ishin të moshuar dhe kishin qenë veprimtarë të vjetër të Usta Mitit, qëkur ky kishte qenë pronar i shtypshkronjës. Marko Mina, Stefan Boçova, Tol Stefani, Aqif Sadiku dhe Andrea Lame flisnin me nderim të thellë dhe kishin dashuri të pamasë për ustain dhe padronin e tyre të hershëm. Ata kishin qenë nxënësit, shokët dhe miqtë e tij më të mirë. Ai edhe kur ishte pronar, punonte në prodhim krahas tyre. Mitë i zotëronte të gjitha specialitetet, duke qenë njëherazi radhitës i shpejtë dhe i pagabueshëm, faqosës, linotipist, makinist i çdo lloj makine e deri një libralidhës i talentuar. Të gjitha këto zeje i kryente në përsosmërinë e tyre. Usta Mitë dhe kështu ishte përpjekur, pa rezerva, t’i përcillte sekretet profesionale të bashkëpunëtorët

e tij besnikë. Ai, personalisht dallohej mbi ta edhe për punime artistike si për bërjen e kornizave të kartonit me oriz, tutkall e varak; dosje e kuti kartoni e kartoçine të shumëllojta, zarfe, kartëvizita të bukura, lidhje speciale librash, etj. Kur gjente kohë, këto punë vazhdonte t’i bënte me dashuri e pasion, pa i pasur detyra funksionale. Edhe më pas, kur doli në pension, punonte për të bërë ndere, pa asnjëfarë interesi material. Usta Mitë ishte një organizator dhe administrator i talentuar. I ngarkonte të gjithë me punë si të barabartë, pa u ndikuar nga asnjë simpati vetjake, apo pikëpamje politike. Ai ishte i saktë në anën dokumentare, si për hartimin e preventivave, të urdhërporosive dhe për formimin e çmimeve, në evidencimin e shpenzimeve dhe në nxjerrjen e kostos së prodhimit e deri në llogaritjen e të ardhurave dhe të fitimit.

Falë punës së tij këmbëngulëse shumë vjeçare një kujdes i veçantë tregohej për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e makinerive. Çdo ditë të shtunë puna kudo ndalej krejt, dy orë para mbarimit të turnit dhe të gjithë punëtorët merreshin me pastrimin dhe lubrifikimin e agregateve. Kjo ishte bërë, jo vetëm traditë, por ishte normë e detyruar, qysh kur këto asetë ishin pronë private. Ky ishte sekret i gatishmërisë teknike për këto makineri që, pothuajse ishin të vjetra, të blera nga Gjermania dhe Austria qysh para lufte, pasi ishin përdorur dhe atje për dhjetëra vjet. Gjeje stampa, në këto makina, që kishin si vit prodhimin 1880.- tën. Lubrifikimi e mban të ri njetin, thoshte Usta Mitë. Vaji për makinat është i domosdoshëm, si uji për kafshët dhe njerëzit. Edhe njetet e lubrifikimit si vajosëset dhe gratorët në këtë shtypshkronjë ishin, qysh nga koha e para luftës. Usta Mitë ishte dhe një njeri shumë human, i dashur dhe i pakursyer për t’u vënë në dispozicion me gjithçka. Mua më deshte fort nga që kishte pasur miqësi, njohje dhe nderim të ndërsjellët me babain tim. Edhe unë, gjithashtu, e adhuroja, e vlerësoja si asnjë e ndihmoja dhe i dilja krahe për çdo gjë. E si mos ta ndihmoje atë babelok aq të ndershëm, punëtor dhe dashamirës?

-Mos u rrëmbe, më thoshte. Mendoje mirë fjalën, para se ta nxjerrësh, duke kafshuar gjuhën. Shiko edhe kë ke për rreth. Ruh u në liqtë dhe karrieristët. Ja, p.sh., më tha një ditë: nga ai “turku”, që kam unë, ruhu, se, ai diku vete e raporton, për

çdo gjë që sheh dhe që nuk i pëlqen. Ka plotë si ai. Kur im vëlla, Bektashi, ra në burg, për një çështje ordinere të sajuar e të fryrë, Mitë Rrumbullaku ishte i vetmi që më qëndroi më afër nga kushdo me porosi e kështilla. Veç të tjerash ai më tha me sinqeritet dhe intimitet: Luan i dashur! Të kam si djalin tim. E kuptoj që je në hall të madh dhe ke nevojë për çdo lloj ndihme... Ta dish që mua më ke gati për çdo nevojë. Më thuaj, si të kesh gjallë babën tënd, mikun tim të vjetër. Ti e di që unë i kam hequr ca para mënjane për një ditë të zezë, për një të keqe të mundshme. Kjo e keqe të ra ty, por sikur më ka rënë mua...Ja ku i ke, merri. Mos mendo kur do m’i kthesh. Unë nuk t’i kërkoj më. Po i pate me thasë, si i thonë, m’i kthe me torbë. Ato janë si të ishin të Kamanit, babait tënd të ndjerë. Unë e falënderova dhe u kënaqa sa s’thuhet, por, natyrisht, nuk ia mora, se aso kohe nuk kisha nevojë për to. Mitë u zemërua shumë. Xha Mitë kishte katër vajza: Lizën, Elvirën, Çivin dhe Linën. Vajza e vogël, në moshën e adoleshencës, kaloi çaste tëpafundme dëshpërimi, të nxitura nga një intrigë dhe thashethemnajë. Çasti fatal kish lidhje me një premtim dashurie. Njomcakja e mjerë, e befusuar dhe shqetësuar nga një tradhti e pabesi e stisur, si dhe e ndodhur në një mjedis pa ngrhtësi dhe papërkrahjen e duhur, e ndofta, përkundrazi, në rrethana të një mjedisi fetar, përbuzjeje e dhune, nuk duroi dhe nuk gjeti zgjidhje tjetër, veçse vetëvrasjen me helmim.

E kisha njohur nga afër Linën 16 vjeçare, kur vinte te shtëpia jonë në Muradie me të motrën, Elvirën, që ishte në një klasë dhe shoqe e ngushtë e motrës sime, Teutës... Lina ishte shumë e bukur, e zgjuar dhe ëndërrimtare. Mësova dhe për prapaskenën, intrigën dhe dizinformimin për dashurinë “e humbur”, që e çoi atë drejt çastit makabër. Sa të papitura sjell jeta. Sa të kujdesshëm duhet të jemi me fëmijët tanë në këtë moshë kaq delikate. Për Dhimitër Rrumbullakun kjo ishte një goditje vdekjeprurëse që e plaku dhe e kërrusi para kohe atë, aq sa s’e ngriti më kokën, derisa dha shpirt. Atij i ngeli peng ngurrimi dhe paafësia për të vepruar në kohë, për të depërtuar në psikologjinë e adoleshentes së brishtë, që nuk i kishte qëndruar afër aq sa duhej, për ta kuptuar dhe parandaluar gjëmën. Iku me një plagë të madhe xha Mitë, mjeshhtëri i rrallë, njeriu që radhiti në mijëra fletë fjalën e bukur shqipe.

Tre vitet e para bëra si bëra, por i katërti ma nxii shpirtin. Se si ikën ata tre vjet nuk e di se ishim njerëz të shkukur dhe kërkonim të sheshoheshim sadopak në shtetin e huaj, ku na çoi halli. Sa më shumë kalonte koha, aq më tepër na ngrihej mendja dhe atdheu na përqasej në bisedat tona të përditshme dhe në ëndrra. Malli dhe merakun për njerëzit që kishim lënë pas po na e përcëllonte shpirtin çdo ditë e më shumë.

Të gjitha ëndrrat më merrnin nëpër natë dhe më çonin në qytetin tim, në vendlindje dhe kudo ku kishte shkelur këmba ime. Edhe ata për të cilët nuk kisha pasur ndonjë konsideratë kusheidi se çfarë, ishin të pranishëm në ëndrrat e mia. Kujtoja të gjallë e të vdekur, të njohur, miq e shokë dhe qetësia më prishej përherë e më shumë. Ajo që ma shtonte më tepër bregënd dhe më bënte të mos prehesha i qetë ishte nëna ime. Sa herë që do të flisja në telefon po të njëjtën pyetje do të më bënte: “Hë, re nuk do të vish ti? Nuk do të të shohësh edhe njëherë sa të jem gjallë?” E merrja me të mirë dhe i premtoja se shumë shpejt do të kthehesha, por kur mendonim se çfarë na pristë në atdheun tonë të dashur na këputeshin këmbët dhe nuk vendosnim dot.

Pyetjes së nënës iu shtua edhe një peng që e mbajta në shpirt prej vitësh, pa ia thënë askujt: më duhej të shkoja te varri i tim biri e të vendosja një buqetë me lule. U bën shumë vjet që nuk kisha shkuar njëherë e të shihja vendin ku prehej ajo foshnje e mjerë, që u vyshk ende pa u rritur mirë. Pothuajse çdo natë më shfaqej në ëndërr dhe më thoshte ashtu, duke bërëbëlitur: “O ha, si më harrove? Si më le këtu më mes të të panjohurave dhe ike s’dihet se ku? Eja, baba e më shih njëherë!” Këto ëndrra më llahtarisin përherë e më shumë dhe një ditë, sapa u ngrita në mëngjes për të shkuar në punë i thashë time shoqje:

- A ke menduar ndonjëherë për tēt bir që s’e kemi parë prej vitësh qysh se u larguam nga qyteti ynë?

- Mos ma kujto, të lutem, se atje e kam mendjen natë e ditë, - ma ktheu dhe u përlot.

I tregova për ëndrrat që shihja çdo natë dhe më në fund i thashë:

- Përfundimisht, duhet të ngrehmë plaçkat dhe të ikim. Veç merakut për nënën e moshuar, kemi edhe ëndrrat që s’po na lënë rehat.

- Ti, e di, po ku do të vemi? Atje na pret papunësia dhe skamja.

- Mos e vra mendjen, një copë bukë do ta hamë si gjithë të tjerët.

Në darkë iu njoftova fëmijëve se në fund të marsit do të ngriheshim e do të iknim. Ata që nuk e ndjenin si në dhimbjen sikur u stepën për pak çaste, por unë ua bëra të qartë arsyet e largimit tonë për në vendlindje. U thashë se një pjesë të shpirtit tim e kisha lënë atje, bashkë me tim bir që prehej në varrezat e qytetit. Veç kësaj iu shpjegova se kur të bëheshin vetë prindër do ta kuptonin dhimbjen e tyre për fëmijët.

Fundi i marsit na gjeti në shtëpinë tonë të sakatuar

nga qiraxhiu, në E. Plaçkat e vjetërsirat që sollëm me vete na u deshën tri-katër ditë që t’i sistemonim. Sa ramë pak në qetësi i thashë time shoqeje s’e nuk po më rrihej rehat. Dy ishin preokupimet e mia që të rëndësishme: të takoja me nënën që t’i nxirja merakun dhe të shkoja të ndizja një qiri e të vendosja një buqetë me lule te varri i tim biri.

Ashtu bëmë. Pasi takova me time ëmë, e cila qau nga gëzimi, e mbajta frymën drejt e te varrezat e qytetit. Para se të kapërcenin portën e varrezave u ndalëm e morëm një buqetë të madhe me lule artificiale te një luleshitës nga të shumtët që ndodheshin disa metra para portës së varrezave. Përhëndetëm varrmihësin që rrinte te porta, përpara një kamareje ku vizitorët hidhnin ndonjë lek, futa dorën në xhep e hodha edhe unë ca të shkoqura për sevap. Me gruan përkrah e mbajta frymën atje ku mendoja se ishte varrosur engjëlli im prej shumë vitësh. Me thënë të drejtën u hutova ca se pamja e varrezave kishte ndryshuar krejtësisht. Kjo që kisha përpara syve shumë pak ngjante me atë të dikurshmen. Hodha sytë përreth për t’u orientuar: kudo buste e qivure të shtrenjtë të rrethuar me kangjella hekuri të lyera me bojëra të ndryshme. Dominonte e zeza. Me tahminë shkova te vendi që mbajta mend prej vitësh duke qarë përmes qivureve gjigantë dhe pasi numërova disa radhë me varre iu afrova njeriit që kishte thjeshtë një emër në një pllakë betoni katrore. Nuk ishte emri i tim biri. Eca pak më tej, e njëjta gjë. U theva dhe hyra në radhën tjetër se kushedi mbase isha i gabuar dhe e kërkujta kotë aty. Shumë pak varre me të tilla pllaka betoni mund të zinte syri përreth. Edhe aty nuk gjeta asgjë. Ime shoqe kur e pa se s’po e gjenim dot u bë një dorë prej trishtimit. E qetësova duke i thënë se do të shkonim te varrmihësi dhe do ta gjenim shumë lehtë nëpërmjet regjistrit të të vdekurve.

- Do Zoti dhe e kanë një regjistër të tillë! – e qetësova gruan.

I futa një njëqind lekëshe varrmihësit dhe iu luta të kërkonte për emrin e tim biri në regjistrin e varrimeve.

- E more, vëlla, - ma ktheu ai, - këta regjistra që kam unë as gjysmat e fletëve nuk kanë. Megjithatë, do Zoti ke fat dhe e gjen. Si e kishte emrin djali?

Ia thashë dhe po shihja me ankth lëvizjet e gishtit të tij kur kalonte pa u ndalur nga faqja në faqe. Ai ndaloi. Mora frymë i lehtësuar: “Më në fund, mendova i lehtësuar!” Ime shoqe ishte bërë gati të skinjësh. Lotët po i shndrinin në cepat e syve. Varmihësi ngriti kokën dhe tha:

- Rreshti trembëdhjetë, varri numër 176. Besoj se atje do ta gjeni.

Mezi i dalloja tabelat nëpër qoshet e secilit rresht.

# Varri i shitur

Nga KUJTIM AGALLIU

Isha i trullësuar dhe më ishin veshur sytë nga merakun nëse do ta vija një buqetë me lule artificiale te varri i tim biri apo jo. Ëndrrat për të më kishin ngritur nga mijëra kilometra larg dhe më kishin sjellë deri këtu.

Por zhgënjimi im nuk njihje kufi. Pikërisht në numrin dhe rreshtin që më dha portieri zemërmirë ngrihej madhështor një varr i rrethuar me kangjella të larta hekuri. Bash në krye të qivurit një skulpturë gjigante e një djaloshi rreth të njëzetë e pesave. Aty midis të tjerave shënohej: “Vrarë nga bandat e vitit 1997” dhe më pas se kush ia kishte përkushtuar këtë varr. M’u këputën këmbët dhe u mbështeta në krahun e time shoqeje. Ajo ishte për vete helm e pikë. Shtërngonte në dorë buqetën me lule dhe nuk dinte s’e ç’te fliste. Për merakun tim hodha dhe një vështrim teknja dy varre aty pranë se mos kushedi edhe mund të ishte ngatërruar pa dashje vendi i saktë. Por jo...askund nuk dukej shpirti i babit. Gjithandej heshtje e përmortimes. Vetëm ca bletë kalonin nga njëra gonxe trëndafil në tjetrën pa e prishur terezinë për hallet e të gjallëve. Ç’të bëja? Ku ta gjeja varrin e birin tim në këtë mbretëri të pagojë, ku gëlonin vetën beton e hekura pa hesap dhe lule artificiale të shpërndara prej ditësh apo ndoshta muajsh nëpër rrugicat e ngushta midis varreve që mbulonin mermeret e ftohtë të tyre. Filloi të më mundojë një mendim origenit. Mos ndoshta...mos ndoshta..., nuk na nxinte goja ta shqiptoja. Megjithatë nuk u përmbajta më, por ia tregova time shoqeje shqetësimin tim:

- Mos na kanë bërë ndonjë dallavere, moj grua!

- Qyqja, mos e dhëntë Zoti, - klithi ajo që m’u duk se ku e kisha kuptimin dhe nga sytë i vërshuan lotët. – Edhe këtë të na kanë bërë?

- Edhe mundet. U bën shtatëmbëdhjetë vjet që s’jemi bërë të gjallë. Sot çdo gjë mund të ndodh.

- Mos të ngutemi. Kthehemi edhe njëherë e pyesim varrmihësin. Mbase kanë ndryshuar radhën në regjistër, - tha ajo.

Me këmbë të kalamendura shkua nëpër shtëri te porta. Varmihësi ngriti supet pa ditur se ç’të na thoshte.

- Zotëri, bën vaki që të bëhet ndonjë dallavere këtu?

Ai në fillim nuk e kuptoi, prandaj më pyeti:

- Ma thoni më shkoqur, zotëri. Për çfarë dallavere e keni fjalën.

- Ja, për shembull, që të shitet ndonjë varr kur të afërmit kanë vite që nuk janë interesuar?

Ai u gjend i pa përgatitur, por si e mori veten ma ktheu.

- Ç’farë nuk ndodh sot, more zotëri. Po pate lekë edhe varrin ta blejnë.

Përgjigja e mëdyshtë e tij më bindi plotësisht se varrin e tim biri e kishin blerë. Kjo ishte një dackë e fortë për

# Unaza prej floriri

nga KOSTAQ DUKA

Kishte humbur krejt fytyra mes degëve ngarkuar me pjeshkë. E nxehta përvëluese impononte heshtjen. Zërat e qeshura të mëngjesit, kur u fillua vjelja me një shpejtësi turravrapëse, ishin shuar krejt... Aty këtu degëjohej ndonjë dialog i mbytur dhe i padëshifruar... Herë, herë ndihej e ecura nervoze e shpejtuar e pronarit dhe thirrja ngulmuese: Grigora, grigora...!” Fundi i rreshtit, me rrënjët e mbetura për t’u vjelë dukej sikur lëvizte pafundësisht, për të mos u kapur kurrë. Kova plastike ku vendoste pjeshkët me kujdes për të mos i vrarë, po i rëndonte aq shumë sikur në të të ishin vënë gurë. I përvëlonte fytyra ku djersa ishte trashur nga pushi i pjeshkëve si të ishte mastiç për të ngjitur këpuçë.Jo kurrë s’e kishte menduar kaq të vështirë vjeljen e pjeshkëve...

Por... ndoshta ishte dita e parë. Më vonë do të mësohej. Gjatë vjeljes, ku s’i shkonte mendja... Ja disa herë rrezet e diellit binin mbi rrethin e florinjit të unazës, teksa dora gjatë vjeljes lëviste papushim mes degëve, gati shkure të pemëve. Ato përthiheshin e sikur ktheheshin përsëri tek disku farfuritës. I pëlqente kjo lojë e rrezeve me unazën... Tek ndiqte këtë lojë jo njëherë i vinte pranë fytyra e trishtuar e gruas me të cilën s’kish as dy muaj martuar... Mos ik, mos ik! - ishte lutur ajo... E kam të vështirë të jem pa ty...

-Ta provoj, në fillim në pjeshkët pastaj do shkoj në qytet të ze një punë të mirë dhe të të marr dhe ty- i premtoi ai...

Tani, tani mezi priste të mbaronte punën. Lodhja e kishte vënë poshtë. Sytë i ishin përskuqur si nga ethe të mëdha... Dhe ja u prek fundi i rreshtit. Vendosi shkallën nga ana e vet. O burra, i tha shoku nga krahu tjetër, ta zhveshim edhe këtë pjeshkë e të vemë të shlodhemi. Në mbremje do shkojmë në buzëqe. Ke për të ngrënë suflaqe dhe do shikosh botë! Se mos harrosh që je i martuar!...

Nuk u përgjigj. Në fytyrën e përskuqur si të dalë prej furre zjarri u ngërdhesh një buzëqeshje... E ndjeu gjaku t’i lëvrinte me shpejtësi. I’u ngjiti shkallës me vrull inaçor. Nisi të mbledhë të fundit pjeshkë në këtë ditë të parë si emigrant. As vetë s’po e kuptonte nga i erdhi papritur kjo energji. Duart i futëte me forcë mes degëve dhe gishtrinjtë si prej automati kapnin pjeshkët e verdha në të kuqe që shpejt përfundonin në kovën plastike. Shoku i vet që kishte vite si emigrant dhe si vjelës pjeshkësh ndali një çast punën dhe po e vërente me habi...

Ej - iu drejtua - më ngadalë nuk mbyllet dita me tërsëllëmë. Do lodhesh. Thashë të shpejtojme po jo të vrapojmë.

Por ai s’e uli ritmin, u ngjiti edhe më thuajse në majë të shkallës e po vilte të fundit degë, të ekspozuar në dritë e ajër, që thuajse ishte përtej kurorës së pemës, në lirinë e vet... Mbetën vetëm tre kokra në majë të degës, në pjesën më hollake e delikate të saj... Tre kokra që verdhonin mes masiv të gjetheve të blerta të pjeshkës. Për një çast ndjeu keqardhje. A nuk është dhe pjeshka, frymore, qenie e gjallë? Zgjati duart për ti këputur tre kokrat. Dhe donte të përsëriste atë lojën e përthyerjes së rrezeve të diellit që farfurinte lart në rrethin e florinjit, përthyerje që do ta përziente me verdhëllimën e pjeshkëve... Por... O zot!... U drodh i tëri. Në gisht mungonte unaza e florinjit. Në vënd të saj një vijëzë gjaku si e prerë më thikë. I hodhi me ankth pjeshkët në kovë dhe i thirri shokut nga ana tjetër e pemës: “Më ka humbur unaza prej floriri, unaza e martesës”

Të dy nisën të kërkonin, poshtë kurorës së pemës. Ishte një bar i sertë, i lartë dhe i bërë zhukë sa mezi hapej. Erdhën dhe të tjerë. Për gati një orë u kërkua unaza. Por ajo s’u gjet.

Refuzoi ftesën e shokëve për të shkuar në buzëqe. Tërë kohën qëndroi jashtë duke ndjekur perëndimin e diellit.

Grigora: gr.- shpejt.

mua. Mirë ma kishin bërë kur unë endesha nëpër udhët e kurbetit dhe liza njerëzit e mi më të shtrenjtë pa i parë për vite me radhë. I thashë gruas të bënte gjajret dhe ta vendoste buqetën me lule diku në ndonjë varr tjetër. Ajo ashtu bëri. Nuk kishim se për çfarë të prisnim më. Eshtat e djalit tonë kushedi se në ç’kosh plehrash kishin përfunduar. Ne edhe sikur të harxhonim tërë jetën tonë nuk mund t’i gjenim dot përsëri.

Hodha sytë përsëri nga qyteza e varreve. Bardhësi, hekura të zinj, skulptura, lule artificiale të hedhura gjithandej. Gjithkund ftohtësi, heshtje, një mbretëri e pagojë që kishte filluar të qeverisej nga tregtarët e varreve. E vetmja gjë e gjallë aty ishin trëndafilat, bletët që zukatnin nëpër petalet e tyre dhe portieri apo varrmihësi që të shumtën e kohës rrinte përpara kamare me lekë të prishura. Më bëhej se aty ishte edhe shpirti i tim biri, që më dukej se më thërriste me zë parajse nga gonxhet e trëndafilave. “Mos u mërzit, babi! Edhe ti mami! Unë jam këtu, midis trëndafilave dhe po luaj me bletët. Varrin ma blenë, por shpirti im është i lirë, atë s’e ble dot askush!”

Me thirrjet e tij mbas shpine, të dy, burrë e grua u larguan të zhgënjyer e më të hidhëruar se më parë, të mbështetur

Nga ANDREA LLUKANI, Tiranë

# Kontributi i Teologut Theofan Popa në shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare

Theofan Popa ka lindur më 3 nëntor të vitit 1914, në lagjen Kala të Elbasanit në një familje zanatçinsh. Pasi përfundoi shkollën fillore Kostandin Kristoforidhi, me ndërhyrjen e atë Josif Mihalit mundi të sigurojë një të drejtë studimi për në Seminarin Teologjik "Joan Teologu" të Cetiës në Manastir. Pasi përfundoi seminarin në vitin 1936 u kthye në Shqipëri dhe pas një viti me mbështetje e Kryepiskopit Visarion Xhuvani mundi të siguronte një bursë për të ndjekur studimet e larta në Fakultetin Teologjik të Universitetit Kapodistria të Athinës, në vitin akademik 1937-1938, me bursë nga fondacioni Jovan Banka. Ndërkohë në Shqipëri ndodhën ndryshime të mëdha përpara i përket organizimit kishtar. Më 12 prill 1937, Patriarkana Ekumenike shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u zgjodh Kristofor Kisi. Sapo përfundoi vitin e parë të fakultetit, Theofani mori një letër nga Kryepeshkop Kisi, me anën e së cilës i thuhet se duhej t'i ndërpriste studimet në Athinë, për t'i vazhduar në Kolegjin Anglikan „Ngjallja e Krishtit“ në Londër. Pasi qëndroi vetëm disa muaj në Londër (gusht-tetor 1938) u kthye në Athinë për të vazhduar studimet, të cilat i përfundoi në vitin 1941. U kthye në atdhe më 1942 dhe filloi punë në Liceun e Korçës si profesor i gjuhës latine.

Më 1945 Theofan Popa u transferua në Tiranë ku punoi si predikues dhe artikullshkrues pranë Kryesisë së Kishës Ortodokse. Theofani botonte një buletin dyjavor me predikimet e të dielave, i cili u dërgohej kishave ortodokse të Shqipërisë. Gjithashtu teologu Theofan Popa ka hartuar librin e inventarit të bibliotekës së Kryesisë së Kishës Ortodokse. Në korrik të vitit 1945 u themelua Lidhja e Teologëve dhe e Seminaristëve të K.O.A.Sh-it. Qëllimi kryesor i kësaj Lidhjeje ishte që të kontribuonte në përparimin dhe lartësimin e Kishës Ortodokse Autoqefale. Në kryesinë e lidhjes u zgjodhën: Sofir Kanxheri, Dhimitër Beduli, Ilia Stavre, Vlash Semini dhe Arkile Kondi. Kryesia zgjodhi si kryetar të lidhjes teologun Theofan Popa. Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve të K.O.A.Sh-it hartoi statutin dhe rregulloren e saj dhe ligjëroi stemën e vëlën. Qendra e lidhjes ishte në Tiranë, por u krijuan degë nëpër rrethe si në Durrës, Korçë, Shkodër etj. Me vendimin e Gjykatës së Tiranës datë 19 shtator të vitit 1945, Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve të K.O.A.Sh-it u ligjërua zyrtarisht. Kryesia e lidhjes më 24 shtator 1945 i shkroi një letër Sinodit të Shenjtë, me anë të së cilës i parashtronte synimet e saj. Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve të K.O.A.Sh-it pikëpamjet e saj i shfaqti në broshurë me titull „Ç'është dhe çfarë kërkon Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve ortodoksë“. Për disa motive, të cilat kanë mbetur ende enigmë, në vitin 1947, Theofani e larguan nga kisha. Sipas një raporti të sigurimit të shtetit arsyjeja e largimit të Theofan Popës nga kisha ka qenë konflikti që ka pasur me Sekretarin e Përgjithshëm Z. Niko Çane, përpara i përket përmbajtjes që duhej të kishin predikimet fetare.

## VEPRIMTARIA NË Mbledhjen e mbishkrimeve dhe objekteve kishtare

Në vitin 1948 Theofani ka punuar si përkthyes i serbokroatishtes në Ministrinë e Financave, ndërsa më 1949, u sistemua në Institutin e Shkencave, në Sektorin e Historisë së Mesjetës, ku e ngarkuan të merrej me studimin e ikonave dhe të afresqeve kishtare. Duke bashkëpunuar ngushtë me bizantinologun ruse Viktori Puzanova, Theofani punoi me zell për evidentimin dhe sistemimin e mbishkrimeve kishtare. Gjatë viteve 1950-1967, falë njohurive të thella teologjike që kishte marrë në Universitetin Kapodistria të Athinës, Theofan Popa u mar me deshifrimin e mbishkrimeve të vjetra nëpër kisha, ikonostase, amvone, ikona etj. Në vitin 1950 Theofan Popa filloi punën për evidentimin e mbishkrimeve dhe ikonave të shek. XII-XVI, duke filluar me kishën e Shën Stefanit në Himarë, trapezarinë e manastirit të Apolonisë, kishën e Shën Mërisë së Vllahernës në Berat etj. Në vitin 1951 shkoi në zonën e thellë malore të Shpatit në rrethin e Elbasanit, në kishën e Shën Nikollës në Seltë, në kishën e Shën e Premtes në fshatin Valës, ku zbuloi mbishkrimet e Onufrit. Më 1953 vizitoi kishën e Shën Kollit në Voskopojë, ku zbuloi veprën ikonografike të David Selenicës. Në vitin 1954 u mor me piktorin Kostandin Shpataraku, i cili ka pikturuar kishën e Shën e Premtes në Çetë të Kavajës, kishën e manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, kishat e Vithkuqit etj. Më 1955 shkoi në zonën e Myzeqesë, duke vizituar kishat e fshatrave Vanaj, Karavasta, Bishtqethëm, Kadipashaj, Kozarë, Krutje, Toshkëz etj., ku gjeti ikona dhe mbishkrime të vëllezërve Çetiri. Në vitin shkoi në veri të Shqipërisë ku vizitoi kishën e Rubikut dhe atë të Vaut të Dejës. Më pas vizitoi ki-



shën e Shën Mërisë në Maligrad të Prespës, vizitoi kishën e Riztozit në Mborje të Korçës etj.

Libri i tij i jetës është Mbishkrime të kishave në Shqipëri, botuar nga Akademia e Shkencave dhe Institutit i Historisë, në vitin 1998, pra pas 13 vjetësh nga vdekja e tij. Botimi përfshin rreth 1000 mbishkrime kishtare, pjesën më të madhe të tyre do ta gjeni të përfshira në brendësi të kësaj monografie. Mbishkrimet paraqesin të gjithë materialin epigrafik të kishave monument kulture të vendit tonë. Ato datojnë që nga shek. IX deri në shek. XIX. Në librin Mbishkrime të kishave në Shqipëri Theofan Popa ka përdorur edhe mbishkrimet që janë botuar nga autorë të tjerë në kohë të ndryshme, ndër të cilët mund të përmendim këta: Jan Papa, Johan Hahn, Theodor Ippen, Stojan Navakov, Panajot Pulica etj. Për përktimin e mbishkrimeve me përmbajtje liturgjike ka përdorur përktimit e librave liturgjikë të Nolit, ndërsa për përktimin e mbishkrimeve me përmbajtje biblike ka përdorur përktimin e Kristoforidhit. Disa nga mbishkrimet kishtare shoqërohen me fotografi ose klishe të transliterimit, me transkriptimin e tyre, duke i shoqëruar me komentet përkatëse. Mbishkrimet kishtare përmbajnë të dhëna të rëndësishme në lidhje me ndërtimin, rindërtimin dhe pikturimin e kishave. Duke lexuar mbishkrimet kishtare gjejmë emrat e këtorëve, piktorëve, mjeshtrave të ndërtimit, gdhendësve të ikonostaseve si edhe emra klerikësh e laikësh që kanë financuar për ndërtimin e kishave.

## KONTRIBUTI I THEOFAN POPËS PËR MUZEOLLOJINË SHQIPTARE

Me krijimin e Institutit të Shkencave në vitin 1947, iu kushtua vëmendje e posaçme grumbullimit të kulturës materiale, që kishte mundur të shpëtonte deri në atë kohë nga grabitjet e ushtrive pushtuese. Në këtë mënyrë rrjeti muzeor shqiptar brenda disa dekadash u shtua dhe u konsolidua. Kulmin e lulëzimit të saj muzeologjia shqiptare e pati në vitet 1980-1982 me ngritjen e tre muzeve kombëtarë: Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë dhe Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti" në Krujë. Theofan Popa është një ndër themeluesit e Muzeut të Ar-

tit Mesjetar në Korçë, i cili u ngrit në themelet e kishës së Burimit Jetëdhënës. Ikonat qenë grumbulluar nga kishat rrethit të Korçës në xhaninë e Mirahorit dhe prej aty u transportuan në ambientet e muzeut. Grupi i punës që u mor me sistemimin e ikonave nëpër pavijonet përkatëse përbëhej nga Theofan Popa, Dhorka Dhomo dhe Pirro Thomo. Numri i përgjithshëm i ikonave ishte 3969. Një pjesë e madhe e ikonave të mbledhura nga Theofan Popa aktualisht gjendet në fondet e Muzeut Historik Kombëtar. Ikonat kanë qenë të grumbulluara fillimisht në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe në vitin 2004 kaluan në pronësi të Muzeut Historik Kombëtar. Fondi i ikonave, i cili përbëhet nga rreth 700 objekte si ikona, pjesëve të ikonostaseve, objekte liturgjike etj. Me ikonat e përzgjedhura nga ky fond në vitin 1999, në Muzeun Historik Kombëtar u hap pavijoni i ikonave me rreth 70 ikona.

Në vitin 1961, Theofan Popa, botoi librin Piktorët mesjetarë shqiptarë, në të cilin përmbledhën piktorët ikonografë si David Selenicasi, Kostandin Shpataraku, piktorët korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi, piktorët grabovarë të familjes Çetiri, si edhe mjaft piktorë ikonografë që kanë zhvilluar aktivitetin e tyre jashtë vendit. Libri Piktorët mesjetarë shqiptarë të shoqëruar me një letër mallëngjyese, më 08.05.1962 ia dërgoi episkop Theofan Nolit në Amerikë. Theofan Popa nuk ishte dakort për prishjen e shumë kishave që mbanin statusin Monument Kulture. Ai gjithmonë thekson rëndësinë e tyre për trashëgiminë tonë kulturore. Së bashku me kolegët Gani Strazimirin, Aleksandër Maksin dhe Pirro Thomon arritën të shpëtojnë rreth 120 kisha dhe manastire, duke iu dhënë statusin e monumentit të kulturës. Theofan Popa ka një veprimtari të gjerë kërkimore e shkencore për evidentimin e vlerave historike të monumenteve të kulturës së popullit shqiptar. Pas ndalimit të lirisë fetare më 1967, Theofani pati privilegjin që të siguronte një leje nga Universiteti i Tiranës për t'u marrë me kishat mesjetare të Shqipërisë.

Në harkun kohor ndërmjet viteve 1967-1975 Theofani u mor me grumbullimin e ikonave dhe të objekteve kishtare, duke i shpëtuat ato nga shkatërrimi. Me interesimin e tij u grumbulluan me qindra ikona, libra liturgjike, veshje priftërore etj. Duke bredhur fshat më fshat dhe kishë më kishë, në shoqërinë e shoferit Ilia Nemçe, Theofan Popa arriti të mbledhë qindra ikona dhe objekte liturgjike kishtare. Në vitin 1974 Theofan Popa botoi librin Ikona dhe miniatura mesjetare në Shqipëri, në dy gjuhë shqip dhe frëngjisht. Teksti dhe materialet e librit janë përgatitur nga Theofan Popa, ndërsa fotografitë janë realizuar nga Pleurat Sulo. Me anë të këtij botimi Theofan Popa u bë i njohur në botë. Nuk vonoi shumë dhe në vitin 1975 atë e ftuan në një konferencë ndërkombëtare në Bullgari, ku mbajti kumtesën: Divergjencat dhe konvergjenca e artit mesjetar në Ballkan.

Persekutimi i teologut Theofan Popa


Në vitin 1954 Theofani u martua me zonjën Eli Mano nga Korça. Një fazë e rëndësishme për veprën e Theofanit janë vitet 1974-1980 kur ai merrej me ruajtjen e kishave dhe të manastireve që gëzonin statusin monument kulture. Në këtë kohë ai punoi pranë Institutit të Monumenteve

të Kulturës. Falë kulturës së lartë teologjike që e zotëronte me kompetencë, Theofan Popa ka bërë mjaft studime rreth artit mesjetar shqiptar, të cilat i ka botuar kryesisht në Buletinin e Shkencave Historike, që botonte Universiteti i Tiranës në atë kohë. Nga kolegët është vlerësuar si njeriu më i aftë përpara i përket artit kishtar. Kolegët kishin cmirë nga puna e tij kërkimore e shkencore. Theofanin e akuzonin se shfrytëzonte detyrën shkencore për të bërë propagandë fetare. Në dosjen e tij ka shumë akuza të papabaza, si për shembull shfrytëzimi i punës shkencore për të bërë propagandë fetare në fshatrak ku shkonte. Organizata e frontit vendosi përjashtimin e Theofan Popës nga fronti, të hiqet nga lagja nr. 8, pasi ndodhet në afërsi të bllokut dhe të vendoset në një lagje tjetër. Mënjerherë pas demaskimit publik, Institutit i Historisë dhe Gjuhësisë ngriti një komision të posaçëm për të shqyrtuar aktivitetin shkencor të Theofanit.

## THEOFAN POPA DHE KRIPTOKRISTIANËT

Theofan Popa frekuentonte mbledhjet e të krishterëve të fshehtë. Ai ka pasur shok të ngushtë episkopin Irine Banushi, teologun Dhimitër Beduli si edhe berberin Koço Fështi, nga Peshtani i Tepelehtës. Megjithë përndjekjet e propagandën ateiste, besimi te Zoti mbeti gjallë në shpirtin e popullit. Kjo duket me sakrificën e martirëve të shumtë klerikë e laikë, të cilët u burgosën, u pushkatuan, u përndoqën por nuk e mohuan Perëndinë. Kisha e nëndheshme funksiononte, në kushtet e një përndjekjeje nga shteti ateist. Madje, kishte prej tyre që pa marrë parasysh rreziqet e panumërta, vazhduan ta mbanin të ndezur flakën e besimit me veprime konkrete, siç ishin atë Kozmai, i cili me Ungjillin e fshehur në një trastë të vjetër shkonte nga qyteti në qytet për të pagëzuar në fshehtësi dhe për të kryer shërbesat e shenja. Motrat Cico nga Korça, të cilat e kishin kthyer shtëpinë e tyre në një kishë të vogël, luteshin vazhdimisht. Theofan Popa, Koço Fështi, Vangjel Plepi dhe Petro Zheji vazhduan të ndiqnin në fshehtësi shërbesat fetare dhe të pagëzonin fëmijët e tyre tek atë Kozmai. Një nga të pagëzuarit në fshehtësi është edhe Joan Pelushi, i cili sot mban titullin Mitropolit i Korçës. Athina Angjellopulu mbajti të ndezur kandilin e kishës së Shën Todrit në qytetin e Vlorës. Muri i shtëpisë së saj përkonte me ajdohimën e kishës, e cila ishte kthyer në repart të Mbrojtjes nga Zjarri. Në shtëpinë e saj grumbulloheshin të krishterët e fshehtë Petro Xhuveli, Mihal Papa, Miti Rrapi, Toli Bubuni, Gori Dumani, Koço Fështi, Sotiraq Andoni, Koço Duni, Klearko Sava, Leni Beli, Harikli Beduli, Evgjani Ballabani, Joan Pelushi, Dhimitër Musho etj, ku luteshin dhe prisnin papa Kozmanë që t'i kungonte me trupin dhe gjakun e Krishtit. Ky i fundit celebronte Liturgjinë Hyjnore gjatë natës në shtëpinë e tij në Bestrovë dhe herët në mëngjes nisej për në shtëpinë e Athinasë, ku e prisnin të krishterët e fshehtë. Në shtëpinë e Dr. Llukës grumbulloheshin për t'u kunguar Kristina Dumi, Rina Sheshi, Qirio Bezhani, Koço Qirinxi, Spiro Duni, Eftali Sota, Jako Qirjako, Zaharulla Marko etj. Papa Kozmai shkonte edhe nëpër qytete të tjerë të Shqipërisë për të vizituar të krishterët e fshehtë. Në Durrës vizitonte Vasil Papastavrin, Vangjel Plepin etj, në Fier shkonte në shtëpinë e Petro Demajt, ndërsa në Elbasan tek Leonora Xhuveli. Në Korçë shkonte te motrat Cico, Pavlina Prifti, Grigor Mulla, Janaq Janku, Goli Remcka, Vito Buçka etj. Në Himarë shkonte në shtëpinë e Petro Xhuvelit. Në Tiranë shkonte te Theofan Popa, Koço Fështi, Dhimitër Beduli, Spiro Findiku, Kristina Papajani, Theofan Popa, Petro Zheji, Joan Pelushi etj. Gjithashtu në shtëpinë e atë Marko Papajani, në Tiranë mbledheshin për të celebruar shërbesat fetare të krishterët e fshehtë Vlash Semini, Dhimitër Beduli, Theofan Popa, Petro Zheji, dhjakon Spiro Findiku, Koço Fështi, Eleni Papajani, Elpiza Xhimitiku etj.

Me gjithë këtë aktivitet kërkimor e shkencor në lidhje me mbishkrimet dhe objektet liturgjike kishtare, Theofani kishte krijuar një reputacion të mirë në rrethet e intelektualëve. Në vitet e fundit të jetës së tij, Theofan Popa ka punuar me kohë të pjesshme në Arkivin e Shtetit. Koha e punës ishte tre orë në ditë, por Theofani nga entuziazmi që e karakterizonte punonte edhe tre orë të tjera pa pagesë. Gjatë viteve që punoi në Arkivin e Shtetit (1983-1985) Theofan Popa hartoi një dorëshkrim me rreth 140 faqe: Katalog i kodikëve që ruhen në AQSH. Theofan Popa ndërroi jetë më 30 dhjetor 1985 në Tiranë, duke na lënë imazhin e një njeriu, që gjithë jetën e tij ia kushtoi ruajtjes së vlerave të trashëgimisë sonë kulturore.





# Në Muzeun Historik Kombëtar çelet ekspozita “Unë jam shqiptar”

Nga Dr. DORIAN KOÇI,  
Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar

Në kuadër të 18 dhjetorit, “Ditës Ndërkombëtare të Emigracionit”, Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën çeli ekspozitën “Unë jam shqiptar”, ku përfshihen materiale fotografike dhe objekte muzeale, që kanë të bëjnë me diasporën shqiptare. 18 dhjetori është caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si “Dita Ndërkombëtare e Emigracionit”.

Ekspozita çelet me fotografinë e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, si përfaqësues i epokës, që shënoi valët e para të emigrimit të shqiptarëve. Vijon me ngulimet arbëreshe në Italinë e Jugut. Gjatë shek. XV kemi valët e fuqishme të emigrimit të shqiptarëve: më 1415-1418, gjatë pushtimit të disa kështjellave të viseve bregdetare; më 1466-1467, gjatë rrethimit II e III të Krujës; pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, më 1468; pas rënies së Krujës, të Shkodrës dhe të Lezhës në duart e osmanëve, gjatë viteve 1478-1479 etj.

Diaspora shqiptare dha kontribute të shquara në lëvizjet kombëtare në shtetet ku u vendos. Arvanitasit u dalluan si luftëtarë të guximshëm të Revolucionit Grek të vitit 1821, duke nxjerrë nga gjiri i tyre figura si: Marko Boçari, A. Kullurioti, Dhaskalina Bubulina etj. Në Itali Garibaldi i ka cilësuar arbëreshët heronj të lëvizjes çlirimtare italiane.

Gjatë pushtimit turk, sidomos në Rilindjen Kombëtare kolonitë shqiptare mbajtën lidhje të vazhdueshme me atdheun dhe kontribuan në lëvizjen kombëtare dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Rilindësit e mëdhenj, duke filluar nga Naum Vegilharxhi, Jeronim De Rada, Elena Gjika, Andon Zako Çajupi, Thimi Mitko, Fan Noli dhe Faik Konica qenë personalitete të shquara të diasporës, që kontribuan në hartimin e programit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Krahas fotografive të këtyre personaliteteve të spikatur nëpër stenda janë ekspozuar edhe mjaft objekte të tyre, ndër të cilët mund të përmendim: kallamarin dhe penën e Jeronim De Radës, stilolapsin dhe stilografin e Asdrenit, kallamarin e Sami Frashërit, obonë dhe



kapelen me të cilën ka marrë gradën “Doktor” Fan Noli etj. Kolonitë shqiptare e vazhduan veprimtarinë e tyre edhe pas krijimit të shtetit shqiptar. Ato e mbështetën atë hap pas hapi në rrugën e konsolidimit të tij dhe në marrëdhëniet me popujt e tjerë.

Emigranti i parë i identifikuar në SHBA zë një vend të parësor në ekspozitë, duke vijuar më tej me fotografi të shoqërive patriotike në Sofje, Bukuresht, Kajro, Stamboll e Vjenë. Diaspora shqiptare pasqyrohet nëpërmjet fotografive të protagonistëve të saj, të themeluesve të shoqërive patriotike: si të Fan Nolit, Faik Konicës, Mit’hat Frashërit. Në një stendë të veçantë është ekspozuar flamuri i kolonisë shqiptare të Rumanisë, ndërsa në stendën që pason gjendet vula e “Shoqërisë Dëshira” në Sofje.

Emigracioni i punës në Shqipëri arriti kulmin në fund të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, të shkaktuar nga proceset e industrializimit dhe urbanizimit të shpejtë në shumë vende europiane dhe në Amerikën e Veriut. Gjatë kësaj periudhe, një numër i madh i shqiptarëve

emigruan për arsye politike dhe ekonomike, si: Gjon Mili, Stavro Skëndi, etj.

Në mars të vitit 1991, pas rënies së diktaturës, më shumë se 24,000 shqiptarë emigruan në Itali. Kjo ngjarje pasqyrohet në ekspozitë, duke na kujtuar momentet e futjes së refugjatëve në Ambasadën Gjermane dhe në vijim largimin e tyre nëpërmjet portit të Durrësit me anijen “Vlora”. Mijëra qytetarë emigruan për një jetë më të mirë, duke lënë pas atdheun dhe të afërmit.

Në çdo kohë veprimtaria ekonomike e emigrantëve shqiptarë mbeti një faktor i rëndësishëm ekonomik në buxhetin e familjeve të tyre. Diaspora ka bërë përpjekje të mëdha për t’u integruar në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendeve ku ka emigruar. Ajo shërben gjithashtu, si urë lidhëse ndërmjet vendit amë dhe vendeve pritëse. Një vend të rëndësishëm në ekspozitë, zënë fotografitë e shqiptarëve të suksesshëm në botë. Diaspora shqiptare është e pranishme kudo në botë. Në shumë nga vendet mikpritëse emigrantët kanë themeluar shoqatat e tyre.

## Paraja...!

nga GENC DEMIRAJ

...Nuk ka para. Nuk ka. Kane mbaruar ato, që ne jemi mesuar ngushtesisht. I kemi patur si gjene me te perdoreshme dhe me te lakmuar... Nuk ka para. E degjojme gjithmone e me shume, perдите, te na e thone apo ta themi. Dhe kur nuk ka, duhet ta mendojme mire dhe ti therrasim radakes se dicka e madhe mungon. Na mungon ne te perditeshmen tone aq sa mund te shpenzojme me pak a mos te shpenzojme fare, te kursejme me pak a te mos kursejme fare, ose te paguhemi me pak a mos te paguhemi fare... Sepse nuk ka para. Te gjithë jemi te shqetesuar, dhe me shume se per politike flasim per parate. Si s’ka, pse s’ka, kush i ka? Fajin ja hedhim krizes dhe gjithë shaktareve te saj. Hamendesojme dhe analizojme me kopetence, inkopetencen e profesionisteve, duke u kotur verberisht ne rebusin e pazgjidhshem se perse nuk ka para... Jemi kthyer si ne prehistori ku gje-ja shkembehej me gje...dhe malli me mall. Po e shkembehej mundin tone ditor, me ndonje kile miell, vaj apo buke!

Nuk ka para, dhe kete nuk kemi si e fshehim... Eshte “meshyer” leku dhe nuk ka drej qe e gjen... Na thone c’do dite qe bolleku na ka kapluar, qe do te shtohen aq dhe kaq perqind rrogat!...por dermani ndaj parase nuk po duket... Dhjete kafe me shume do tu shtohet ne muaj pensionisteve, dy e gjysem ish ushtarkeve dhe nga nje paketen cigare gjithë buxhetoreve te tjere...Kaq eshte shtesa ne rroge e konvertuar ne mall! ...Nuk ka para...dhe kete te gjithë ne po e shohim dhe po e ndjejme... Po fundja kur kemi patur? ...asnjehere... Na kane dhene sa per gajret. Sepse paraja c’mend dynjane... Te kesh para, kane kenduar parodistet, nuk je i sigurte...Te mos kesh para, je mender nje mut... Por qe para nuk ka... kesaj i ka vdek nena.



## Disidencë në kohën e Visarit

nga SHPENDI SOLLAKU

Emendoj si tani sesi do te jene shkruar, apo te pakten si do te jene menduar keto vargje te Visar Zhitit: «- Gjysh, o gjysh, çohu...!/- Ç’është, bir?/- Kam frikë se mos nuk zgjohesh më...»Gjyshin e tij e kam njohur mire ne femijeri dhe me ka mbetur ne kujtese si nje burre i moshuar fjalepake, shtatlarte, me hapin e ngadalte kur ecte, por mjaft i zellshem si kopshtar. Kishte syte enigmatike dhe nje veshtrim te thelle, qe ndoshta ne te vegjelve ndonjehere na kallte friken. Sidoqte ishte, mjaftonte qe ai plak i pashem te hapte gojen qe te kuptoje se zeri i tij dilte nga nje shirt qe mbarte miresi te thelle. Kishte nje bahçe te madhe gjyshi i Visarit, ngjitur me shtepine tone, nje gardh na ndante. Nje dericke formale lejonte qarkullimin e tyre deri ne oborrin tone dhe tonin ne bahcen e tyre. Ne fakt edhe çfare prodhonin kopshtet tona mund ta shijonin te dyja familjet. E donte shume token gjyshi i Visarit. Peshperitejt nder femijet qe kish qene i pasur, qe kish patur toka te mëdha andej nga Devolli, prandaj bente aq shume per kopshtin e tij. Ne te vegjelve nuk na duhet te dinim nese kish qene apo jo kulak, na mjaftonte idea qe, meqe e donte kaq shume kopshtin e tij, patjeter qe duhet te kish humbur kushedi sa toka andej larg Lushnjës. Kur Visar Zhiti botoi poezine e mesiperme, ne mos gaboj ne nje numer te revistes «Nentori» te vitit 1972, ne adoleshentet e lagjes se tij i lidhem menjehere ato vargje me portretin dhe origjinen e gjyshit te tij. Kishim filluar edhe ne te shkruanim edhe te botonim tekut ndonje varg. Qe Visari perdorte alegori ne ato vargje, per fat te keq nuk na kish rene ne sy vetem neve, fqinjeve te tij. Ato vargje u perdoren me vone edhe ne akuzen qe iu ngrit poetit tone ne gjyqin e montuar qe e dergoi ne qeli. M’u kujtuan keto detaje ndersa lexoja nje shkrim te dikujt rreth ekzistences apo jo te disidencen ne Shqiperi ne vitet e diktatures. Autori ngulte kembe se nuk ka pase patur. Une, nderkaq, ngul kembe se ka pase patur dhe te mjaftueshme, te botuar apo te mbetur sirtareve, te drejtperdrejte apo alegorike. Kjo poezi edhe mjaft shembuj te tjere prej vargjeve te Visarit apo te bashkohesve te tij, ishin deshmii e qarte se, edhe pas vargjeshe te tilla ne dukje epigramatike, fshiheshin idera te medha: Ç’beni, u zuri gjumi? Harruat se kush jeni?

A ka disidencë me te qarte se kjo, pavaresisht nga mjetet artistike te perdorura?

## Unë jam nga Shqipëria

Nga ARIANA HOXHA

Gjithmon do te mbetet pergjigja ime “Unë jam nga Shqipëria”. Nje shprehje qe buron nga shpirti ashtu sic buron dhe rrjedh nder shekuj kultura dhe historia e kombit tone. Prej vitesh jetoj, studioj ne Itali, por te shpjegoj gjuhen shqipe femijeve shqiptare te lindur dhe rritur ne qytetin e Macerates per mua eshte dhe do te jete gjithmone nje privilegj. Ne cdo pellembe toke te ketij qyteti eshte shkruar historia e mesjetes dhe universiteti i themeluar ne 1290 ka qene dhe do te mbetet kulti i dijes qe pret e percejll breza te tere studentesh. Seminarat qe zhvillohen jane te shumte por te lexosh titullin e seminarit “The transition of Albania economy achievements failures and challenges” sikurse edhe emrin e te ftuarit te nderit “Arben Malaj” ne Fakultetin e Ekonomise, tek shqiptaret ngjalli nje ndjenje te vecante. Aula Blu tek Polo Pantaleoni u mbush nga student italian dhe te huaj, por ne rradhet e para qendronin studentet shqiptare.

Nje vajze e ardhur prej pak ditesh nga qyteti i Vlores per te kryer doktorrraten u afrua prane nesh e emocionuar duke thene:”Sa bukur, ketu flitet shqip!” Te perqafuar se bashku ne dhe te huaj, por me ndjenjen e forte te atdhedashurise, ndiqnim me interes seminarin e drejtuar nga profesor Arben Malaj. Nje seminar i zhvilluar ne gjuhen angleze, por qe trajtonte ndryshimet ekonomike te Shqiperise duke filluar qe nga viti 1991, fillimi i nje periudhe te re historike. Nepermjet materialeve pasqyrohej lidhja ekonomike dhe kulturore ne shekuj ndersa nepermjet dialogut profesori shpjegonte: “Eshte nder te jem prezent ne nje universitet te hershem ne Itali dhe Europe. Sot me jepet mundesia t’ju flas per Shqiperine, vend i pajisur nga bukurite natyrore qe ia vlen te zbulohen. Ju siguroj nese vizitoni atdheun tone nuk do te ndiheni ne veshtrise, ne radhe te pare nga mikpritja e shqiptareve dhe se dyti sepse ata kane aftesine e komunikimit ne gjuhen italiane. “Ne mbyllje te seminarit profesor Arben Malaj dhe profesor Roy Cerquetti shkëmbyen ne

shenje miqesie dhuratat tradicionale. Dhuratat te sjella nga Shqiperia ishin dy libra qe paraqisnin kulturen antike te territorit dhe Kanunin e Leke Dukagjinit dedikuar rektorit te universitetit “Francesco Adornado”. Pas seminarit te gjithë sebashku morem rrugen drejt ambienteve te bibliotekes “Mozzi Borgetti” ku cdo te shtune zhvillohet mesimi i gjuhes dhe kultures shqipe. U mirepritim nga drejtoresha e bibliotekes dhe nga nenkryetarja e komunes se qytetit: Prof. ssa



Stefania Monteverde e cila perkrah komunitetin shqiptar ne shume aktivite. Gjate bisedes nenkryetarja shpjegoi binjakezimin me bashkine e qytetit te Gjirokastres, sikurse edhe bashkepunimin me universitetin “Egerem Cabej” fale punes se profesor Roberto Perna duke filluar nga viti 2005 per sa i perket studimeve arkeologjike. Nderkohe qe po benim foto prane flamurit krijuar nga nxenesit shqiptare, veshtrimi nuk mund te ishte indiferent ndaj veprave te profesorit Silvio Craia (Kraja) qe ndodhen ne biblioteken komunale. Ai eshte arberesh qe me krenari shprehet: “Origjina ime eshte shqiptare”. Silvio ndodhet gjithmone prane nesh duke festuar festat kombetare. Familja e tij u shperngul nga Arberia ne vitin 1604 ne Corridonia Marche. Pikerisht ne rrugen kryesore te qytetit te Macerates “Corso Caioli” ndodhen nderesat e mesjetes “Le sasette” te ndertuara nga arbereshet. Profesor Malaj gjate degjimit te historise u shpreh: “Dy popuj dhe dy histori qe gershetohen ne shekuj”. Nje dite e mbushur me aktivite per te kultivuar dhe zhvilluar ekonomine, kulturen tone si nje pasuri per brezin e se ardhmes.



## Në qendër te Maceratës mësohet gjuha shqipe

Nga ARIANA KOSOVA

Dje pasdite po shpjegoja mesimin e gjuhës shqipe. Dy zotërinj po shihnin me kureshtje nga jashtë. Erdhën brenda tek biblioteka dhe njëri prej tyre më tha: “ Mirëmbërëma quhem Gjok Bici,jam nga Lezha. Kam dy javë ne Itali tek vajza por kjo ishte surpriza më e bukur e pushimeve. Kam punuar arsimtar 47 vjet,30 vjet kam qenë drejtor shkolle në Shqipëri,por emocionin më të fortë e ndjeva sot. Nga jashtë shihja flamurin shqiptar dhe nuk i besoja syve. Në qendër te Maceratës mësohet gjuha shqipe”. Me lotë në sy bënte foto materialeve didaktikë. Isha sebashku me dhëndrrin e tij italian. Na premtoi se në shkurt do të kthehej përsëri në Macerata dhe do te ishte midis nesh. I emocionuar u largua nga ambientet e shkollës duke thënë: “Zoti ju bekoftë ju që mbani gjallë vlerat,kulturën dhe gjuhën tonë!”

# Toka e djegur, shpirti i përvëlur...

Nga FAHRI KHARRA

Do të shetisim pak nëpër "Arnaut-lëk", dhe t' i kujtojmë do toka mbi të cilat dikur flitej shqip, frymohej shqip dhe jetohej shqip. Në mes të Prishtinës dhe Nishit (Nisusit) dhe në perëndim të Leskovcit është një tokë që sot quhet Pusta Reka, që sot jetojnë jetojnë serbët dhe i thonë Serbi. Është vetëm një pjesë nga pjesa e madhe deri te Molla e Kuqe, ku dikur flitej dhe jetohej shqip. Nuk e kam për qëllim që me anën e këtij shkrimi që t' i lypë dikujt diçka, por vetëm t' a bëjë të dijtur se dikur e jo fort largë në kohë, ishim ne aty. Na dogjën aso kohe, na shkumbuan, na vranë dhe vetëm dikush munda munda të ikë e të shpëton vetëm shpirtin e thatë. Toka të djegura e të përculluara mbetën vetëm. Edhe vetë ardhacakët serb, kolonët e quajten këtë regjion Lumi i Shkretë, jo pse lumi ishte i shkretë e natyra po ashtu e shkretë, por u shkretuan dhe u shkumbuan për t' i larguar Arbanasët nga tokat e tyre. Rritje me dhunë e hisës së tyre në dëm të riparueshëm të Arbanasëve.

Ishim Arnaut atëherë. Edhe pse frymonim shqip, Evropa na njëfte vetëm si Arnaut. S' ka gjë të keqe pse ishim arnaut, por bota nuk e dinte se mbas këtij emri janë Shqiptarët. Pushtuesi parë (turku) nuk interesohet dhe nuk donte që t' i tregonte botës se i kishte robëruar shqiptarët, dhe Evropa mendonte se ishim ardhacak, "popull i ri" në tokat e vjetra të Evropës. Pushtuesi i parë me vetëdije të plotë dhe në bashkëpunim të sinqertë me pushtuesin e dytë (serbin) i planifikuan planet e tyre për zhbërjen tonë nga tokat tona...

"Evropa alarmohej se po liroheshin tokat nga turqit". Ishte viti 1877. Evropës i vinte fllad se serbët po e kryejnë një mision të mirë të pastrimit të Evropës nga Turqit. Ishte plan ky, plan i mbrapshtë në marrëveshje në mes turkut e serbit, kurse shqipëtarit ende nuk kishte gojë. Nuk kishte gojë sepse nuk donte të shkëputej pak dhe një herë e përgjithmonë nga robëria shumë shekullore. I pëlqente. Ia kishte andja, dhe vështirë i dilte gjumi nga ai koshmar (ankath) i gjatë dhe sfilitës. Çdo gjë i pëlqente vetëm me kusht mos të i prishet ëndërra shumëshekullore. Në Europë filluan lëvizjet, filluan tërmetet, por ne kurrsesi të kthjelloheshim. Nuk po iu shoh për të madhe shqiptarëve të asaj kohe, kur të njëjtat ëndërra po i shofin disa edhe sot.

Evropës i ishte mbushur mendja. Keq i ishte mbushur mendja. Ia kishin mbushur mendjen. Një shkronjëtor politik i njohur më thosh një ditë (Faik Konica): "Evropa nuk do ta kish dhënë Vranjen e Leskovcin te Serbia dhe Ulqinin te Mali i Zi, sikur të kish kuptuar që ka një komb shqipëtar të ndryshëm nga të Turkut. Po u lajthit puna e besës [ndërhyri puna e fesë] ???"

Lufta Turko-Serbe e vitit 1877

Çka shkruajnë serbët? "Imperatoria Otomane, e bënte kolonizimin e Ballkanit me musliman (R. Nikoliq), dhe në këtë mënyrë iu ndihmonte atyre që të përhapeshin nëpër gadishull, si që ishte edhe rasti me vendosjen e shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni dhe Toplicë?(Pikëpyetja e ime). Muslimanët kolonizojshin sipas një plani të caktuar, në mënyrë që të bënin ndarjen e homogjenitetit të Krishter. Kështu vendoseshin popujt e pa dëshiruar në tokën tonë". Këto shkruheshin e edhe sot shkruhen për ne. Kush po i demanton? Apo më mirë të them: a jemi të atillë që Evropa të na beson?

Të kthehemi tek lufta e cila i parapriu zhbërjes sonë nga tokat tona në Serbinë e sotit. "Forcart Serbe me 15 Dhjetor 1877 u vërsulë në dy drejtime kryesore; Në Jug për të marrur Nishin dhe tjetra në Jug-Perëndim në drejtim të Pirotit. Një pjesë e madhe e ushtrisë serbe vepronte në drejtim të Toplicës (J.H. Vasiljeviq). Serbët e muarrën Prokuplen që në ditën

e tretë të luftës. Muslimanët e qytetit dhe ata të rrethinës së Prokuples, mësë shumti nga ta shqiptarët, i lëshuan shtëpitë e tyre nga panika (?) duke lënë prapa ushqimet e mëdha dhe shtëpitë. Shqiptarët vendas u larguan në malet e Pasjaqës, në jug të Prokuples. Gjatë përparimit të ushtrisë Serbe drejt Kurshumlisë, trupat serbe hasnin në refugjatët shqiptarë, të cilët nuk donin të dorëzoheshin (Popoviq Ç). Fill pas Kurshumlisë, ra edhe Prokupla. "Ishte hapur fjala se forcat turke po vinin me të madhe dhe shqiptarët pritnin më kot "(shkruhej në librat e kohës).

Nishi ra, turqit u tërhoqën dhe shqiptarët s' u kthyen më". (në tokat e tyre fkh) (M.Cj. Miliqeviq; Serbia, tokat dhe banorët.) Kjo ishte një lojë, një "luftë" e marrur vesh. Një poshtërsi e mirë e llogarit. Pushtuesi i mëparmë ia dorëzonte tokat pushtuesit të dytë, dhe banorët vendas, den bab den të vendit nga rrënjët, duhej të zhbëheshin. Kush humbi? Kush përfitoi? Ku mbetën ne? Evropa nuk qante kokën për ne. Lojërat luheshin e ne viktimoheshim.

Po ku shkuan shqiptarët nga tokat e djegura? Në Turqi, po ku tjetër.

Një gjë më bën të habitem, një ngacim që gjithmonë që më grryen; Pse Turqia kurr nuk dual hapas dhe t' i thot botës, e ta thotë të vërtetën historike se neve shqiptarëve na gjeti këtu ku jemi, që nuk na solli nga askundi por përkundrazi na shpërndau neve si qenje dhe na varfëroi nga tokat. Pse nuk ia mbyllë gojën sllavit një herë e përgjithmonë?.

-Pse nuk i tregon botës që ai nuk na solli si musliman për ta "ndarë" krishterimin në mes (siq e thonë serbët) por na muslimanoi për t' i shkruar punët e tij me mirë. -Pse na nuk jemi në gjendje t' i the-


Familjet e Toniqëve dhe Mladenoviçëve) nga Cërna trava, dhe disa të tjerë dhe në brigjet e Lumshkretit formohet mëhalla "Albanija" (Mita Rakiqi: vendi ishte me të vërtetë mbi shkëmb dhe emri i përshtatej natyrës së Shqipërisë)

-Brestovci i Epërm: Ky fshat deri në luftën e dytë botërore është quajtur Arnautski Brestovac (Brestovci i Shqiptarëve), kurse pjesa e epërme e Lumshkretit Arnautluk (Shqipëria), sepse deri më 1878, në këto anë jetonin Arnautët gjegjësisht Arbanasët (shiptari). Brestovci së pari përmendet në shënimet e Fon Hanit me 1859, ku shkruhet se aty jetonin 86 shtëpi shqiptarësh por me emrin Fratovci.

-Vujanovo, fshat me sipërfaqe prej 684 hektarësh, i banuar pas 1878 -tës. Kolonët, kur erdhën e gjetën një fshat arnautësh plotësisht të djegur dhe të shkatërruar. Afër fshatit kalon lumi Vujanovo dha ai i Borinës.

-Konjufca, së Bashku me Konjufcen e poshtme e bëjnë fshatin më të madh të Lumshkretit. Fshatin e përmend, në udhëpërshkrimin e tij "Prej Beogradit në Selanik, albanologu Fon Han me 1858 kur thot se aty ishin 17 shtëpi shqiptarësh, por thonë serbët se këtë fakt duhet marrur me "rezervë", thënjën e Fon Hanit sepse aty jetonin edhe 2 shtëpi serbësh që llogariten si banues të vjetër. Çfarë ironije!

"Arnautlluku", i kishte edhe fashtrat Dobra voda, Donje Konuce, Gjimgjusha, Zlata, Zorovac, Ivanje, Kosanica, Kocaniq, Lapotince, Lozana, Mijajlica, Orane, Prekopolca, Reçica, Shtulac, Turjane, Stublla, Slavnik, Sekicol, Svinjara, Reçica etj, etj., ku me "dhëmbshuri" shkruhet se sa shumë hoqën serbet t' i bëjnë këto fshatra të ribanueshme pasi



mi Europës që na nuk jemi ata të shekujve të kaluar?

Si u shkretua dhe si u ripopullua (me kolonë serbë) Pusta Reka - Lumshkretit?

Bojniku: E kaluara e këtij vendbanimi daton që nga parahistoria, edhe pse gjymët konkrete në sferën e kulturës materiale jenë që nga shekulli i 3-të e epokës sonë. Olga Zirojeviq shkruan: "Ky vend në vitin 1516 u bë pronë e shpërblimit të pushtuesit (timari). Ambasadori dhe albanologu Fon Han shkruan me 1858 se ky fshat i kishte 20 shtëpi shqiptare. Në kohën e turkut, kishte xhami. Mita Rakiq, në librin e tij: "Iz Nove Srbije (Nga Serbia e Re)" tregon se Bojniku në vitin 1879, menjëherë pas çlirimit nga shqiptarët (arbanasët) edhe pse "i vendosur në një vend të bukur ishte një fshat i mjerë me disa kulme të mjera".

Po sigurisht që ishte vend i mjerë se aty ishin takuar njeriu me bishën, dashurija me urretjen, i pafajshmi me krimin, bukurija me shëmtinë, fëmijë dhe të palindurit me vrasësit, errësira me dritën. Nuk ka fjalë që mund të përshkruajnë dhëmbjen e madhe të shqiptarëve të Lumshkretit. Vazhdojmë:


-Bregovina: Pa luftës turko-serbe të 1878-tës, në gërmadhat e një vendbanimi arnautësh, vijnë kolonët e parë (

që "arnautët" i kishin lënë të djegura, të rrezuara dhe të shkreta (?) Shikoni për shembull për fshatin Ivanje, shkruhet se serbet e parë që erdhën këtu ishin ata që erdhën në vitin 1880-1885, duke e gjetur një fshat të djegur shqiptarësh. Me këtë kuptohet se Serbia nuk kishte banorë të vet për t' i kolonuar fshatrat shqiptare. Tokë sa të duash, por serb jo. Tokë sa të duash, tokë shqiptare.

Me mijëra libra, dhe përkthime të atyre librave në shumë gjuhë të Evropë janë shkruar nga serbët për ato toka, janë shkruar dhe Evropa lexon, e libri mbetet. E me librin edhe gënjeshtro serbe. Shqiptarët nuk i lernin tokat nga dëshira por nga dhuna, nga masakrat e nga vrasjet. Toka e djegur dhe shpirti i përvëlur i shqiptarit që vazhdimisht i duhej të lëvizte të ikete që vetëm e vetëm të shpëtojë shpirtin e shkal-luar dhe të riçelë si lulja e humber nëpër tokat e huaja. I përdjekur gjithëmonë.

Po sigurisht që ishte vend i mjerë se aty ishin takuar njeriu me bishën, dashurija me urretjen, i pafajshmi me krimin, bukurija me shëmtinë, fëmijë dhe të palindurit me vrasësit, errësira me dritën. Nuk ka fjalë që mund të përshkruan dhëmbjen e madhe të shqiptarëve të Lumshkretit.

E ne ende heshtim...!



## Ekspozita 105-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë në Muzeun Historik Kombëtar

Nga Dr. DORIAN KOÇI  
Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar

Më 28 nëntor 2017, në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar u çel ekspozita "105-vjetori i shpalljes së Pavarësisë", e cila u organizua nga Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Qendrën Mbarëkombëtare të Koleksionistëve të Shqipërisë. Objekti kryesor i kësaj ekspozite tematike ishte pena, me të cilën është nënshkruar Akti i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ndonëse është një objekt i vogël pena ka një rëndësi mjaft të madhe për historinë e shqiptarëve. Në pjesën ballore të ekspozitës gjendeshin 40 foto të patriotëve shqiptarë, që nënshkruan Aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Anash firmëtarëve janë ekspozuar sipas radhës kronologjike flamuj të periudhës së Pavarësisë.

Objekt tjetër me rëndësi është aparati telegrafik mors, me të cilin Qeveria e Përkohshme e Vlorës ka marrë e ka dhënë telegrame gjatë periudhës 1912-1914. Aparati telegrafik ishte i modelit Czeija, Nissl u Co., Vienna. Në stenda janë ekspozuar objekte të dy protagonistëve të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemalit dhe të Isa Boletinit. Ndër objektet e Ismail Qemalit mund të përmendim një flamur të vogël si edhe një gotë uji të perdorur prej tij. Nga objektet e Isa Boletinit bie në sy xhamadani, i cili ka ardhur në Muzeun Historik Kombëtar në maj të vitit 1982. Pas vrasjes së Isa Boletinit nga forcat malazeze Adem Boletini i mori reliket e tij dhe i fshehu ato në murin e shtëpisë së vjehrrit të tij Hasan Bekteshi. Pas shembjes së shtëpisë së Hasan Bekteshit, dolën në dritë një numër objektesh ndër të cilët bie në sy xhamadani dhe një revolver me mulli Gasser, model 1873. Ky lloj revolveri ka qenë prodhuar për oficerët e ushtrisë austro-hungareze. Revolveri është i zbukuruar me motive floreale dhe figura gjeometrike të vogla në formë rombi.

Nga objektet e Luigj Gurakuqit janë ekspozuar ora e dorës, që i përket markës "Diana", stilografi dhe një vulë e përdorur nga Luigj Gurakuqi. Në pjesën fundore të vulës janë gdhëndur dy gërma L. G. Në vitrinë janë ekspozuar edhe dylbitë e Pandeli Cales, të cilat i janë dhuruar Muzeut Historik Kombëtar nga e bija e tij Konstancia Prodani. Gjithashtu janë ekspozuar edhe syzet dhe një vulë e përdorur nga patrioti Thanasi Floqi. Vulën e ka dhuruar në Muzeun Historik Kombëtar, z. Vasil Floqi, i biri. Në stendat e tjera gjenden dorëshkrime origjinale, gazeta e revista të asaj periudhe etj. Një vend të rëndësishëm në ekspozitë zënë flamujt e shoqërive atdhetare, të cilat ndezën dëshirën e patriotëve shqiptarë që Shqipëria të ishte e lirë dhe e pavarur.

Për ngritjen e flamurit kombëtar atdhetarët shqiptarë u ndeshën me pengesa dhe vështirësi të shumta. Më 5 nëntor 1912, Ismail Qemali mbledhi atdhetarët shqiptarë në hotelin "Continental" të Bukureshtit, ku u diskutua për pavarësinë e Shqipërisë. Figurat më të rëndësishme të asaj mbledhjeje qenë Asdreni, Spiridon Ilo, Vasil Zografi, Pandeli Evangjeli, Luigj Gurakuqi, Dhimitër Berati etj. Ata vendosën që të mbahej një Kuvend Kombëtar me përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Në mbledhje u diskutua për flamurin kombëtar dhe u vendos që të ishte ai flamur që pati ngritur Gjergj Kastrioti në Krujë.

Punimet e Kuvendit të Vlorës filluan më 28 nëntor 1912 në orën 15:30 në sarajet e familjes Vlora, me pjesëmarrjen e 78 delegatëve. Kuvendi i Vlorës vendosi: "Shqipëria të bahet më vehte, e lirë dhe e mosvarme". Pas nënshkrimit të Aktit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemali doli në ballkonin e shtëpisë, ku zhvilloi punimet kuvendi dhe valëviti lart flamurin kombëtar. Duke folur për flamurin, Faik Konica thotë: "Flamuri përmbledh kujtimet e shkruara të një kombi në një gjuhë të pashkruar, që mund ta kuptojë syri dhe zemra e çdo njeriu me ndjenja".

Ekspozita qëndroi e hapur nga data 28 nëntor deri më 4 dhjetor 2017 në hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar.

# Një libër poemë për Prishtinën

Nga XHEMAIL PEÇI

Veptrat dramaturgjike të Henrik Ibsneit janë quajtur nga bashkëkombësit e tij si ca simfoni hyjnore. Fjalori i Kantsantin Nelko Kristoforidhit (babait të gjuhë shqipe) në tërësinë e tij, është quajtur një poezi në vete. Së këndejmi mund të thuhet se libri i Sanije Gashit Prishtina e fëmijërisë sime, është një libër poemë për Prishtinën.

Në një cep të Ilirisë së Poshtme, siç do të thoshte Mitrush Kuteli, e në një sfond të Shqipërisë së Jashtme, siç do të thoshte Lasgush Poradeci, publicistja e prirjeve të veçanta krijuese, e vendos Prishtinën si një emblemë ilire në sfondin e një gjeografie - pajisur jo vetëm me pamje të fotografive por edhe stolisur me kujtime të një fëmijërie, me të cilat ajo qytetit të saj të lindjes dhe të rritës ia falë përmasat e një përjetësie.

Duket sikur që të dyja kanë bërë një marrëveshje të pashkruar, një pakt të heshtur mes tyre. Duket sikur Prishtina i ka thënë qytetares së vet se do ta marrë për dore që në fëmijëri të saj, e do të ecë ashtu së bashku me të derisa ajo të vijë në ditën kur do t'ia kthejë borxhin këtij qyteti: duke e marrë tani për dore Prishtinën e fëmijërisë së saj dhe duke ecur së bashku dorë për dorë: në shpallim të viteve të fëmijërisë e të dashurisë së madhe që ka për të!

Në këto kalldrëme kujtimesh, tek ecin ashtu së bashku dhe dorë për dorë, Prishtina dhe publicistja, sikur shkrihen me njëra-tjetrën, sikur mishërohen mes tyre tek ndjekin njëra-tjetrën në rrugëtimin e tyre të përhershëm.

Që të dyja, duke ecur në shtegun e kujtimeve të fëmijërisë së publicistes, fillimisht ecin si dy motra binjake, e pastaj bëhen një.

Në kujtimet e fëmijërisë së saj, e në mënyrë të veçantë në shpallimin e këtyre kujtimeve si gazetare emblemë, autorja e librit e ka shfaqur në sfond Prishtinën, sa të dashur po aq edhe të bukur: herë si një kukull, herë si një shtojzovalle, e herë si të veshur me një vello nusërie!

Në këto kalldrëme kujtimesh, në këto fletë fëmijërie, në këto kronika kohësh, në këto qëndisje gjithë mall e frymëzim, gjithë dashuri e përkushtim, të projektuara në prizmin dje dhe sot, publicistja vihet në mbrojtje të vlerave kulturore e arkitektonike.


Ajo lëshon kështu zemër-klithjen e saj që ato të ruhen, por njëkohësisht lëshon edhe zemër-thirrjen e saj që Prishtina të jetë ajo që meriton.

Në poetikën e ligjërimin të saj publicistik, ajo ngjitet tek maja e Veternikut dhe kundron nga kodra e Arbërisë, shikon dhe sodit - siç e thotë vetë "me sytë e kujtesës" pamjet që i shfaqen përpara, pamjet e qytetit të dikurshëm të fëmijërisë së saj, dhe sheh "imazhe përplot diell".

Në këto pamje dhe në këto imazhe me ngjyra ylberi shpaloset Prishtina, një emër të cilin publicistja e mbanë thellë në zemër që nga fëmijëria e saj.

Ajo bëhet bashkudhëtare e saj në rrugën e madhe të jetës dhe të dritës.

Me një memorie të freskët, me një kujtesë të habitshme, me një dashuri të rrallë, autorja e monografisë për Prishtinën hyn sërish në lagjet dhe rrugicat e fëmijërisë së dikurshme, përshkon sheshet dhe bulevardet, shuan etjen tek krojet dhe gjen paqe tek gjelbërimet ("oaza gjelbërimi e bukurie"), kujton çezmat e shumta e rrjedhën e krojeve, nxjerr në sfond konceptin e shtetit përmes bashkëbiseduesve dhe kujtimeve të tyre, zbrit në lashtësinë e shekujve dhe shpalos përballjen e vendase me pushtuesit, kujton përpjekjet titanike të shqiptarëve për të mbijetuar dhe për t'u çliruar nga të gjithë ata që sa padrejtësi-



isht po aq edhe mizorisht ua kishin zënë frymën; rikthehet në kujtesë e përpara i shfaqen "sepetet me ushqime", flet gjithë mbresa për "buzëmbremjet idilike të shatërvani", ndalet me shumë finesë tek: "Kapali Çarshia, hijeshi e qytetit", kërkon gjurmë të humbura dhe ndjenë mall për ato kohë të lumtura, përshkon rrugicat e shtruara me gurë e kujton me nostalgji tek ecte në fëmijëri atje tek Zona e Pazarit të Vjetër ose Mëhalla e Tregut, ndalet tek ato shtëpi të vjetra e që i shfaqen dhe rishfaqen në kujtesë si ca kaikë të vockla por aq shumë të dashura, dhe me ca buqeta fjalësh përshkruan vatrën e ngrohtë familjare shoqëruar me një poetikë permallimi: "Në këtë rrugicë, të shtruar dikur me guralecë, vende-vende edhe pa ta, çdo gjë i takon së kaluarës. Në fillim të sokakut, në të majtë ishte shtëpia e vjetër e prindërve të mi..." (PFS, f. 66), flet për pamjet e brendshme dhe të jashtme të shtëpive (kujton mangallin me prush apo edhe "dronjat e punuara në vek/tezgjah" (PFS, f. 75), kapixhikët dhe sabah-qejfet e zonjave të Prishtinës - kur "laheshin shtigjet e shtruara me gurë" (PFS, f. 77) dhe kur "dinin të bënin pikën e sefasë" (PFS, f. 77), kujton aromën dehëse të lule-shebojës si dhe "trëndafilat llojesh e sojesh të ndryshëm" së bashku me "zambakët erëkëndshëm", duke u shprehur me krenari të ligjshme se: "Ishte një kolorit mahnitës.", vë në pah tendencën e njohur për t'i konvertuar shqiptarët në turq si dhe shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, dhe aty-këtu edhe kthimin e ndokujt; kujton zanatçinjtë e mrekullueshëm e gjithë përkushtim, dhe rishfaq në kujtesën e brezave du Marigo Postjet e Prishtinës, qëndistaret e flamurit kuqezi: "Gruaja e familjes së Alibegëve-Remzia, si dhe Nixhare Batalli (e tjetërës lagje), do t'i qëndisin, me sa dihet, flamujt e parë kuqezi në Prishtinë." (PFS, f. 81)

Sakaq, në gjithë këtë kolorit përs-hkrimesh, në të cilin buqetat e fjalëve shkrihen në një me buqetat e luleve, të cilat ajo i përmend me një kujtesë të habitshme e një nga një: "sardonët (mëllagat), menekshetë (lulevjollcat), meshet (krizantemat), lulezjarrin lulebombone, lulevathi, lulekënat, zymbylet, jargavanët, fexlixhenët..., lule këto që po i mbushnin oborret e qytetit, varësisht nga stina." (PFS, f.77), duke përshkruar me tutje edhe ditën e pazarit plot gjallëri e ngjyra jete.

Duket sikur këto lule i ka ruajtur me aq kujdes në rrugëtimin e saj me qytetin e lindjes, sa të bëhet sikur i ka premtuar kryeqytetit se do t'i marrë e do t'i ruajë tërë jetën, për t'ia kthyer një ditë në formën e një tufë lulesh, tufë të cilën rrallëkush ia ka falur Prishtinës si publicistja Sanije Gashi.

Në një mishërim si ky, zë vend edhe shkëlqimi i rrezeve të diellit në kohën e fëmijërisë:

"Sa shumë kujtime janë të palosura në atë mëhallë, në atë oborr të Emixhikëve, me gjithë lojërat e fëmijërisë së pastër, të pagajle, me atë shkëlqim të diellit, që nuk ndodh në vitet e pjekurisë." (PFS, f. 80)

Ajo kthehet mbresa në kohë për të ecur sërish në Mëhallën e Kullës së Sahatit, prej ku ka shumë kujtime dhe përjetime, kujton dyert dhe dritaret e Gjinnazit ("Gjinnazi që rrezaton kulturë"), renditë fotografitë e përfshira një nga një me aq kujdes dhe shije, shpalos kujtime gjithë mallëngjime, sjell në kujtesë ecjen nëpër sokakët e dikurshëm, gjallërinë në shëtitoren e qytetit, pastërtinë dhe rendin, rregullin dhe dashurinë që kishin njerëzit për njëri-tjetrin, vë përballë kohët mes tyre: dashurinë që kishin njerëzit dje dhe mungesën e ngrohtësisë njerëzore sot, vë kundruall njëra-tjetrës: Prishtinën e vjetër "në ato kohë të perënduara" (PFS, f. 48) dhe Prishtinën e re në këto kohë të moderuara, arkitekturën e vjetër dhe ndërtime moderne, thekson plagët e qytetit si pasojë e ndërtimeve pa plan ("ngulfatjen që po i bëhet qytetit" (PFS, f. 68)...

Publicistja e dhuntisë së dëshmuar krijuese shprehet gjithë pietet dhe respekt për intelektualët dhe atdhetarët e kryeqytetit, si profesorët Vasil Andoni, Lirak Dodbiba, Ymer Berisha, Lorenc Antoni, Abdurrahim Buza, Ahmet Gashi, Rauf Zajmi, Dr. Rexhep Krasniqi; kujton me krenari dhe nostalgji "kohën e Shqipërisë" (1941-1944), bashkëbisedon me njerëz të cilët mbajnë mbi supet e tyre peshën e viteve, por me një kujtesë tepër të freskët dhe me një dashuri gjithë mall tek flasin për qytetin e tyre, dëshmon për përplasjet shqiptaro-serbe, për konfiskimin e pasurive dhe të pronave të atdhetarëve shqiptarë pas marrjes së pushtetit nga ana e komunistëve (si shtëpia e Iljaz Agushit, sot ndërtesa e RTK-ës: "Gruaja e Iljazit, Fatimja, një vajzë e bukur e beglerëve të Prishtinës, vdes e re, në shtëpinë të Televizionit i sotëm. Të dy kanë qenë një çift i bukur...Iljazit nuk qe martuar kurrë më." - PFS, f. 90.), e flet edhe për shtresat e shoqërisë...

Në kujtimet që shpalosen palë-palë e me një mall shpesh të valë, ajo kujton njerëzit eminentë dhe begatitë kështu galerinë e protagonistëve të qytetit, galeri që përbehet nga njerëzit e thjeshtë a zanatçinjtë (furrat e qytetit) e deri tek ministat.

Në një kapitull të veçantë, gazetarja emblemë ndalet tek figura rrezatonjëse e atdhetarit Iljaz Agushi (Personalitete kohe. Shtëpia dhe veprimtaria e të shquarit Iljaz Agushi), duke theksuar meritat e tij të mëdha në ngritjen e pushtetit shqiptar në Prishtinë:

"Aty nga mesi i prillit 1941, pasi gjen përkrahjen e personaliteteve të shquara të Prishtinës e të rrethinës, e ngriti Flamurin Kombëtar dhe nën valëvitjen e tij e shpalli përbërjen e udhëheqjes së Prefekturës së Bashkisë së Prishtinës." (PFS, f. 87)

Publicistja e përkushtimit të veçantë krijues kujton me krenari të ligjshme se Iljaz Agushi ishte një atdhetar i pandalshëm:

"Pa vonuar themelon komunat shqiptare, vendos kryetarët në komuna të mjediseve fshatare dhe shtron kërkesat që Kosova të bashkohej me Shqipërinë londineze - drejt Shqipërisë tërësore." (PFS, f. 87)

Pasi përkujton se: "KPJ-ja merr vendim që të likuidohet. Kështu, më 27 tetor 1943, në orën 18 hyjnë në shtëpinë e tij në Tiranë dhe e qëllojnë me 6 plumba." (PFS, f. 88), ajo gjithashtu dëshmon për dashurinë që ushqente populli për një nga bijtë e tij më të devotshëm, me rastin e varrosjes së tij në Prishtinë:

(vazhdon në numrin e ardhshëm)



## Historia e priftit shqiptar At Stath Melani dhe komandant çete

Nga MARIN MEMA

At Stath Melani është, për fat të keq, një figurë pak e njohur, nëse e krahason me kontributin e tij të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare.

Djaloshi që lindi në fshatin Melan të Përmetit në vitin 1858, që në moshë të re u zhvendos me babain e tij në Stamboll, ku u lidh me patriotët si Jani Vreto, Sami Frashëri, Hasan Tahsini, Pashko Vasa, Said Toptani etj. Punët e tij të para lidhur me çështjen kombëtare kishin të bënin me shpërndarjen e librave në gjuhën shqipe. Pak kohë më pas, diku në vitet 1876 - 1877, veprimtaria e tij ra në sy ta autoriteteve osmane, të cilat u përpoqën ta arrestonin, por pa mundur.

Stathi udhëtoi drejt Shteteve të Bashkuara, ku vazhdoi aktivitetin e tij në lidhje me figura të njohura të kohës. Në vitin 1899, i shqetësuar për situatën në Përmet dhe në të gjithë jugun e vendit, ku grekët kishin shtrirë influencën e tyre duke përdorur edhe kishën, ai merr vendimin më të rëndësishëm të jetës së tij, duke u shuguruar prift.

At Stath Melani në fillimvitet 1900 u kthye në Përmet, ku nisi një punë të dendur në zona të ndryshme, në përpjekje për të minimizuar ndasitë fetare të imponuara nga grekët në njërin krah e turqit në tjetrin. Shtëpia e priftit në Melan u shndërrua në një bazë ku iknin e vinin të gjitha çetat, siç ka shkruar në kujtimet e tij Mihal Grameno. Edhe pse disa herë u paralajmërua nga autoritetet e larta kishtarë të kohës të hiqte dorë nga ajo që ata e quanin herezi, At Stath Melani jo vetëm që vazhdoi meshimet në gjuhën shqipe, por i kushtoi një rëndësi edhe më të madhe hapjes së shkollave dhe arsimit të fëmijëve në gjuhën e tyre.


Për shkak të veprimtarisë së tij, në 1909-n At Stath Melani u arrestua dhe u burgos në Manastir, ku qëndroi për disa muaj. Pasi doli nga burgu i Janinës, prifti qëndroi për disa kohë në hapësirat e Çamërisë. Ai krijoi një lidhje të veçantë me atdhetarët e luftëtarët e kësaj zone, çka u shpreh përgjatë Luftës së Dytë Botërore, ku një ndër çetat e para të kësaj krachine u quajt At Stath Melani. Në vitin 1911 ai themeloi një çetë me djem nga krahina e Përmetit, Shqërisë, Dangëllisë, Leskovikut e me radhë. Rëndësia e këtij vendimi nuk lidhej thjesht me faktin e krijimit të saj, por edhe me vendimin për të mos hequr dorë nga rroba e priftit. At Stath Melani ishte kapëdan e prift në të njëjtën kohë.

Pas shpalljes së Pavarësisë, qeveria e Vlorës e caktoi komandant ushtrie në krahinën e Përmetit. Në 2 mars 1914, në Gjirokastrë, u organizua i ashtuquajtur i kongresi Vorio Epirot, që zgjodhi një qeveri me në krye ish- ministrin e Jashtëm të Greqisë, Jorgo Zografi. Kjo ishte pikënisja e një prej dërgatave më të përgjakura dhe drithëruese ndaj popullsisë civile shqiptare. Jugu dhe juglindja u sulmuan nga trupa të shumta andarte që masakruan pa mëshirë fshatra të tërë. Çeta e drejtuar nga prifti - kapëdan u përball me andartët në Lashovë e Melan, duke u shkakuar humbje të shumta. Në hakmarrje, grekët i dogjën shtëpinë dhe i arrestuan gruan e fëmijët e vegjël. E megjithatë ai nuk u ndal, por u gjend sërish në betejat e mëdha në Peshtan, Frashër e me radhë.

Për shkak të sulmit nga dy fronte (nga njëri krah grekët, nga tjetri trupat e Haxhi Qamilit), çetat zbrisin në zonën e Beratit, ku veç At Stathit gjendeshin edhe Çerçiz Topulli, Themistokli Gërmenji, Mihal Grameno e shumë kapëdanë të tjerë. Në gusht të vitit 1914, sipas gazetës "Dielli", At Stath Melani gjendej në fshatin Sinjë të Beratit. Prifti luftëtar më parë mbajti një meshë në gjuhën shqipe e më pas u bëri thirrje të gjithë banorëve t'u bashkoheshin sa më shumë çetave kombëtare. Gazeta "Albania" e 14 marsit 1918 solli pjesë nga fjala e mbajtur në atë periudhë nga kapëdani. "Më shihni prift ortodoks, por nuk u lindi kësajoj, u lindi shqiptar dhe shqiptar dua të vdes. Prandaj kush është për Shqipërinë, unë përpara dhe ju pas meje, të mbrojmë kombin dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë që armiqtë duan të na e coptojnë, e të përkrahim qeverinë e Vlorës". Pas betejave të ashpra, tërheqja drejt Vlorës mbeti mundësia e vetme për çetat, por edhe këtu trupat rebele hynë në fund të muajit gusht. Sipas mediave të kohës, mes intelektualëve e luftëtarëve të arrestuar nga forcat e Haxhi Qamilit ishte edhe At Stath Melani dhe djali i tij. Pas disa kohësh, një pjesë e tyre u liruan me vendim të qeverisë së Durrësit. Menjëherë pas daljes nga burgu në fundvitin 1914, At Stath Melani me të birin u nisën sërish drejt Shteteve të Bashkuara, por këtë herë jo për të punuar e për të siguruar mbijetesën, por për të kryer takime me patriotë të shumtë, të cilëve u kërkohej mbështetje edhe më e madhe. Në vitin 1915, atij i vdiq në Përmet djali tjetër. Në hakmarrje, drejtuesit grekomanë të kishës jo vetëm nuk lejuan mbajtjen e një ceremonie fetare, por as varrosjen brenda territorit të saj.

Shumë patriotë i kërkuan të qëndronte në Shtetet e Bashkuara, por mesa duket jeta e qetë nuk bënte për të. Ai kërkonte të kthehej e të punonte në vendin e tij. Në vitin 1917, At Stath Melani mori rrugën e rikthimit për në Shqipëri. Udhëtimin e tij e përshkruan me bukur e qartë se kushdo Mihal Grameno në librin "Kryengritja Shqiptare".

"Vetëm një plak i thinjur me leshrat dhe mjekrën e bardhë qëndron përjashta mbi vapor duke vështruar përpara dhe përpara. Fytyra e qeshur dhe simpatike tregon që plaku është i kënaqur nga udhëtimi. Ku e ku një nënqeshje shfaqet në buzët e tij dhe nga gëzimi fërkon duart. Duket që frika, tmerrri dhe dëshpërimi nuk gjejnë vend në zemër të plakut. Nuk gjejnë se plaku është nga pleqtë e Shqipërisë. Është nga kombëtarët e vjetër dhe shumë të vuajtur, prandaj e ka zemrën e çeliktë. Plaku quhet At Stath Melani. Shtëpinë ia dogjën barbarët grekë, po At Stath Melani dëshiron të trojë në kasolle po vetëm në Shqipëri të lirë ku të valojë flamuri i Skënderbeut. Zoti i mbushtë dëshirat dhe e shpëntë shëndoshë luftëtarin At Stathi, një nga pleqtë kombëtarë të Shqipërisë". Me t'u kthyer, edhe pse tashmë 59-vjeçar, At Stathi rinisi gjithçka me energjinë e një të riu në udhëtime fshat me fshat, duke meshuar shqip e përhapur ndjenjën kombëtare. Megjithatë armiqtë nuk ishin zhdukur, një pjesë qëndronin sërish aty, më të fshehur, por me të njëjtin objekt: të vrisnin At Stathi Melanin. Pasi kishin tentuar për vite të tëra ta thyenin, prifti kapëdan u ndal vetëm përballë një pabesie. Më 24 dhjetor të vitit 1917, në prag të Krishtlindjes, ai u vra në një pusi e më pas trupi i tij u masakrua. Patriotët nuk e harruan dhe morën hak për vrasjen e At Stath Melanit. 3 vjet më pas, në vitin 1920, Thanas Budo ezkzekutoi në zonën e Postenanit, Josif Sorropullin, vrasësin e priftit.



## Një lutje të dëshpëruar Nënë Terezës!

Nga RALF GJONI

**N**ënë e Shenjtë. Se kam zakon t'u lutem Shenjtorëve, por me sa shoh, për ne shqiptarët, edhe Zoti paska nevojë për mik! Ndaj unë s'kam ku të trokas tjetër, përveç derës tënde, e të të lutem të 'ulërasësh' pranë Fronit Qiellor.

Ti Nënë e Shenjtë e sheh nga lart se si kthetrat e dëshpërimin na kanë mbërthyer në këtë tokë të helmuar nga e keqja, e kanë kapur peng shpresën e popullit tënd. E shpresa, o Nënë, vështirë të kthehet këtu pa ndërhyrje hyjnore.

Lutu o Nënë e Shenjtë për popullin tënd të prangosur nga injoranca, verbëria, kokëfortësia e egërsia.

Lutu për këtë popull që ti le pas e që nuk e mori dot kurrë veten nga intoksifikimi i hidhur otoman. Shekuj lufrash e vrasjesh, çnderimesh e përdhunimesh, diktature e internimesh, spionliqesh e servilizmi, vjedhjeshe e grabitjesh - kanë lënë sot të braktisur e të dëshpëruar në këtë tokë vetëm pak, shuumë pak njerëz të vlerës e të besës. Të tjerët u vranë, u tjetërsuan, e ulën kokën ose ikën. Ata që kanë mbetur kanë gëlltitur haraçin otoman të për(k)uljes, servilizmit e të gjumit letargjik, me ne të paktët në mes!

Jemi shumë pak Nënë e shenjtë, shumë pak për të zgjuar një komb të tërë të copëtuar mes katër anëve të botës. Me sa duket nuk kemi forcë t'a ndryshojmë këtë vend. As Amerika e as Evropa mesa duket nuk i bëjnë dot punë kësaj toke.

Ata që ti le pas, sot kanë humbur dashurinë, kanë vrarë shpresën, kanë propozur vlerat, kanë humbur vizionin e urrejnë të vërtetën. Sot këtu mbretëron e keqja, hileja, arroganca, mburrja, egoizmi, cmira, inati, e futnja, urrejtja, droga, kurvëria, dashakeqësia, ashpërsia, ftohtësia e pasjellshmëria. Terri shpirtëror ka kapur frenat e Shqipërisë tënde të dashur o Nënë e Shenjtë!

Mashtrimi e trillimi, shpifja e spionimi, frika e papërgjegjshmëria janë sot vlerat e këtij kombi të vrarë në shpirt.

Ne kemi humbur dashurinë, vërtetësinë, durimin, dëshirën, shpresën, respektin, përlulësinë, vlerat, nderin, besën e besimin. Por mbi të gjitha, ne kemi humbur guximin.

Sepse ndryshimi kërkon vizion, kërkon besim, kërkon punë, por mbi çdo gjë tjetër kërkon guxim. E ne guxim nuk kemi, sepse jemi shumë pak, jemi të vegjël përballë frontit të keq mbarëkombëtar që ka kapur peng politikën, financën, familjen, shoqërinë e territorin e këtij vendi.

Ndaj sot, në ditën tënde, duhesh ti Nënë e Shenjtë, të sjellësh pakëz dritë e të mbjellësh pakëz shpresë, se ne nuk qen kemi për kurrëgjë. Edhe të ardhmen e fëmijëve tanë jemi gatë t'a shesim, vetëm të mos na prishet rehatia.

Dëgjoji o Nënë e Shenjtë burrash të zbythtur, klithmat e këtij popullit tënd të mbytur!

## In memoriam për specialistin në mjekësi, Adrian Abazaj nga Vlora

Nga HASAN ALIAJ, Romë

**K**am kohë që mendoj të shkruaj për Adrian Abazaj, por të them të drejtën kam hasur vështirësi, sepse nuk e besoj akoma që, Adi, siç i flisim shkurtimisht prej katër vitesh nuk ndodhet më midis nesh. Ai u largua shumë shpejt në parajsë, duke na lënë një boshllëk të madh e të parikuperueshëm. Ai, la tre fëmijë yje, që i deshte aq shumë, të cilët e mbushnin me lumturi kur kthehej nga puna i lodhur. Ai, la të vetmen fisnike, hallemadhe nënën e tij të dashur, që e deshte si drita e diellit. Adi, u mbushën katërt vjet, që nuk ta dëgjojmë zërin e ëmbël nga receptorit telefonit. Ah! Adi i shtrenjtë, që na deshte aq shumë e na falje vetëm dashuri e kënaqësi.

Po kush ishte Adriani?

Ka lindur më 24 korrik të vitit 1970, në qytetin bregdetar të Vlorës nga një familje intelektuale e patriotike. Fëmijërinë e tij e kaloi midis ëmbëlsisë së nenes, gjyshes Nasybe dhe gjysh Shyqiriut, të cilëve ju dhuronte shumë dashuri. Filloren e kreu në shkollën "Teli Ndini". Bashkëmoshatarët e kujtojnë me respekt djalin nga lagja "Partizani", për sjelljen shembullore në klasë dhe jashtë saj.

Ai shquhej edhe si mik i librit, pasi ishte i lidhur marëzish me librin, duke lexuar me pasion. Më kujtohet fare mirë sapo hynte në shtëpinë time ngrinte dorën lart duke përshëndetur dhe menjëherë drejtohej nga biblioteka. I shkonte librat, por nuk i prekte, pasi u kishte hedhur një sy titujve më afrohej dhe më pyeste. A mund të ma shënoni edhe mua emrin në listen e personave, që marrin libra në bibliotekë. E shikoja me vëmendje dhe mu bë qejfi për korektësinë dhe dashurinë e tij për librat. Kishte marrë dhe herë të tjera libra dhe ishte treguar i rregull në kthimin e tyre. Çdo tre ditë Adi trokiste në derën e shtëpisë, e cila i hapte në çast dhe silueta e tij njomzake ndodhej para bibliotekës. Në shkollën "Teli Ndini" zhvilloheshin konkurse të ndryshme dhe në njerin prej tyre Adi mori çmimin "Miku i librit". Studimet jashtë shkollore e kishin formuar intelektualisht. Tek Adi librat shkollorë dhe artistikë, qenë në harmoni me njera-tjetrën. Në shkollën e lartë për mjekësi të frekuentuar në qytetin e lindjes, Vlorë tregoi një perkushtim të jahtëzakonshëm. Ai kishte pasion mjekësinë, prandaj arriti ta perfundojë shkollën dhe të mari masterin me rezultate të shkëlqyera.

Ky profesion human e shoqëroi Adin gjithë jetën e tij, derisa u nda para kohe përfundimisht nga ne. Tek Spitali Civil i Vlorës edhe sot e kujtojnë me respekt Adin e dashur, sportist, energjik dhe të gatshëm në çdo moment. Humanizmin e tij e ka treguar në momentet e vështira të vitit 1997. Adriani djalë i vetëm, por me miq e shokë shumë dinte të dallonte miqësinë e vërtetë. Me guximin që e karakterizonte, ai arriti ta ndërtojë jetën në mërgim pa asnjë mbështetje. Pasi arriti ta mbrojë diplomën u sistemua me punë në spitalin "Clara Bella" të provincës Corte Franca Brescia. Profesioni humanitar e kishte mësuar të ishte korrekt dhe i gjendur me pacientët. Ketu po citoje mikun tim Profesor Lutfi Alia i cili ne KONGRESIN 3<sup>o</sup> NDËRKOMBËTAR I MJEKËSISË, AKTIVITET SHKENCOR MULTIDISCIPLINOR I SPITALIT AMERIKAN që u mbajt këto dite në Tiranë, për rolin e Infermierit është shprehur kështu: "Profesioni universal i infermierit, shumë i respektuar dhe i nderuar nga të gjithë, historikisht është parë si mision humanitar në shërbim të individit dhe të kolektivit, i ushtruar me art, kulturë dhe shkencë për të sëmurët e shtruar në spitale dhe jashtë spitaleve, gjithmonë pranë dhe në ndihmë të atyre që vuajnë nga sëmundjet. Infermieret, në kryerjen e kujdesit infermieror, aplikojnë kapacitetin profesional, formimin kulturor dhe ndjeshmerinë shpirtërore, duke i vënë në shërbim të atyre që kanë nevojë për ndihmë jo vetëm mjekësore por edhe shpirtërore, psikologjike dhe morale. Sa më të përgatitura profesionalisht dhe shkencërisht të jenë infermieret, aq më i kualifikuar dhe rezultativ është shërbimi, aq më të medha janë perfitimet mjekësore në institucionet spitalore dhe ambulatoriale, ashtu si dhe perfitimet shëndetësore, shpirtërore e morale për të semurën. Roli i mjekut është i rëndësishëm në diagnozën dhe kurimin e të semurit, por sukcesi i punës se tij varet nga aktiviteti profesional i infermierëve". I tillë ishte Adrian Abazaj!

Shumë përkujdesje dhe dashuri ka falur Adi në gjirin e komunitetit shqiptar në Breshia. Në çdo moment që e kërkonin për këshilla mjekësore ishte i gatshëm dhe nuk përtonte. Ndonëse ai u këput herët nga kjo botë në moshë të re asnjë nuk do që ta besojë. Të gjithë kujtojnë me respekt atë fytyrë engjëlllore. Madje Nënkrjetari i Bashkisë në Corte Franca Z. Luciani ka thënë: "Sot komuniteti ynë humbi një ndër bijtë e vet Adrian Abazaj, një djalë që rezatonte kudo që shkonte vetëm mirësi, dashuri e perkushtim".

I tillë ishte Adrian Abazaj nga Vlora, që dhe në tokë të huaj mbolli dashuri e mirënjohje.

Amen.



## In Memoria al Medico Specialista Adrian Abazaj di Valona

**E**' da tempo che ho pensato di scrivere per Adrian Abazaj, ma ho avuto qualche difficoltà, perché ancora non riesco a credere che "Adi" chiamato così dagli amici, da quattro anni non si trova più qui con noi. Lui se n'è andato troppo presto, lassù in Paradiso, lasciando un grande vuoto irrecuperabile. Ha lasciato tre figli che gli donavano tanta felicità quando ritornava dal lavoro stanco. Ha lasciato sola anche la sua adorabile madre, che lo amava tanto. Adi, sono quattro anni che la tua dolcissima voce non si sente più dall'altra parte della cornetta del telefono. Oh! carissimo Adi, tu che ci volevi così bene e ci regalavi così tanto amore.

Ma, chi era Adrian?



Nato il 24 Luglio del 1970 nella città di Valona, proveniente da una famiglia intellettuale e patriottica. Ha passato la sua infanzia fra le braccia dei suoi nonni Nasybe e Shyqiriut ai quali lui regala il suo amore. La sua istruzione elementare la conseguì nella scuola "Teli Ndini". I suoi coetanei ricordano con rispetto il giovanotto di "Lagja Partizani" per i suoi modi educati nel comportarsi dentro e fuori dall'ambiente scolastico. Lui era noto come un amico del libro, ed era legato in

modo pazzesco ad esso, leggeva con passione. Ricordo benissimo quando veniva a casa mia, entrando alzava in alto la mano salutandolo e subito si dirigeva verso la biblioteca. Guardava i libri ma non li toccava, dopo aver dato un'occhiata ai titoli si avvicinava e mi chiedeva potete scrivere anche il mio nome nella lista delle persone che prendono libri nella biblioteca? Lo guardavo con attenzione e mi faceva piacere l'amore e la correttezza che aveva con i libri. Aveva già chiesto altre volte ed è sempre stato molto regolare nel restituire ciò che aveva preso. Ogni tre giorni Adi bussava alla porta di casa, e appena quella si apriva lui con il suo corpo minuto subito si recava in biblioteca.

La scuola "Teli Ndini" organizzava diversi concorsi e in uno di loro Adi è stato premiato con l'attestato "Amico del Libro". Gli studi lo avevano ormai formato intellettualmente. In lui i libri di testo scolastici e quelli non scolastici avevano una combinazione armonica. Dopo seguì la facoltà di Medicina nella sua Città Natale dove mise tutta la sua passione e finì gli studi con un Master e ottimi risultati.

Questo mestiere umanistico lo ha accompagnato tutta la vita fino alla fine. All'ospedale civile di Valona anche oggi ricordano con molto rispetto Adi, uomo sportivo, energico e sempre pronto. Le sue capacità non sono mancati nei momenti difficili del 1997. Adrian era figlio unico, ma aveva tanti amici e sapeva ben distinguere la vera amicizia.

Con le sue forze è riuscito a ricostruire la sua vita da emigrante senza nessun appoggio. Dopo il riconoscimento della Laurea trovò sistemazione all'ospedale "Clara Bella" di Corte Franca in provincia di Brescia. L'umanesimo del suo mestiere gli aveva insegnato di essere corretto con i suoi pazienti. E qua volevo citare il mio amico Professor. dott. Lutfi Alia che al Terzo Congresso Internazionale di medicina, sull'attività Scientifica - Multidisciplinare dell'Ospedale Americano, che ha avuto svolgimento in questi giorni a Tirana, per il ruolo dell'Infermiere ha detto: "La professione universale dell'Infermiere, rispettato e amato da tutti, storicamente si è visto come una missione umana nel servizio per l'individuo e la collettività, esercitata con arte, cultura e sapienza per tutti i malati dentro e fuori dall'ospedale, sempre vicini e in aiuto di coloro che soffrono. Gli infermieri nella loro missione applicano le loro capacità professionali, formazione culturale, la sensibilità dell'anima mettendoli al servizio di coloro che hanno bisogno anche di sostegno psicologico e morale. Più sono preparati e professionali gli infermieri più è qualificato il servizio con maggior profitti ospedalieri e ambulatoriali nel tirare su anche lo stato morale del malato. Il ruolo del medico è importante nella fase diagnostica e della cura del malato, ma il successo di questo lavoro dipende dall'attività professionale degli infermieri". E uno di loro era Adrian Abazaj.

Tanto amore e professionalità ha regalato Adi nella comunità Albanese di Brescia. In ogni momento che gli veniva chiesto un consiglio era sempre pronto. Lui se ne è andato troppo presto troppo giovane da questo mondo nessuno non voleva credere. Tutti ricordano con rispetto questo viso angelico.

Il vicesindaco di Corte Franca ha detto: Oggi la nostra comunità ha perso un figlio come Adrian Abazaj, un ragazzo che irradiava solo del bene, amore e perseveranza.

"Questo era Adrian Abazaj di Valona che in terra straniera ha seminato amore e riconoscenza.

Amen.



## Scoperto anno di nascita del poeta albanese sangiorgese Giulio Variboba

Di COSMO LUDONE

La ricerca dello scrittore - giornalista Cosmo Laudone, arbereshe di San Giorgio Albanese in provincia di Cosenza, non finisce mai di stupire. Presidente emerito della pro loco sangiorgese "Jul Variboba", nonché autore di decine di pubblicazioni, il Cavaliere dell'Ordine al Merito della Repubblica Italiana, Cosmo Laudone, ha rintracciato importanti fonti documentali presso archivi pubblici e privati sulla comunità di appartenenza. Conoscitore profondo dello scrittore di lingua albanese, Giulio Variboba, dopo aver scoperto nel 1977 l'atto di morte del poeta, risalente al 1788, pubblicato in L'atto di morte di Giulio Variboba, 1977, Ludone Cosmo, ha rinvenuto di recente anche la data di nascita che risale al 16 aprile 1725. L'importante scoperta si può desumere dalla documentazione sotto riportata:

Ritratto eseguito con la tecnica dell'incisione a bulino di D. Giulio Variboba del 1756, recante la scritta "Rev.mo D. Giulio Variboba del Ven. Collegio Italo Greco Corsini in S.cto Benedetto de Ullano in Provincia di Calabria Citra" Dopo l'intestazione del titolo, nella parte centrale abbiamo la data di nascita: "Natus die 16 Aprile 1725". La lastra al bulino venne incisa da Giuseppe Vasi in Roma nel 1756, come si può leggere sul lato destro e sinistro, subito dopo il rigo intestatario della nascita. Il ritratto è appartenuto al Collegio di Sant'Adriano in San Demetrio Corone, proveniente con certezza dall'archivio del Collegio Corsini di San Benedetto Ullano (1734-1794), rintracciato oggi giorno in famiglia privata a San Demetrio Corone (Cs). I dati sopra riportati vengono confermati da altri due fonti documentali.

Il catasto onciario dell'Università di San Giorgio in Corigliano del 1743, nel distretto di Rossano, custodito presso l'Archivio di Stato di Napoli (Regia Camera della Sommara. Patrimonio Catasti onciari, nr. Busta 9072, f. 148r), dove risulta che nella rivela degli "Ecclesiastici cittadini secolari", presentata da D. Giovanni Arciprete Variboba di anni 59, sono compresi Francesca Minisci, moglie di anni 50 e Giulio, figlio clericale di anni 18, abitanti "in casa propria sita nella contrada delli Variboba" e confinanti con la casa di Martino Variboba...

Si evince chiaramente che il figlio dell'arciprete D. Giovanni Variboba, il chierico Giulio Variboba, di anni 18, nacque nel 1725, essendo il Catasto onciario di S. Giorgio in Corigliano ultimato nel 1743, come risulta sul frontespizio del Catasto in questione.

Parte della rivela di D. Giovanni Arciprete Variboba (Ecclesiastico cittadino secolare), come si può ricavare dal Catasto onciario dell'Università di San Giorgio in Corigliano del 1743, custodito presso l'Archivio di Stato di Napoli (Regia Camera della Sommara-Patrimonio Catasti onciari, nr. Busta 9072, f. 148r). Ritratto di "D. Giulio Variboba della Terra di San Giorgio in Corigliano, ecclesiastico in Roma".

Sottostante, possiamo leggere la data di nasci-

## Zbulohet viti i lindjes së poetit me origjinë shqiptare "Sangiorgiorgese" Giulio Variboba

Punët e shkrimtarit-gazetar Cosmo Laudone Arberesh nga San Giorgio Albanese në provincë të Kozencës, nuk shteron të na habitë. Duke qënë president për meritë në Sangiorgese "Jul Variboba" edhe pse autor i dhjetra publikimeve dhe "Kavaliert i urdhërit për Merita të Republikës Italiane. Cosmo Laudone ka nxjerë nga burime të rëndësishme dokumentarë nga arkiva privatë dhe publike mbi komunitetin të cilit i përket. Njohës i thellë i gjuhës së shkruar Shqipe Giulio Variboba. Mbas zbulimit në 1977 të aktit të vdekjes së poetit që i përket vitit 1788, i publikuar në aktin e vdekjes të Giulio Variboba, Cosmo Laudone na ka sjellë së afërmi edhe datën e lindjes së poetit në 16 Prill 1725. Zbulim i rëndësishëm që përshkruhet si në dokumentin e poshtëshkruar:

Ritrat i punuar me teknikën e inçizionit në bulino, të D. Giulio Variboba në 1756 sipas shkrimit "Rev.mo D. Giulio Variboba në Ven. Kolegji Italo-



(La lastra al bulino di Giulio Variboba, incisa da Giuseppe Vasi nel 1756. Cosmo Laudone).

ta, espressa in caratteri romani; "Natus die XVI Aprile MDCCXXV".

Anche questo ritratto apparteneva al Collegio di Sant'Adriano e dalle prime notizie certe in nostro possesso, è appartenuto insieme ad altri dipinti allo scrittore albanese Luigi Gurakuqi (1879-1925), all'epoca dei suoi studi nel collegio italo - albanese di San Demetrio Corone (1897). Altre fonti documentali in merito, saranno rese note quanto prima a conferma della straordinaria scoperta che pone fine e mette in luce la questione dell'anno di nascita di uno dei più grandi poeti della letteratura albanese. La conferma della datazione sopra riportata, si può evincere in parte, anche dalle ricerche inedite compiute dallo storico Vincenzo Librandi di Vaccarizzo Albanese, autore dei primi due volumi "Vacarici: Vaccarizzo Albanese: genesi storica di una comunità, Famiglie, avvenimenti e luoghi della memoria".

In un atto notarile del 27 ottobre 1739, dallo scrittore rintracciato, che ringraziamo per la gentile concessione, è riportato "la donazione, da parte del padre sacerdote, a Giulio Variboba, di vari fondi agricoli e di una casa" in procinto di "conseguire la prima tonsura". La tonsura solitamente veniva ricevuta a 14 anni, come emerge anche da un altro atto del 1829 rinvenuto dal Librandi, quando un certo Nicola Masci di Michele, alunno del Collegio di Sant'Adriano, nato nel 1815, riceveva a 14 anni la chierical tonsura (1). Emerge, quindi chiaramente, da tale documentazione, stabilire nel 1725 l'anno di nascita di Giulio Variboba. Tratto da Vincenzo Librandi: VAKARICI: Vaccarizzo Albanese: genesi storica di una comunità. Famiglie, avvenimenti e luoghi della memoria, vol. 5 (1759- 1763) inedito. Ritratto di "D. Giulio Variboba della Terra di S.Giorgio in Corigliano, ecclesiastico in Roma", nato il 16 Aprile 1725.

Greco Corsini në S.cto "Benedetto de Ullano" në provincën e Kalabrisë Citra. Mbas titullit në pjesën qendrore kemi datën e lindjes "Lindur më 16 Prill 1725". Pllaka në bulino është gdhëndur nga Giuseppe Vasi në Romë në 1756, siç mund të lexohet e djathtas e majtas, menjëherë mbas intestatit dhe lindjes. Ritrati i përkiste kolegjit "Shën Adriano" në San Demetrio Korone, dhe vjen me siguri nga arkivi i kolegjit Korsini nga San Benedetto Ullano (1734-1794), që mund ta gesh në ditët e sotme në familje private në San Demetrio Korone. Të dhënat e mësipërme janë konfirmuar edhe nga dy burime të tjera dokumentale.

Kadasta e Universitetit të San Giorgio në Korigliano e vitit 1743, në rrethin e Rossano-s, i ruajtur në Arkivin e shtetit të Napolit.


Dhoma e mbledhjes, pronësi "Katasti onciari" nr. Zarfi 9072, f. 148r, ku rezulton në "Ecclesiastici cittadini secolari" e prezantuar nga (Vijon në faqen 16)

## L'atto di morte di Giulio Variboba

Nella chiesa parrocchiale di S. Giorgio Albanese si conserva un ritratto del Variboba con la seguente scritta: D. Giulio Variboba, sacerdote italo - greco della terra di S. Giorgio, diocesi di Rossano, morto di apoplezia in Roma e un età di anni 64 il dì 31 dicembre 1788 nella ven. chiesa di S. Maria sopra Minerva dell'Ordine de' Predicatori, dopo aver recitato il SS. Rosario e aver ricevuta la benedizione del SS. Sacramento. Nei due studi più recenti sul nostro personaggio sono stati riferiti questi dati, ma è stato osservato che non esistono documenti sicuri sulla sua data di morte del Variboba. Veramente la didascalia del ritratto è molto circostanziata e non v'è motivo di metterne in dubbio il contenuto senza una ragione valida. E che quella data e quei particolari erano veri sono ora confermati dall'atto di morte che qui appresso pubblichiamo. Il ritrovamento di questo documento è tutto merito del signor Cosmo Laudone, anch'egli di S. Giorgio Albanese, che da qualche tempo s'è dedicato allo studio delle figure più rappresentative del suo paese. Naturalmente il primo appuntamento è stato con D. Giulio Variboba e, avendo appreso che il poeta era morto nella chiesa romana di S. Maria sopra Minerva, vi si è recato con la speranza di rintracciare più ampie notizie in merito, magari coadiuvato da qualcuno dei Padri domenicani che officiano la chiesa. Per la verità non vi ha trovato niente come, del resto, era capitato ad altri che prima di lui vi erano andati con lo stesso scopo. I suggerimenti, però, ricevuti l'hanno indotto a rivolgere altrove le sue ricerche e questa volta con esito positivo. Nell'archivio del Vicariato di Roma sono conversati i libri

appartenuti alle parrocchie soppresse della città ed è precisamente in uno di questi, proveniente dall'ex parrocchia di S. Francesco di Paola ai Monti, che viene registrata la morte del Variboba avvenuta alla data e nelle circostanze sopra indicate. Con molta probabilità il Variboba s'era recato alla chiesa di S. Maria sopra Minerva per partecipare alla funzione vespertina di ringraziamento alla chiusura dell'anno che si svolgeva con solennità nella cappella del SS. Mo Salvatore. E qui, durante la cerimonia, verso le ore 16,45 (= alle ore 23 e 30 del documento) avvenne la repentina conclusione di una travagliata ed amara esistenza. Il giorno ed anno successivo il cadavere veniva trasportato e seppellito nella chiesa dei Santi Sergio e Bacco, detta anche di S. Maria del Pascolo. Liber mortuorum ab anno 1787 usque ad an. 1802, p. 73. December 1788. Anno Domini 1788 die 31 dicembris, hora 23 cum dimidio: R. D. Julius Variboba, sacerdos huius parochiae aetatis suae an. 63, orans in ecclesia S. Mariae supra Minervam ante Sanctissimi Salvatoris immagine repentina morte correptus cessit in humanis agere, sacramentali absolute et sacri olei unctione reffectus. Eiusdemque cadaver sequenti die, scilicet prima januarii 1789 fuit delatum de proprii parochi S. Francisci de Paula benigna permissione ad ecclesiam S. Mariae de Poscolo PP. Ruthenorum S. Basilii Magni absque ulla nec minima parochialium jurium laesione, sed votis annuens Rectoris illius laci, in eiusdem ecclesia fuit expositum, humatum, inique expectat universae carnis resurrectionem.

(Arch. Del Vicariato di Roma, Parrocchia di S. Francesco di Paola, vol. VIII)



## Akti i vdekjes të Giulio Variboba

Në kishën e S. Giorgio Albanese ruhet një ritrat i Variboba me nënshkrimin: D. Giulio Variboba, prift Italo-Greco në vendin S. Giorgio Albanese, Diocesi di Rossano, i vdekur për opoplezia në Romë, në moshën 64 vjeç në 31 Dhjetor 1788 në kishën e shënjtë të S. Maria e sipërmë, Minerva në "Ordine dei Predicatori", mbar recitimit të Rozarit të shënjtë dhe mbas bekimit të SS. Shënjtërimi.

Në dy studimet më të afërmë të personazhit tonë janë referuar këto të dhëna, dhe është verifikuar që nuk ekzistojnë dokumenta të saktë mbi datën e vdekjes të poetit. Eshhtë e vërtetë që mbishkrimi i ritratit është shume i dukshëm dhe nuk ekziston motiv për ta vënë në dyshim. Që kjo datë dhe këto të veçanta janë tashmë të vërtetuara nga akti i vdekjes qe ketu më poshtë po publikojmë.

Gjetja e këtij dokumenti është merite e veçantë esig. Cosmo Laudone, edhe ai nga S. Giorgio Albanese, që prej disa kohësh i është kushtuar studimit të figurave të shquara të vëndit të tij. Natyrisht nga të parët që filloj të studionte është Variboba, duke patur parasysh që poeti ndiq në kishën Romane të S. Maria, Minerva, vajtiatje me shpresën që të gjente më shumë të dhëna i ndihmuar edhe nga Padri Domenikani, që mirënbajnë kishën. Në të vërtetë nuk gjeti ndonjë gjë më shumë se githë të tjerët që kishin vajtur para tij për të njejtin qëllim. Sygjerimet e kanë detyruar të kërkojë akoma, këtë radhë me rezultate pozitive.

Në arkivin e Vicariato në Romë janë ruajtur libra që i përkasin disa kishave dhe pikërisht

në njërën prej tyre parrocchia S. Francesco di Paola ai Monti është regjistruar vdekja e Varibobës në datën dhe rrethanat e lartëpërmendura ka shumë mundësi që Variboba kishhtë vajtur në kishën S. Maria sopra Minerva për të marë pjesë në funksionet, falenderimit dhe të fund-vitit me solemnitet në kapelën e SS.mo Salvatore. Dhe këtu gjatë çeremonisë rreth orës 16,45 (= me orën 23 e 30 në dokument) mbyllet me hidhërim ekzistenca e tij. Në ditën dhe vitin që vinte i vdekuri u trasportua dhe u varros në kishën e "Santi Sergio e Bacco", e ashtuquajtura "S. Maria del Pascolo"! Liber mortuorum ab anno 1787 usque ad an. 1802, p. 73. December 1788. Anno Domini 1788 die 31 dicembris, hora 23 cum dimidio: R. D. Julius Variboba, sacerdos huius parochiae aetatis suae an. 63, orans in ecclesia S. Mariae supra Minervam ante Sanctissimi Salvatoris immagine repentina morte correptus cessit in humanis agere, sacramentali absolute et sacri olei unctione reffectus. Eiusdemque cadaver sequenti die, scilicet prima januarii 1789 fuit delatum de proprii parochi S. Francisci de Paula benigna permissione ad ecclesiam S. Mariae de Poscolo PP. Ruthenorum S. Basilii Magni absque ulla nec minima parochialium jurium laesione, sed votis annuens Rectoris illius laci, in eiusdem ecclesia fuit expositum, humatum, inique expectat universae carnis resurrectionem.

(Arch. Del Vicariato di Roma, Parrocchia di S. Francesco di Paola, vol. VIII) (Perktheu Ana Bisholla)

## LETËR XHAXHAIT TIM ALI

*Nga XHEVAHIR SPAHIU*

Më thuaj, xhaxha:  
a janë gjallë lisat  
apo kanë shkuar dhe ata refugjatë?  
Po ti a flet më me kau  
dhe me xhindet, natën?  
Yjet mbi lumë e në gjirin e lumit  
a luajnë me zajt dhe këmbëjnë vendet  
në Shkallëz?  
A ka më dëllinja?  
Ditën e verës me to ndizim zjarre,  
kapërcenim mbi zjarre  
të bëheshim trima.  
Xhaxha, shko një herë nga varret,  
e më thuaj: ç'bën gjyshja nën dhë?  
Kur të vij do t'i çoj një vargan manafere.  
Xhaxha, Lumi i Vogël i ka gryyer brigjet, –  
për këtë nuk të pyes. E di.  
E di,  
siç di plisat dhe gjurmët e dhelprave ti.  
Xhaxha,  
flas me ty si me një këngë të vjetër:  
A ke zier raki?  
Ke zier, patjetër.  
Më dërgo me njeri një shishe, po munde: ballka-  
zani,  
kuptohet.  
Do ta pi me një frymë  
si të qeshë ezhderhá –  
dhe do them veç dy fjalë naimiane:  
Të paça, xhaxha!

## PREJ AJRIT DHE MENDIMIT

*Nga LINA LURASCHI*

Rënduar prej ajrit dhe mendimit gjynjëzohet shelgu,  
dëgjon të ulërijë pafundësinë që toka,  
si xhëp i ngrirë, e pret.

Dhe e regjur si kallo dhimbja ligjëron midis degëve.

E lehtë, ajo zgjatje, e tingullit arkan,  
është zë i dobët që flet,  
fëshfërimë që gratë mishërojnë në patejdukshmëri  
ritesh.

E balsame  
e laqe  
e çelsa  
gjuhë nga etja në pranga vërtisin shikimin  
e prej ajrit dhe mendimit ofshan shelgu.

Vuan për mos t'u kthyer në një sporë endacake  
kur fryma e ditës,  
pas zverkut, t'i arrijë.

*(Perktheu Valbona Jakova)*

## Flakadan prej ere (Frederik Rreshpjes)

*Nga VASO PAPAJ*

Frederik  
Dhe pse s'të njoha asnjëherë,  
Kurrë s'është vonë të të them,  
Se ishe flakadan në terr.

Nga vinte ajo dhunti të mbeteshe në këmbë,  
Nga ngjyrat dhe liria të ngjaje me Van Gog?  
Rrotull, kur të mbytnin, kishin nxjerrë dhëmbë  
Dhe heshtja si flakë ferri vështronte nën tokë?!

E ti me jetën tënde si një fajtor pafaj,  
Si flakadan prej ere shpalosur nëpër erë,  
S'dite të mbërtheheshe fort-fort pas saj,  
Se si fëmijë ngjasojnë poetët nganjëherë.

Frederik!  
E ashpër vetmia jote, vetmi rebeli.  
Një rol i vështirë që lehtë ti s'e ke blurar.  
Yll që në skenë të poezisë kurrë nuk shkeli,  
Ku dhimbja mbeti nga të vetmet çmime të paguar.

Dhe ike...  
Atëherë në faqet e heshtjes diçka nisën të tjerin...  
Iu klitha: Merrini gazetat, flakini në Lanë të gjitha!  
S'kanë ç'të thonë më dhe s'kanë ç'të nxjerrin,  
Vetëm shkëlqim kallaji dhe blic me lakuriqa.

## “E HËNA E PËRTEJBOTËS:

*Nga HAMIT ALIAJ*

Edhe Zoti qan, dy lotë ia di:  
Njeri lot - Valbona,  
Tjetri lot je ti...

Ti sheh veten në ujëra  
Pa ditur se fytyra  
Kaherë ka ikur me lumin

Këto shpirtëra mjegullash  
Që ikin luginave  
Dikur ishin lumë...

Në pranverë lumi im thinjet  
Nga vijnë borërat që shkrihen  
Prej malit a mallit?

Kur njerëzit bëhen ura  
Lumenjtë kthehen pas  
Deti mbetet shkë.  
*Shkëputur nga libri “E hëna e përtejbotës”*

## ORKESTRA IME

*Nga ARBEN KURTRESHI*

Ka shumë kohë  
Që po mendoj,  
Një orkestër  
Të formoj.

T'i mbledh bijtë  
Nga Shqipëria,  
Nga Kosova  
E Malësia.

Te këndojmë  
Të gjithë bashkë  
Siç kënduan  
Ilirët e lashtë.

Dhe kur së bashku të jemi  
Me ata nga mërgimi  
Këngës për bashkim do t'ia themi  
Përherë nga gëzimi.

## DHEMBJA JOTE

*Nga MYRTEZA MARA*

Unë jam dhembje,  
dhembje e të gjitha dhembjeve jam,  
këngë loti,  
binjak i rrënjëzuar me shpresën  
puh kristalet e dritës  
veshur i gjithi me mall e zjarr!

Jam orteku i trishtimit,  
kam marrë fuqin e Dhembjes,  
që kur shpirti  
u ngjiz me poezinë!

Jam dhembja e ajrit,  
e tokës,  
e qiellit,  
e krahut të zogut në fluturim,  
jam loti i diellit!

Unë-udha e plagës së puthjes,  
gjurma e psherëtimës  
në shtratin e përmendores së lutjeve  
mbi poet e kësaj bote.

Unë ...  
dhembja jote!

## POETET

*Nga FESTIM LITI*

Shpesh vdesin poetet,  
Te perhumbur,  
mbi vargje,rima,metafora.  
Udhetojne te lodhur drejt motiveve.  
Cmendurisht duan te pushtojne,  
qiejt,enderrat,koherat.....

Vdesin poetet,  
Mbi shpine mbajne arke-mortet e fateve,  
njerzve,dashurite e vdekura,  
dashurite e pafilluara,  
kenge te mbushura me aromen e lule-lofa-  
tave,  
dhe shpresa here-here te mekura....

Vdesin poetet,  
edhe tre here ne dite,  
e vine perseri ne jete,  
nxitojne per te mbledhur agime dhe drite.....

Poete jane si Anteu,  
qe vec nga toka merte fuqi,  
Ata vdesin e ringjallen perseri,  
Kur kamba e tyre shkel,  
ne planetin magjik,  
qe quhet POEZI...

## NJË MIK

*Nga ANA BISHOLLA*

Një mik i mirë  
Kur flet, më sy të shikon.  
Një mik është dora në sup  
Që dhimbjen lehtëson.

Një mik është loti që zbret ngadalë,  
Dhe papritur rrugën ndalon.  
Një mik është fjala e ngrohtë  
Që distanzën e oqeanit  
Pafund shkurton.

Një mik është jorgani  
Që shpirtin e ftohur mbulon.  
Një mik të do edhe kur  
Ndonjëherë gabon.

Një mik ftohtësine e shpirtit  
Me ngrohtësi ta mbush,  
Ndez edhe zjarrin kur  
S'ka më as prrush.

Një mik, pranë teje është  
Edhe kur ti nuk e mendon.  
Një mik është udha ku isha harruar...  
Si faqet e një libri,  
Që akoma skam lexuar.

Me një mik je lidhur,  
Si me një ënder të bukur,  
Ku nuk të zgjon,  
As ritmi i shfrenuar i jetës  
Që mizor ikën, nxiton!

## VALLEZIM NE ENDERR

*Nga IZMIT M IMERI*

Ne mes vargut ,gjumi me kishte zene,  
M'i perkdhelte faqet nje rreze hene,  
Isha duke vallezuar nen tingujt e violines,  
Ne perqafim i morra te gjitha yjet!  
Fishekzjarret i ndeznin me xhelozzi meteoret,  
Doja qe te ndalonin te numronin oret  
Doja qe endra te zgjaste deri ne perjetesi,  
Une mbi ozon ,te beja gjumin ne qetesi!

## RINGJALLJE

*Nga REMZI LIMANI*

Lëreni kujtimet e rrudhura  
le të thellohen ballit të dylltë  
nëpër vijat e brazdave  
të mbillen lulet për ty e dashur  
le të shihen lulet e dala  
nga rrudhat e rrudhave  
ta shoh dhe unë ringjallen tënde  
të larë në qumështin e luleve dhe buzëqeshjen  
e qartë në sy mëngjesi  
le të dëgjojen rrumbat e këmbanave  
mbi Ulpianë

## SHALLI

*Nga SETI PEZAKU VLADI*

Vështroje gjethet si u ikin degëve,  
lotët e pemëve ta shtuan dhembshurinë,  
furtuna e erës shallin ta mori,  
vrapove pas tij përrenj e luginë.

Kërkove mjegullash, sheshe, korije,  
supeve vjeshta gjethet t'i hodhi,  
shallin kërkove zaje e rrepshte,  
valëve të lumit që sytë t'i vodhi.

Shallin e kuq hedhur për qafe,  
dhoratë dashurie ardhur së largu,  
e gjete në pyllin e vargjeve të tua,  
valëve të aty, në rimën e një vargu.

## UNE DHE STINAT

*Nga STELO SOKO*

Çdo mengjes me takon vjeshta  
Ajo per drej cmendet per mua  
Mua ne goje me rri genjeshtra  
Me ze te mekur i them ,”te dua” .

Si te gjithë dua pranveren  
Por edhe veren jo me pak  
Me pelqen ta mashtroj vjeshten  
Dimerit deren nuk ja hap.

## NËN NJË COPË QIELL

*Nga NIKOLLE LOKA*

Kur veten kapërcen  
në atë fund udhëtimit,  
në vetmi deri në amshim,  
bota krejt një lëmsh pikëllimi  
nën një copë qiell,  
e më përtej,  
përtej amshimi dhe rreze dielli,  
dëshira për më tej,  
më përtej thonë se nis fillimi...  
Qielli mbi krye një copë harrimi,  
se yje s'ka,  
e dielli nuk po lind...

## LOT FEMIJE DHIMBJE NENE

*Nga VANGJELIA VERORI(MEHMETAJ)*

Renkojne dhimbshem kullat ne malesi,  
Me fryme te pafajshmish ne hasmeri,  
Ne lot nenash me femi ne gjii,  
Ne buzeqeshjen e tyre vrare pa liri...

Legjende e pergjakjes se kanunit,  
Tradite pagane qe s'njeh shoq,  
Tunden themelet nen hijen e frikes,  
Ku pergjojne muret nen tmerrin e prites...

Bota shkon perpara koha evulon,  
Barberia gjakmarrje,ketu te miren shkaterron,  
Hasmi pas deres s'le burre te shkoj ne pune,  
Trashegimtaret te vriten,ne jete te mos lene  
gjurme...

Kjo plage, qe foshnjen ne djep e vshk,  
Ku nje i pashpirt, papritur ja mbyll syte,  
Atij qe rron, e fryme lirisht nuk mer,  
Cdo qelize e embrion ia shtjer ne terr.

Dora e shtetit fuqishem le te degjohet,  
Kjo plage e kobshme,  
Nga themelet te shkaterrrohet,  
Paqja e pajtimi te lartesohen..

## NJË KOMB, NJË GJUHË E VETME...

*Nga NIKOLIN SH. LËMEZHI*

*(Ua kushtoj vëllezërve shqiptarë kudo që janë të  
shpërndarë në botë:  
Me rastin e Festës së Flamurit)*  
Kosovë e Shqipëri,  
dy shtete, një flamur.  
Një komb, një gjuhë e vetme,  
Ti s'do shuhesh kurrë!  
Ndaj jetoni me gëzim,  
kudo jeni të shpërndarë!  
Gjithmonë paqe e bekim,  
për ju, o vëllezër shqiptarë!

## I DASHUR MIK PO TË SHKRUAJ...

*( Lucio Dalla )*

*Nga ARJAN TH. KALLÇO*

Një tingull klarinete  
Papritur u këput në mes, por jehona  
Endet dhimbshëm në horizont.  
Edhe ca tela kitare për drejt  
Ç'u këputën dhe kënga jonë  
Na mbeti pezull.  
Derdhni lot, o Miq, se një Dritë  
U largua prej nesh.

## DALLGË

*Kushtuar shkrimtarit Petro Marko*

*Nga ALEKSANDËR ÇIPA*

Deti tokën tonë,  
Në vis të Himarës,  
E rrahu, e vrau, e theri me dallgë.  
Në vjetët e vjetër,  
Dhe ne vjetët tanë...  
Po ti?  
Ti, himariot i fismë!  
Nga dallgët e jetës,  
Rrahur në çdo brinjë,  
Përkulu të lutem,  
Të të puth në thinjë!

## VLORA NË NËNTOR

*Nga LAURETA PETOSHATI*

Në një moshë të thellë sa dhe deti  
ky qytet ku lindi dhe një shenj  
e shenjtëruar vetë historia mbeti  
histori e Vlorës burim që kurrë nuk resht.

Janë vitet e trimërisë sa rëra e detit  
si gjetet e ullirit rilindin pambarim  
ku sot gjarpërojnë makinat drejt bregdetit  
me dritat llavë lëvizëse në flakërim.

Qyteti ku flamuri hap krahët e shqiponjës  
tani është i mbushur me turistë  
dëgjon me pulëbardhat gjithë gjuhët e botës  
dhe të atyre që dje e shkelën egërsisht.

Por s'ka armiq qyteti im,  
qyteti që për ajër ka lirinë  
ku pas pesë shekujve me ngadhënjim  
një bir i tij i sjell atdheut pavarësinë.

Në këto ditë të shenjta rri e mendojem  
stoli kurorash Vlorë ime mban  
se djalëria e saj e bëri shenjtërore  
tempull lirie me luftëtarë e partizanë.

Vlorë çel lule dhe pse është nëntor  
për bijtë lule si pika referimi  
yje në qiell, lavdi në kraharor  
Vlorë është deti, por dhe burimi.

## KUR LINDI DIELLI...

*Nga NIKOLIN SH. LËMEZHI*

Kam parë tek lind dielli,  
nga Mëmëdheu im, sot.  
Me të seç u hap qielli,  
sa bukur ishte, o Zot!

## MESUESI

*Nga HYDA ISMAILI*

Na sjell ndermend te gjithëve feminine,  
Një kohe te arte kur kishim Nene e Babe.  
Na mesoi te behemi ne jete te mire,  
Atdhene, Vnedlindjen e njeri-tjetrit te duam.

Fjala Mesues s'është nje emer i thjeshte,  
Ka vlere dhe peshon sa vet feminia.  
Rrezaton vlere e drite tere nje jete,  
Para tij e Zotit perulet me respekt tere njerezia.

## PYETJA E PAHARRUAR E NËNËS...

*Nga VULLNET MATO*

O zot, si nuk e harroj dot atë pyetje të nënës,  
kur shtypja në tastierë shkronjat me radhë!...  
Ajo ulur pranë meje, ndiqte trokitjet e gërmës,  
ku rreshtoheshin fjalët në letrën e bardhë!

Ç'i ke gjithë ato fjalë që shkruan, more bir?  
-Fjalë për botën dhe veten time, moj nënë!...  
Ajo psherëtiu me kryet mbështetur te supi im  
dhe troku i gërmave sytë në dremitje ia kish  
vënë.

Kur mbarova me makinën, nëna u zgjua befas,  
fërkoj sytë, që i qenë mbyllur krejt pa kuptuar  
dhe sikur po kërkonte ndjesë, më pyeti lehtas:  
-Mbarove, o bir, fjalët, që kish për të shkruar?  
-Kam lënë vetëm një fjalë, moj e shtrenjta ime!

-Ç'është ajo fjalë që s'e shkrove, nxitoi të pyesë?  
-Fjalën e parë, që të belbëzova ty, kur më lindi,  
ta shkruaj edhe të fundit, përpara se të vdes...  
Ajo më puthi e më fërkoj gjoksin sipër zembrës:  
-Ti s'ke për të vdekur, derisa të jem unë gjallë!...  
O, zot si nuk e harroj dot atë pyetje të nënës,  
por sa herë shkruaj, ma kujton i përvëluari mall!

## E MIRA IME

*Nga SOKRAT HABILAJ*

Për ty, i druhem trishtimit në vjersha,  
Se ti s'më do si vjershaxhinjtë e tjerë.  
Që si rrobat e brendshme nëpër tela,  
Nderin në vargje çdo dhimbje e sherr.

Për ty, lotët si lë të kthehen kristale,  
Dhe nis i kafshoj, sikur veten nduk.  
Nëse ndonjë më rrëshqet, pa dashje,  
Ti zgjatë buzët, e gjasme më puthë.

Për ty, edhe si burrë e ndjej frikën,  
Kur të kesh para, një burrë që qanë.  
Pa menduar dy herë, tej gruas ikën,  
Dhe bëhesh nënë:-Mos qaj o xhan!

Për ty, sytë i tera, pikë nga një pikë,  
Ndërsa ti heshtur, qerpikët m'i fsheh,  
Thua se kuptoj se loti është si shpirt,  
Që ikën nga unë, e tek ty gjen strehë!

## BOTA IME

*Nga KELA BILBILI*

Bota ime është e paster  
Madje pa asnjë mekat  
Ku ka dit o mik i dashur  
Se le kurr te behet nate  
Bota ime është e qeshur  
bota ime smban meri  
Bota ime harmonike  
E ka emrin dashuri.

## NËNTORËT SHQIPTARE

*Nga MUSA JUPOLLI*

Zanorët tona  
Shkrimtar ' e Poet ' në kërkim  
Aty ku Homer epik homerik  
Me sy të verbër e bënte të këndonte  
Epopenë e zanoreve të humbura  
Vërbëuar jemi nga komedi e njeriut  
Plagosur me të njetën armë  
Dhjetëmilion pika loti n' apostrof  
T' ëmbëla derdhur në Det të njelmte  
Po unë, ç' farë faji kam  
Të gjitha letrat më janë djeg  
Germat ar(t)i më janë shkrirë  
Pena ime shpirtin më ndrydhë  
O o o zë që vjen nga mali  
Melodi në zemër më kalli  
Shnet e Shnetë  
Zanoreve tona!

## ATJE TEK DIELLI

*Nga ZEF MULAJ*

Muret e kullës  
Si alpet.  
Tek dielli rrinë,  
Përjetsia e bardhë  
jetën njerzore  
Atje vesh.  
Kull alpine  
Aty rrënjët i kam.  
Shtëpi e diellit  
Heshjtja e mbulon  
Të shkretën bukuri.  
Pë qark pemët  
Të rrin kurore.  
Kan ikur ikur...  
Ti në vetmi me diellin  
Jeton.

## DASHURIA IME...

*Nga ANILA TOTO*

Më cmend,  
dashuria ime!  
Të rrij përballë

edhe vetëm hesht.  
Një heshtje e paster  
e brendshme, intime,  
të ngjall e të vdes!

## DHEUN E TOKES KU U RRITA...!!

*Nga ZIHNI NDREGJONI*

Ku u rrita dua,me tan mall,  
dheun t'ia puthe e ta rrembej!  
dua te marr ta fus ne gji,  
e nga te shkoj me te te defrej!.

Dua ta marr edhe ate kodren time  
mbi keto supet e mija ta mbaj!  
Ta keme edhe per gezime,  
por as kur hallet t'me rendojen te mos e ndaj!.

Eh me ato te shtrenjtet miq,  
te jem prane tyre e te ngrej dolli!  
Te kuvendojme e mallin ta nxjerrim,  
te shkojme larg andej ne rini!!

Sa dashuri e deshire,  
Sa e embel do te ishte dita!  
Ta puthja me gjithë mallin qe kam,  
Dheun e tokes ku u rrita...!!

## “NJË CIGARE ME TY”

*Për miken time Kozeta Mamaqi*

*Nga LUAN RAMA*

« Erdha të ndez një cigare me ty »  
thua ti,  
sy hiri,  
buzë hiri,  
gojë hiri,  
një qiell i hirtë nderet mbi shpatulla hiri,  
këmbë hiri që shkojnë kuturu  
në rrugën që mbyllet tej  
me një dritare hiri,  
djegur nga malli...  
“Erdha të ndez një cigare”  
thua ti  
me lotë që pikojnë  
veç hi,  
ylbere të hirta,  
dhe tymi i hirtë që lë pas lule të argjendta  
krizantema, tulipanë,  
për ti dhënë dritë syve të shuar  
për të kapërcyer errësitat  
dhe tunelin e tjetrës botë,  
për ti hapur krahët dhe një herë me dashuri,  
dhe atëherë ti shtron çarçafë për birin  
si të shtrosh shtratin e dhëndërisë,  
shtron një qiell për kurmin e tij  
por ah, kurmi i tij ngrihet lart,  
ku shkon ky kurm kështu  
mbuluar me kaq dashuri,  
dhe ti e vëzhgon pjellën nga poshtë  
pi cigare dhe djeg padashur gishtërinjtë  
zjarri djeg zemrën tënde  
ti drithërohesh e thua  
po unë, ç'bëj ende këtu,  
dhe atëherë nxiton të hapësh dyert  
verbuar nga sytë  
etur për dashuri...

## MALL PËR SHTËPINË E VJETËR

*Nga PERPARIM HYSI*

Tej nga kodra hija zgjatet  
Shtrihet der tek kodra tjetër  
Mu atje ku paç “sarajet”  
E shtëpisë sime, të vjetër..

Ja, atje, më qenë themelet  
Goxha bahçe rreth-përqark  
Mbushur shkurre (nishan s'ngjendet)  
Shkurret ploç zogi fluturakë.

Varem kodrës në luginë  
Edhe sos mu tek përroi  
Zë kullo me nge synë  
Dhe sinoret, zë kërkuj.

Pastaj ngjit një të përpjetë  
Hë, o burra, edhe pak!  
Ja këtu shkova një jetë  
Tek kjo kodër, tek ky prag.

Këmbëkryq ulem tek vendi  
Mbytur ferra e gjembaçë  
Më vret sytë e më kap helmi  
Shpirti dhëmb sikur ka plagë.

Dua të ik,por hiç s'më iket  
Më vjen pranë fëmijëria  
Numëroj mbi supe vitet  
Mbytem krejt nga nostalgjia.

## RRËNJËT KEMI NË ATDHE

*Nga THEODHORI PROKO*

Në atdhe i kemi rrënjët  
Unë dhe ti me gjak shqiptari  
Në vend të huaj jemi degë  
E hollë sa një fije bari.

Të vetmuar dhe fillikat  
Edhe emrin kemi ndërruar  
Askush s'na njeh, asnjë s'na leht  
Me emrin që na kanë pagëzuar.

Ty të thonë sinjor Kolombo  
Dhe përgjigjesh: “pronto - si”  
Unë dhe vet e kam harruar  
Që më quajnë Theodhori.

Të dy plasim nga marrazi  
Si qelq i nxehtë në të ftohtë  
Kur “mama mia” cicërojnë fëmijët  
Nënë, shqip, goja s'u thotë.

Me dhimbje digjemi në flakë malli  
Si gjarpri nën gur nga zjarri  
Se në atdhe i kemi rrënjët  
Unë dhe ti me gjak shqiptari.

## UDHËTIM NË VENDIN E LINDJES

*Nga IRMA KURTI*

S'ish një udhëtim si gjithë të tjerët,  
vendi im më priti me bubullima e shi,  
me sa duket më konsideronte të huaj  
e më nuk më njilhte përsëri.

Në tregun e fshatarëve pranë shtëpisë,  
fletët e sallatës të shitura përtokë  
u përbaltën dhe u përngjanin gjetheve  
të shpërfytyruara të vjeshtës së vonë.

S'kisha një strehëz, u ndjeva e vetmuar,  
nuk dinin ku të më çonin as hapat e mi,  
këpucët e humbën ngjyrën e tyre të artë,  
mendimet në përrenj të vegjël mbyteshin.

Rinjoha të gjitha ato detaje që atëherë  
më trishtonin si orë leksioni e gjatë,  
qentë e rrugës, trafiku në kaos, boritë,  
shpresën, dëshirat m'i vranë pak nga pak.

Shkrepëtimat ndriçonin pisllekun në rrugë,  
së bashku me shiun rridhte trishtimi im,  
por nostalgjia e mijra kujtimeve digjej  
brënda meje dalëngadalë pors një kandil.

## PRITJE

*Nga NDUE LAZRI*

*- Sipas një motivi rus-*

Pritmë ti, e dashur, prit,  
siç di t'presësh ti,  
krejt papritmas unë një ditë,  
tek ti do të vij.

Në të thonë se t'kam tradhtuar,  
ta thonë për zili,  
veç me ty jam dashuruar  
ndaj do vij tek ti.

Në të thonë se jam zhdukur,  
ti mos u merriz,  
vish fustanin më të bukur  
e n'ballkon më prit.

Në të thonë se paskam vdekur,  
jo, ti mos beso,  
do gërryesh baltë e hekur,  
do vij domosdo.

Do vij me hov djaloshar,  
herët në mëngjes,  
të të puth me vrull, me zjarr,  
pastaj le të vdes.

## AH, DASHURIA...

Nga **OLTJONA SELAMAJ**

Trullosur më ka dashuria,  
trullosur, “goditur me gurë”,  
në shpirt vjen e shtohet magjia,  
kjo zemër përvëlton si një furrë.  
Më bëre shumë të të dua,  
zjarrin e zemrës më ndeze,  
perëndim nuk ka më për mua,  
shoh gjithëkund agime,mëngjeze.  
Shoh bukur, me sytë e shpirtit,  
symbyllur, ethshëm, të ndjej,  
do vij të të strukem në zemër,  
aty askush t’mos më gjejë.  
Më mbaj shtrënguar pas vetes,  
unë edhe ti jemi një,  
mbulomë me puthje pa fund,  
mes puthjesh do fle, pa bërë zë.

## PRITJET

Nga **SKËNDER LAZAJ**

“Mirupafshim”, them sa herë që iki,  
përherë me pak “lamtumirë” brenda,  
jo se bëj betime moskthimi,  
por s’i dihet nëse pret dot nëna.

Tërë një jetë ka në pritje nëna ime,  
e unë një jetë që i them: më prit dhe pak.  
Dhe Ajo më beson e më pret me bindje,  
se po kthehem, sapo jam nisur nga larg.

Në jetë e mbajnë të miat kthime,  
Ajo veç për pritjet rron, e di mirë.  
Kur “mirupafshim” i them e iki si hije  
pa vetëdije i kam thënë dhe pak “lamtumirë”!

## MË IKE

Nga **ZHANETA LAZRI**

Më ike, sikur deti të rrëmbeu,  
sa shumë rrëmbeka ky i shkreti det!  
Disa i merr në gj, rival me dheun,  
të tjerë i flak përtej, në tjetër breg.

Sado t’i zgjatim duart, s’na takohen,  
për fjalë e pëshpërime s’ka më vend,  
veç ëndrrat i thërres të më afrohen,  
e të më sjellin pranë imazhin tënd.

Ky det, shpirt i pafund, mister i rrallë,  
me sytë e tij, pasqyrë kaltërsie,  
në ma përcjelltë mallin tënd si dallgë,  
do të ta rikthej - puhizë dashurie!

## DHURATË

Nga **RAKELA ZOGA**

Unë e di, ti s’je si të tjerët,  
je Perëndi,  
në u dashtë të kem një Zot në zemër  
Ai le të jesh Ti.

Unë flas me Ty si me mbretërit,  
se Ti në shpirtin tim mbretëron,  
të gurtë të kam skalitur,  
më duaj, mos më rrëzo.

Ti s’je si të tjerët, je dashuri,  
më thua të vij si princeshë,  
me degën e blirit më prit  
e qeshjen e syve të mi.

## FORMA IME MBI RËRË

Nga **MIMOZA ÇEKIÇI RISTA**

Atë ditë lashë gjurmë në rërë,  
ti gjurmë më le thellë në shpirt,  
kuqtoj, ishte i qetë liqeni atë ditë  
dhe unë, kaq e vogël...e brishtë....  
Atë ditë... Vetëm atë ditë,  
nuk di pse dielli digjte aq shumë  
e unë nuk e shuaja dot etjen  
nga etja do pija të tërin një lumë.  
Nuk e di se nga dole ti papritur,  
e më mbështolle me krahët e tu,  
ma puthje me zjarr buzën e zhuritit  
e unë shkrihesha në sytë e tu blu.  
Pastaj më shtrive pranë gjolit me valë,  
me trupin tënd më mbulove të tërën,

se ç’ndodhi atë ditë kush e mori vesh,  
vallë, veç format e mia që mbetën mbi rërën.

## TEK UNË KA MBETUR NJË VEND BOSH

Nga **ILJAZ BOBAJ**

Tek unë ka mbetur një vend bosh,  
një vend që vetëm unë e di,  
i fshehur, strukur në një qoshek,  
ka mbetur siç e ke lënë ti.

Aty s’ka hyrje, ndenje, dalje,  
as ike s’ka, se s’mund të ketë,  
është bosh si gjithë boshësitë,  
po kurrësesi një vend i shkretë.

E mbush me praninë e saj,  
mungesa jote cak më cak,  
rrugicave të tij, i lodhur,  
gulçon ky malli im idhnak.

Ca fjalë që rrinë përherë të ngrohta,  
sikur i puth vala e zjarrit,  
drithmojnë si një këngë zogu,  
që pret në mes pushkë e gjahtarit.

Gjithçka s’është tjetër, veç mungesë  
dhe rron si një mosqenësi,  
qenka e thënë, aty ku s’je,  
të mbetesh në përjetësi.

Tek unë përherë një vend bosh  
një vend që vetëm unë e di,  
i fshehur, strukur, në një qoshek,  
s’e zë kush tjetër, se je ti.

## SHQIPËRIA IME

Nga **NASE JANI**

Shqipëria ime me bukuri të rrallë,  
si hënë pa dritë, me sy të palarë...

Shqipëria ime, që vdes të jesh gjallë,  
e mbetur në udhë, si nuse pa kalë...

Shqipëria ime e gjitha legjendë...  
1001 shekuj, të vranë e të prenë...

Shqipëria ime: një milion tradhti,  
kush qeshi aq shumë, kush qau sa ti?!

Shqipëria ime, që je e do jesh,  
ujkonjë në mesnatë, princeshë në mëngjes...

## ZËRI I BORËS

Nga **TEUTA HAZIRI**

Më pëlqen me mbledhë borën  
në shuplakë,  
me e ba topa,  
me e hedhë në dritaren tande,  
me të thirrë me zanin e borës,  
me u shkri  
e ngjët për xhami  
me dy duart,  
me e grye akullin me thonj,  
me të puthë nga jashtë,  
buzët me u ngjët  
në akullin e xhamit...  
I baj topat,  
i hedh lart  
dritarja jote asht shumë larg  
nga kjo dorë,  
nga kjo borë.

## BOTË KAFAZESH

Nga **BARDHA MANCE**

Kafaze të vjetra  
Kafaze të rinj  
Që hapen e mbyllen  
Hap të vjetrin  
Futesh tek një i ri  
Botë pa kafaze shpirtërash  
Ku Unë mbetem Unë  
Dhe Ti je Ti  
Në universin e paqes  
Kjo a nuk duhet të jetë  
Bota tënde njeri?

## ME HESHTJE PËRGJIGJEM

nga **JOSIF GEGPRIFTI**

Edhe në vargjet që shkruaj,  
Nuk munda dot  
Ta largoj heshtjen,  
Që shpirtin  
Aq ndjeshëm ma ka pushtuar.  
Me heshtjen  
Kam ecur kudo në rrugë,  
S’më kanë pëlqyer  
As zhurma e as buja.

Edhe kur më përflasin  
Me patëdrejtë e me shpifje,  
Si përgjigje  
U jap  
Heshtjen  
Dhe buzëqeshjen time.

## ATDHEU IM.

Nga **ASTRIT BLLACA**

(Për gjithë emigrantët).

Atdhe, u ushqeva me ty kur isha fëmijë,  
pa e ditur, kafshatë më kafshatë symbyllur të kapërdija,  
dhe ditëve e netëve kur s’kisha asgjë për të ngrënë,  
me vrap fëmijënor, në prehrin tënd unë vija.

Atdhe, jam rritur tani, jam bërë burrë,  
e të kërkoj më kot në hapësirën pa fund,  
nuk të kërkoj si burrë por prapë si fëmija,  
që nënën kërkon e portën furishëm e tund.

Ku të kërkoj Atdhe, më thuaj, ku të të gjej,  
s’ka ngelur nga trupi yt asnjë shenjë,  
tek tuk gjej ndonjë kockë që zbardh që përtej,  
tek tuk kur kërkoj, gjej nga ty ndonjë rrënjë.

Më ndoqën Atdhe, ata që të donin për vete,  
më ndoqën si djalin plangprishës i ati, e ndjek  
nga shtëpia,  
dhe ika Atdhe e mora rrugët e botës,  
unë ika me gjysmën e shpirtit që prapa e lija.

Dhe sa herë për ty Atdhe, uria më merr,  
të kthehem dua atje ku u rrita fëmijë,  
ta ngjyey kafshatën në lotët që rrjedhin si lumë,  
t’mos endem jetim që s’ka vend ku të rrijë.

Më thuaj Atdhe, unë a të dhimbsem ndopak?  
Apo ata egërsirat asgjë s’kanë lënë më nga ty,  
më thirr të vij, i ri në jam ap plak,  
u lodha së enduri rrugëve me lotët në sy.

## NË GARË?

nga **LUMO KOLLESHI**

Eh, të ishin kuaj, do t’i puthja në ballë.  
Me jelet e tyre,  
fjongo dhe gërsheta do të bëja për metaforat,  
por,  
po ma plas shpirtin kjo garë me horra.  
Në garë,  
baltarë,  
kush të hedhë baltë më shumë,  
mbi vlerat e kombit kush të hedhë më parë.  
Sa qumësht gjiri i nënave të gjora  
Paska shkuar dëm për horra!

## MALLI

Nga **MARJETA MUSARAJ**

Flladi i detit dhe lotët,  
mallin e trazojnë me dhimbje.  
Shpirtit tim syçarë vite e vite,  
Më rikëthen aty vendlindjes time.  
Fluturimthi si mijra vite drite.  
Vendlindja ime,e bukura, përrallore,  
me detin e stërlashtë Akrokeraon,  
me malet Himerike,ku lindi Zeusi,  
Zjarri dhe Zëri i truallit tonë.  
Të lutem jam larg,dhimbjen dëgjojme,  
Ndjemi lotët e kripura mollzave  
Shikoi kur bien tokës dhe kanë shpirt  
Ata s’tahen as avullojnë tokës së kurbetit  
Rrijnë në këmbë më flasin përditë  
Se nuk dua këtu as pallatin e mbretit.  
Doja strehëzën time aty dheut tim,  
të qeshja të gëzoja mes njerëzve.

## MË PRIT O NËNË

Nga **SHEFIK ARIFI**

Të lash tek porta me lot në sy  
Që atëherë kanë kaluar shumë vite,  
Një pjesë e zemrës më ngeli aty,  
Nënë gjithmonë me lot në sy më prite.  
Te pragu i derës vazhdon akoma më pret,  
Më dhe një amanet kur ne u ndam,  
Guri i rënd mor bir në vend të vet  
Fjalët e tua anash kurrë si kam lënë.  
Më djegë malli për tuat përqafime  
Mezi po e presë o Nënë atë ditë,  
Do të kthehem në çerdhën time  
Aty te pragu i derës të lutem më prit.  
Për atë fjalë e për atë besë  
Këtë nga jam nuk dua të vdesë,  
Më prit se do vij fluturim  
Si Shqiponja në vendin tim.

# Zbulohet viti i lindjes së poetit me origjinë shqiptare “Sangiorgiorgese” Giulio Variboba

(Vijon nga faqja 13)

D. Giovanni Arciprete Variboba vieç 59,  
janë bashke edhe gruaja vieç 50 dhe Giulio  
Giglio Chierico vieç 18, banues shtëpinë e tyre  
e vendosur në kontradën e Variboba, dhe në  
kufi me shtëpinë e Martino Variboba.

-Është e qartë që djali i arciprete D. Giovan-  
ni Variboba vieç 18, lindi në 1725, duke qënë  
në Kadastë onciario në S. Giorgio in Korigliano  
e përfunduar në 1743 siç rezulton në fron-  
tespizio të kadastën që i përmban.

-Pjesa që tregon D. Giovanni, Arciprete  
Variboba (qytetar ekleziastiko në shekuj), ai  
mund të nxierë në pah nga kadasta onciario  
e Universitetit të San Giorgio në Korigliano në  
1743, i konservuar në Arkivat e Shtetit Napo-  
litan. Si më poshtë mun të lexoimë datën e  
lindjes në shifra romake: lindur në XVI Prill  
MDCCXXV. Edhe pse ky ritrat i përkiste Kol-  
legjit. Shën Adriano, dhe nga njoftimet e para  
të sigurta që kemi në dorë i përkiste bashkë  
me piktura të tjera shkrimtarit Shqipëtarë Luig  
Curakuqi (1879-1925) në kohën kur ai stu-  
dionte në Kolegjin Italo – Albanese të “San  
Demetrio Corone” (1897).

Burime të tjera dokumentare për këtë gjë do  
të bëhen të njohura sa më shpejt, në konfer-  
mimin e zbulimit straordinar që sjell në dritë

çeshtjen e viti të lindjes të njërit nga poetët  
më të mëdhej të letërsisë Shqipëtare. Konfer-  
mimi i datave të mësipërme mund të vihet në  
dukje edhe nga kërkimet e zhvilluara nga his-  
toriku Vincenzo Librandi nga Vaccarizzo Al-  
banese: Gjenetika, historia e një komuniteti.  
Familje dhe vëndet të kujtimeve . Në një akt  
notaril të 27 Tetor 1739 e (sjellë në dritë)  
nga shkrimtari gjurmuar që e falenderojmë  
për mirësinë, dhënia nga ana e babait prift  
a Giulia Variboba i fondeve në agrikulturë të  
një shtëpie për të vazhduar ritualitetin për të  
hyr në urdhërin e shenjtë.

Ky urdhër bëhej zakonisht në moshën 14  
vieç siç rriedh edhe nga një akt i vitit 1829  
nga Librandi, kur Nicola Masci di Michele,  
nxënës i kolegjit e Sant’Adriano-s, lindur  
në 1815 dhe në 14 vieç urdhërin klerikal.  
Kështuqë qartësohet ky dokument që preçi-  
zon 1725 vitin e lindjes të Giulio Variboba.  
Trajtuar nga Vincenzo Librandi: VAKARICI:  
Vaccarizzo Albanese: prejardja dhe historia  
e një komuniteti. Familje, ngjarje dhe vënde  
historike,vol 5 (1759-1763) i vetëm. Ritrati  
“D. Giulio Variboba në Corigliano, ecclesias-  
tico di Roma, Lindur në 16 Prill 1725.

(Perktheu Ana Bisholla)



# Pena të arta franceze për shqiptarët

Si na shohin të huajt... "Shqipëria nuk është vendi më i varfër i Evropës, por një vend i pasur i varfëruar"

Nga YLLI POLOVINA

Fotograf Andrea, në fillim të viteve dymijë ambasadori i Republikës së Shqipërisë pranë Këshillit të Evropës në Strazburg, është njëkohësisht një përkthyes e sidomos studiues mjaft origjinal i historisë kombëtare. Njëri prej librave të tij, të cilit i ka ardhur koha të ribotohet, titullohet "Pena të arta franceze për shqiptarët". Duhet thënë se, në krahasim me britanikët, gjermanët dhe italianët, politikisht apo për arsye gjeostrategjike, gjykimin francez për ne është më pak i ngarkuar me interes deformues të imagjinit.

-Që në vitin 1877, një shekull e gjysmë shkuar, francezi Lui Bonljë (Louis Bonleë), kur botoi librin e tij interesant "La Grèce avant les Grecs" ("Greqia përpara grekëve"), u shpreh se emri shqiptar ngjante me fjalën shqiptoj, por kjo që një pikëpamje të cilën e braktisi shumë shpejt dhe nguli këmbë tek varianti shqiptar-shqiponjë. Doemos më shumë se saktësi shkence që shprehje mirësie për ne.

-Në këtë mjedis dashamirës dramaturgu, romancieri dhe moralisti Shari-Jozef de Linjë (1735-1814) (Charles-Joseph de Ligne) në shkrimin "Batalioni i shqiptarkave", përshkruan "dyçind gra dhe vasha bukuroshe, me dyfekë, bajoneta dhe heshta, me flokë të gjatë e të gërshetuar hijshëm...". Ai vë në dukje se popullit që ato i përkisnin "as që ka këtu lypsa apo përdërës".

-Ambasadori i Francës në Kostandinopojë, Konti Shuasël-Gufjé (1752-1817) (Le Comte de Choiseul-Gouffier), spikaste për shqiptarët: "Janë të gjithë shtatlartë, të dobët, të shkathët dhe tërë nerv".

-Konti Lamartin në një rast tjetër definon: "Çdo qytet, çdo krahinë, çdo fshat, njëjtë një princ, një fisnik, një bej, që qeveris despotikisht, sipas traditave dhe zakoneve. Ky nënshtrim i qyteteve, krahinave, fshatrave, para fisnikëve apo princërve të tyre feudale nuk cenonte aspak ndjenjën e lirisë së përgjithshme dhe pasionin e patriotizmit, qëllim i lartë tek shqiptarët".

-Baroni Feliks de Bozhur (1765-1836) (Felix de Beaujour), emri i vërtetë i të cilit që Lui Ogyst Feri (Louis Auguste Feris), politikan i ngarkuar me mision diplomatike por në kohën e vet edhe deputet i qytetit të Marsejës, në nderim të të cilit Akademia e Shkencave Morale dhe Politike të Francës jep një çmim, theksonte se "Shqipëria i ngjason Zvicrës për nga malet e saj dhe është më shumë e mbrojtur nga natyra se nga arti i luftës".

-Dijetari, historiani, natyralisti, arkeologu, diplomati, për shumë vite edhe konsulli francez pranë Ali Pashë Tepelenës, Fransua Pukëvil (1770-1838) (François Pouqueville), pa dyshim një ndër ata të huajt që na kanë njohur më mirë, ndërsa ka këmbëngulur se "Shqiptarët janë njerëz të maleve", është shprehur po ashtu: "Nuk përdorin art për t'u maskuar". Ai ka vënë re se "Sapo u krijohet mundësia të vendosen në një ofiq, mendjen e kanë tek të ardhurat që do nxjerrin..." Pukëvil nuk ka harruar të vërë në dukje: "Gjithë entuziazëm për vendin e tyre, nuk flasin kur-

rë për të veç për ta nxjerrë mbi të tjerët...".

Ka theksuar ndër kohë: "Nuk shkojnë ndër mend vuajtjet që kanë kaluar... rreziqet e vazhdueshme që i kanosnin, por pavarësinë që gëzonin..." Fransua Pukëvil ka qenë i mendimit se "Shqiptarët krijojnë një trupë kombësie më vete", se "në mërgim mbeten, gjithë mburrje, shqiptarë me zemër dhe me emër". Ndërkohë spikat: "trupë i zakonit i këtij kombi të ashpër e të fortë... të nënshtruar, por pa qenë skllevër". Ose nxjerr në pah për çdo lexues të huaj se shqiptarët janë "Më shpejt të nënshtruar ndaj autoritetit, më pak të lirë, por të pasur".

Pukëvil nuk harron të shkruajë se "Shqiptari i paaftë për mendje të zezë, nuk ushtron kurrfarë despotizmi ndaj grave; kurrë nuk i mbyll brenda dhe ato i qepen malit fytyrëzbuluar..."

-Fransua Viktor Lamar-Pikò (1787-1865) (François Victor Lamare-Picquot), ndihmësmjek ushtarak me mision në Korfuz dhe në Janinë, i dekoruar me Legionin e Nderit, ka vënë dukje se "Gjithë banorët e tjerë të Epirit quhen përgjithësisht shqiptarë apo epirotë. Edhe pse janë me zemër të gurtë, nuk është se janë pa cilësi, sado të egra të shfaqen". Spikat po ashtu: "Hakmarrja e shqiptarit është e pamëshirshme, por miqësia e tij është më se e sigurt".

Vëren: "Ka një guxim të pasqur në çdo sprovë. Asgjë nuk mund të krahasohet me shpejtësinë e marshimit të shqiptarëve dhe ushqimi më i paktë, një kokër hudhër, pak djathë dhe, u mjafton për të tërë ditën". Njëkohësisht ravijëzon se "Gratë shqiptare punojnë tokën dhe shpesh u bëjnë ballë rreziqeve përkrah burrave; por këta nuk i ndihmojnë asnjëherë në punët e vështira që bëjnë; madje rrinë dhe i vështrojnë në mundin e tyre, pa u dhënë kurrfarë ndihme..."

Fransua Viktor Lamar-Pikò ngul këmbë se "Luftarakë nga karakteri, shqiptarët vlerësojnë për zbulim veç armët". Po ashtu thekson: "Shqiptarët kanë një muzikë me ritëm shumë të thyer... Kjo muzikë me ashpërsinë e vet duket sikur vjen nga malet ku banojnë këta popuj barbarë".

-I lindur në 1807, një tjetër frank, studiuesi, gjuhëtar, profesori i letërsisë dhe i gjuhëve sllave në Kollëgjin e Francës, Siprien Rober (Cyprien Robert), ka shpallur këtë mendim për "homo albanicus": "Nativiteti i tyre bie në sy në krejt veprimet që bëjnë: të pafuqishëm për t'u maskuar, ata e shpallin çiltërsisht si urejtjen ashtu edhe miqësinë e tyre; shumë të butë në marrëdhëniet e zakonshme, ndonëse të zymtë dhe të heshtur, ata kanë të metën që s'dinë të falin". Ndërkohë vë në dukje: "Kryesisht njerëz të punës, ata rëmbejnë armët vetëm kur e shohin pisk".

-Agyste Mejlan (1840-1897) (Auguste Meylan), udhëpërshkrues dhe pamfletist, është i mendimit se "Fiset shqiptare kanë për prijtës kapitenë apo bajraktarë që gëzojnë një autoritet shumë më të gjerë se



vajvodët e fiseve sllave...". Në vijim: "Zakonet shqiptare janë tepër të çuditshme dhe nuk kanë lidhje me ato të popullatave të tjera të Ballkanit. I guximshëm, i pavarur, krenar për lirinë e tij, shqiptari, qoftë i krishterë, qoftë mysliman, kërkon të jetojë i lirë dhe i qetë në malet e veta. Nuk pranon as tiraninë e Kostandinopojës, as sundimin sllav. I përbahet rriteve, zakoneve e traditave të veta dhe-gjë e çuditshme-has në Shqipëri shqiptarë myslimanë, ortodoksë katolikë, grekë e katolikë romakë".

-Në vitet 1873-74 Alber Dymon (Albert Dumont), studiues e udhërrëfyes, botoi veprën "Ballkani dhe Adriatiku". Në të thotë: "Shqipja është një gjuhë indoevropiane, që për nga rrënjët e fjalëve afrohet shumë më tepër me latinishten se sa me greqishten". Ai ka vënë në dukje gjithashtu se "Shqiptarët e malit asnjëherë nuk i janë nënshtruar kujt". Alber Dymon spikat edhe këto fjalë: "Vendi është i ndarë në klane që administrohen sipas dëshirës, ose më mirë që jetojnë sipas dëshirës nga që fjala administrohen nuk

Shqipëria nuk është vendi më i varfër i Evropës, por një vend i pasur i varfëruar.

-Baroni Pol d'Esturnel de Kostan (1852-1924) (Paul d'Estournelle de Costant), senator e mbi të gjitha i vlerësuar me çmimin "Nobel i Paqes" në vitin 1909, i ndodhi që në 1914 të udhëhiqte një mision ekspertizë në Ballkan. Për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare ai bashkëpunoi shumë ngushtë me mikun e madh të popullit tonë, bashkëkombësin e vet Zhysten Godar (Justin Godart). Senatori Pol në vitin 1914, në 15 mars, ditë e diel, në faqen e parë gazeta "Le Petit Journal" botoi editorialin "Pashallarët favorizojnë banditizmin..." Opinioni i redaksisë për shqiptarët ishte ky: "Kjo është racë energjike dhe e fortë, fatet e të cilës ndoshta do jenë të shkëlqyeshme në të ardhmen nëse qytetërimi i dobishëm vjen fatmirësisht për të ndryshuar karakterin dhe zakonet e tij".

-Profesori i historisë së mesjetës në Universitetin e Parisit X të Nanterres, specialist për çështjet e Mesdheut dhe drejtor i Qendrës së Historisë Shoqërore të Kulturave për Perëndimin, Henri Bresh (Henri Bresc) në vitin 1939 është shprehur: "E megjithatë ndjenja e origjinës dhe e veçantisë së tyre mbetet shumë e fortë; nuk ngatërrohen as me grekët, as me sllavët fqinjë".

-Natali Klejë (Nathalie Clayer), aktualisht studiuese e specializuar në Qendrën e Historisë të Studimeve të Larta në Shkencat Shoqërore në Paris, vështruar historikisht, ka këtë opinion të palëkundur për shqiptarët: "Nuk ishin servilë, ishin të guximshëm dhe parapëlqenin zanatin e armëve".

-Zhilber Gard (Gilbert Gardes), historian i artit, ish-sekretar i Përgjithshëm i Qendrës Kërkimore Kombëtare Shkencore, drejtor i promovimit të Kulturës së Shoqërisë Bashkimi Shq-



shkon në këtë rast".

-Zhak Elizé Reklus (1830-1905) (Jacques Élisée Reclus) ka qenë një gjeograf i famshëm francez, por edhe anarkist po aq i njohur. Pjesëmarrës në revolucionin e Komunës së Parisit, më pas shok i ngushtë me bolshevikun Sergej Bakunin, ai hartoi, përveç shumëvëllimëshit "Gjeografia e Re Universale" ("Nouvelle Géographie Universelle", edhe botime mbi anarkizmin. Reklus ishte i bindur se komunizmi prej natyrës së tij që anarkist, popull dhe njerëz të lirë pa asnjë qeveri. Njerëzimi, ngulte këmbë ai, tërë jetën ka ndjekur dy qëllime të tij kryesore: lirinë ekonomike dhe politike. Pikërisht ky gjeograf shumë i njohur në botë dhe që për pikëpamjet e tij anarkiste dhe subversive pati qenë i burgosur vazhdimisht, ka shkruar për popullin tonë. Dy nga formulimet e tij janë: "Shqiptarët dallohen në përgjithësi për mprehtësinë dhe finesën e shpirtit, për qartësinë e mendimit dhe forcën e karakterit" dhe "Mikpritës, të përkorë e të qëndrueshëm, këta janë në përgjithësi shqiptarët, popullsia e të cilëve, e shpërndarë mbi një territor gati sa ai i Zvicrës, nuk i arrin të një milion banorët. Po prapë, hijeshia e Shqipërisë nuk qëndron thjesht në bukurinë e pejsazheve dhe në karakterin simpatik të shqiptarëve".

-René Pinon (Renë Pinon), shkrimtar, historian dhe analist, në vitin 1911 shkruante se "...shqiptari është mbret i maleve; guetar, bari, ushtar apo kaçak... ai i bindet vetëm zakoneve të tij dhe fatin e lidh me pushkën që mban. Roli i tij historik është i lidhur ngushtë me natyrën e vet dhe kjo me atë të vendit të tij". Njëkohësisht Pinon është shprehur se "Vetëm shqiptari, nga tërë popujt e Evropës, ka përshkruar historinë dhe ka mbetur i ngjashëm me vetveten". Sipas tij "Iliria nuk ka histori të veçantë, por njerëzit që lindin në të janë të famshëm për energjinë e tyre disi brutale, aftësinë e tyre për luftë dhe për funksione publike...". Pinon është i mendimit se shqiptari është "I shkathët për të arritur caqet e nderimit dhe të përfitimit, është njeriu i vendosmërisë dhe i pasurisë".

iptar, autor në 1995 i librit "Udhërrëfyes për Shqipërinë" ("Guide per l'Albanie"), botimi më i plotë dhe më i shitur i këtij profili për vendin tonë, shpall se "Shqipëria nuk është vendi më i varfër i Evropës, por një vend i pasur i varfëruar. E pasur nga toka e nëntoka, e pasur me trashëgimi kulturore origjinale". Po ashtu tërheq vëmendjen e çdo lexuesi se "Shqiptarët nuk janë hordhi leckamanësh të uritur e të krisur, që lypin dyerve të Evropës. Shqiptarët janë një komb me diasporë të përhershme, që gjithmonë i ka dhënë gjallëri vendeve që kanë përfituar. Ndershmëria, respektimi i fjalës së dhënë, mikpritja, siguria në marrëdhëniet e ndërsjella, vlera tradicionale që arrijnë kulmin më të lartë në qytetërimin shqiptar janë përherë të rrënjësura në shtresat e thella të popullsisë". "Shtëpia e shqiptarit, ngul këmbë Zhilber Gard, është vatra e mikut dhe e udhëtarit".

-Aleksandër Dymë (1802-1870), autor i mbi 120 librave, ka përshkruar historinë dhe ka mbetur i ngjashëm me vetveten, kur përshkruan shqiptarët: "Shqipëria është një nga provincat më të vështira për t'u shfrytëzuar. Banorët e saj ishin mjaft të varfër, shumë të vendosur dhe, nga ana tjetër të fshehur natyrisht në vargmalet të ashpër. Pashallarët e kishin shumë të vështirë të bënin aty pasuri, sepse secili e kishte zakon të mbronte energjikisht bukën e vet. Muhamedanë apo të krishterë, shqiptarët ishin të gjithë ushtarë".

-Konti Lamartin (1760-1869), një nga poetët më të mëdhenj romantikë të vendit të vet, autor i 30 librave dhe në të njëjtën kohë edhe politikan, diplomat e deputet, ka nxjerrë në pah se "E vetmja gjë e pandryshueshme tek shqiptarët është pasioni i tyre për pavarësi e lavdi. Ky pasion i lavdisë është tipar sundues i karakterit të tyre dhe burimi i heroizmit: është toka e heronje në të tërë kohërat". Po ashtu ai vinte në dukje: "Disiplina tepër e rregullt e ushtrive evropiane u rëndon, parapëlqejnë shkëlqimin e bëmave vetjake...qytetërimin që i lejon skllevërit të ngjiten, sipas trillit të të parit të tyre".




# Beteja e Backes si Beteja e “Termopileve”

Nga MRSC BESIM DERVISHI

Njëqind e katër vjet më parë më 25 Korrik 1913, në “Qafën e Martës” në fshatin Backë të Skraparit, u zhvillua një ndër betejat më legjendare të çetave të Skraparit, Kolonjës dhe Korçës ndaj hordhive andarte. Skraparasi, kolonjarët dhe qoçarët luftuan krah për krah si burrat ndaj kriminelëve andartë. Po si rrodhën ngjarjet deri në këtë betejë të ashpër. Historia e teorisë së “Megali Idea-s” ka shënuar një nga faqet e saj më të turpshme dhe të urryer, sidomos me masakrat të cilat u bënë në jugun e Shqipërisë në vitin 1913-1914. Qeveria greke e asaj kohe nuk u mjaftua me marrjen e “Shqipërisë së Poshtme” (sic e quan Epirin e Jugut historiani John Foster Fraser në punimin e tij me të njëjtin emër, por dhe gjithë udhëtarët perëndimorë në vitet 1800) por pretendonte dhe mbi Kazatë e Gjirokastrës dhe Korçës (shih librin “L’Albanie en 1921. Preface de M. d’Estournelles de Constant” të autorit Justin Godart, faqa 259). Për këtë qëllim Qeveria e Venizellosit ideoi por edhe zbatoi në terren një plan për shkatërrimin e fshatrave shqipëtare sidomos në këto dy kaza por edhe në kaza të tjera si ajo e Beratit dhe e Vlorës. Po sipas autorit francez Justin Godart të gjitha fshatrat e kazas së Korçës dhe Gjirokastrës ishin shqipëtare përveç 18 fshatrave në Gjirokastrë të përbëra nga 400 shtëpi. Por banorët e tyre ishin fermer të thjeshtë të cilët ishin të punësuar nga pronarët e tokave në këto zona (shih librin “L’Albanie en 1921. Preface de M. d’Estournelles de Constant” të autorit Justin Godart, faqa 260). Konferenca e Ambasadorëve në Londër e mbajtur më 1, 5, 8 dhe 11 Gusht, caktoi një Shqipëri të cinguar. Por përsëri qeveria e Athinës nuk ishte dakort. Kjo konferencë unanimisht vendosi që të hotohej për përkatesin kombëtarë në Kazan e Korçës dhe Gjirokastrës nga KNK (Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit) dhe të gjitha këto të dhëna dhe rezultate të hidheshin në Protokollin e Firences (17 Dhjetor 1913). KNK rezultatin e të dhënave në terren ku caktoj vijën kufitare nga Shën Naumi – Konispol dhe vazhdon në kodrat Stilo deri në kuotën 254, e hodhi në Protokollin e Firences dhe në datën 13 Janar 1914 u njoftua qeveria greke në mënyrë kërcënuese që të largoj ushtrinë e saj nga këto toka.

Ndërkoh ministrit e Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë dhe Rusisë informuar Greqinë për vendimin e qeverive të tyre për të dorëzuar ishujt e Egjeut . Por ata i vunë kusht asaj që Protokollin e Firences do të ekzekutohet më parë. Pra Greqisë do t’i jepeshin ishujt e Egjeut kur trupat greke të ishin larguar nga Kazaja e Gjirokastrës, Korçës, Delvinës dhe Ishulli i Sazanit të cilat i mbanin të pushtuara. Evakuimi i trupave duhet të fillonte më 1 Mars 1914 dhe të përfundonte më 31 Mars 1914 (shih librin “L’Albanie en 1921. Preface de M. d’Estournelles de Constant” të autorit Justin Godart, faqa 263-264 ). Çfarë kishte ndodhur “de facto” në terren? 31 Marsi 1914, ishte dita e fundit ku forcat e rregullta të ushtrisë greke duhet të largoheshin nga Shqipëria.

Por qeveria greke njëkohësisht duke larguar trupat e rregullta të ushtrisë së saj, futi grupe të përbërë nga “Kretian” (ish të burgosur të arratisur nga burgu i Kretës) si dhe ushtarët grekë (dezertorë). Në planin politik Venizellosi nxiti dhe financoi një qeveri kukull, epirote me Kryeministër renegatin nga Shqipëria Jorgji Zeografos, Ministër të Jashtëm Aleksandër Kostandin Karapano si dhe Ministër të Luftës Kolonelin Dhimitër Daulis. Në këto operacione u përfshin direkt peshkopët e Gjirokastrës dhe të Korçës. Më 27 Mars trupat e rregullta të Ushtrisë Greke u larguan nga Gjirokastra ndërkohë që menjëher në terren ato u zvendësuan nga trupat të ashtëquajtura vorio-epirote. Turbullira dhe sulme u shënuan dhe në Korçë në 11 Prill 1914. Qeveria greke luajti një lojë të fëlliqur në Korçë. Ndërsa qytetin j’u dorëzoi shqiptarëve në fund të Marsit 1914. Ajo në mënyrë tinzare ka një numër të lartë të personelit saj ushtarak në spitalin e këtij qyteti me pretekstin se ishin të sëmurë (shih librin “Albania past and present” Constantin Chekrezi, faqa 139). Nga ana tjetër brënda qytetit ishte një bërthamë e njohur filo greke dhe simpatizant të Greqisë për shkakë se në Korçë ishte dhe Gjumnazi grek. Ky fraksion filo grek udhëhiqej nga Kryepeshkopi grek i Korçës. Peshkopi grek ishte ideatori i komplotit për pushtimin e qytetit të Korçës si dhe ura lidhëse dhe kordinatori midis ushtarëve grekë që ishin në spitalin e qytetit me simpatizantëve filo greke (shih librin “Albania past and present” Constantin Chekrezi, faqa 140). Natën e 11 Prillit ushtarët grekë dhe bashkëpunorët e tyre filluan komplotin. Nga pozicionet e marra ata sulmuan dhe në pak kohë morën ndërtesat kryesore të qytetit. Por shumë shpejt patriotët dhe populli i Korçës u bashkuan në luftë, dhe pas luftimesh të ashpër, i shpartalluan forcat andarte dhe filo greke. Pas kësaj andartë u përpoqën për t’u hakmarrë për humbjen e tyre duke kryer shumë mizori ndaj popullsisë së pambrojtur. Më agresivi në këto masa ishte grupi i të burgosurve nga Kreta- Kretianet (shih librin “Albania past and present” Constantin Chekrezi,



faqa 141) Një rast të cilin na e tregon autori Chekrezi ishte ai i Manastirit të Kodrës. 218 persona, pleq, gra dhe fëmij ishin strehuar në Manastirin Ortodoksë të Kodrës. Andartët hoqën një pjesë të çatisë së Manastirit dhe nga andej filluan të qëllonin me armë zjarri refugjatët e pafat që ishin mbyllur në manastir. Pasi ju mbaruan fishekët andartët hynë në Manastir dhe i therën të mbijetuarit me thika dhe sopatha. Ky ishte një krim i tmerrshëm që vështirë se mund të imagjinohet në ditët tona. Por raportim zyrtar të masakrës, e shkroi gjenerali De Weer i Misionit Holandez. Ai konfirmoj në këtë raport se kjo ishte masakra më revoltuese në historinë moderne. Këto mizori barbare dyfishuan guximin e shqiptarëve të cilët e kuptuan tani se kjo ishte një luftë për jetë e vdekje. Bandat ishin fajtoare për krimet më të rënda, ato shkatërruan, dogjën edhe placitën vendin, masakruar popullsinë (shih librin “Albania past and present” Constantin Chekrezi, faqa 142) . Gjatë kësaj kohe Gjenerali Papulias, i ushtrisë mbretërore greke, hodhi këmbësorinë e tij dhe artileri kundër shqiptarëve duke i detyruar ata të ndalen. Megjithatë, Qeveria greke hodhi poshtë të gjitha përgjegjësitë rreth kësaj ngjarje. Në këto momente Evropa mendonte se ishte e këshillueshme të ndërhyhej dhe u organizua Protokollin famëkeq i Korfuzit por edhe gjatë këtyre negociatave grekët dogjën Tepelenën dhe Leskovikun. Nën hundën e Komisionit të Kontrollit, rreth tre mijë ushtar u transportuan nga Korfuzi për në Shqipërinë e Jugut ((shih librin “Albania past and present” Constantin Chekrezi, faqa 143).

Edhe gjatë periudhës Maj- Korrik 1914 u bënë shumë masakra të llahtarshme. Një nga autorët që i përshkruan me detaje këto masakra është Kosta Papa nga Përmeti në librin tij me titull “Barbarite Greke në Shqipëri”, botuar në USA 1917: Në këtë punim ai tregon me fakte se në operacione u përfshinë oficer të rregullt të ushtrisë mbretërore: “...Andartët bënë përgatitje për ofensivën kundër Kelcyrës dhe Cepanit e cila nisi ditën e Hënë, 29 Maj, 1914. Plani i ofensives u bë kësajsoj: Fjorgakaqi, Jorgollaqi, Qiro Vaso, në Miçan do t’i binin Backës. Kapedan Farmaqi në Malind do t’i binte Koprëncës. Sotir Bubuna në Sevran, do t’i binte Qafës së Rogut. Kapedan Niko Aristidhi dhe trupat e Kocifaqit ne Qarishte, do t’i binin Muzhakës. Në ofensiv do të merrnin pjesë dhe Kapedan Psaroj, Papa Jani, Kapedan Zerva, Kapedan Kollovoj, trupat e Karaxhajt me gjithë topa. Ofensiva zuri në orën 2 në mëngjes në Qarishte (shih fq. 66) . Më tej autori tregon me detaje se topi nga Brezhdani po e bombardonte pa pushim Kelcyren, topi nga Miçani po bombardonte Backen (shih fq. 66). Në pyllin e Qarishtes u perleshën trup me trup andarte dhe shqiptarët, u vranë 4 andart dhe 4 u plagosën. Shqiptarët u terhoqën pas disa orë luftimesh të përgjakshme kjo fal epërsisë numerike të armikut dhe armëve të rënda të cilat zotronte ai. Atëhere andartët hynë në Backë, Corovodë, Sevran, Rog, Muzhakë, Cepan, Prishtë, Turbohovë, Vlsh, Cjerbës, Spatharë, Vëndresh e të tjerë fshatra, ku dogjën dhe vranë fëmij, gra dhe pleq. ( shih fq.67). 300 barrë me kuajë dhe karroka i dërguan në Janinë. Me mijëra krerë gje të gjall shkuan në Greqi. Në Backë u therën 30 gra dhe foshnje, të cilat nuk harritën të shkonin në Zhepov. 15 gra me djep në krahë i zunë dhe i therën me gjithë foshnjat që kishin. Shqiptarët u demoralizuan se nga një anë kishin andartët kurse nga ana tjetër bandat esadiste të cilat zunë Beratit. Shumë banorë të zonës së Skraparit shkuan “muhaxhirë” në Berat dhe rrethinat e tij, por dhe atje mundoheshin nga bandat esadiste, shumë nga këta persona vdiqën nga mosushqyerja dhe kushtet e këqija, por ata që mbijetuan vendosën që të ktheheshin. Mbi 400 fëmijë u kthyen ne Skraparë, të cilët ranë në pabesin e andartëve (shih fq.67-68). Bandat andarte në shenjë hakmarrje shkuan deri



Interesante është letra e dërguar nga Vloja e Edith Durham dhe e botuar në gazetën prestigjioze “The Times” ditën e Mërkur, 15 Korrik 1914. Në këtë letër përshkruhet masakra mbi banorët e pafajshëm të fshatit Backë në Skraparë nga forcat kretiane si dhe sulmi dhe masakrimi që i ishte bërë refugjatëve të Skraparit ( shih librin “Albania’s Greatest Friend: Aubrey Herbert and the Making of Modern Albania”, autori Aubrey Herbert , faqa 184). Deputeti Aubrey Herbert përmend në librin e tij arrestimin e dy oficerëve të andartëve dhe mbajtjen në burgun e Vlorës nga KNK dhe oficerët holandez. Ata si dhe armët e sekuestruara dyshoheshin për masakrat e bëra në Hormovë dhe Backë (po këtu fq. 185)

Beteja legjendare e “Qafës së Martës” Backa ka qënë një çerdhe e patriotizmit Shqipëtar. Këtë e përmend dhe historiania franceze Nathalie Clayer e cila në librin e saj thekson se sidomos teqejja e Backës me Baba Fetahun ishte vatra e këtij patriotizmi ( shih “Aux origines du nationalisme albanais: la naissance

d’une nation” Nathalie Clayer , faqa 547). Ceta e Lace Backës ishte spikatur sidomos në përpjekje me turqit në vitin 1900 në fshatin Panarit (Shih librin “Riza Kodheli” Haxhi Çemeric, Ilir Buzali, fq. 6). Repartet turke të ndjekjes ishin bërë vizitor të rregullt në Backë sepse ai fshat ju nxirrte vazhdimisht telashe, sidomos për djemtë që duhet të shkonin Nizamë. Në këtë kohë në Skraparë u formuan dhe çeta të tjera përveç çetës së Lace dhe Zoto Backës me djem që nuk praninin të shkonin nizamë, si çeta e Servet Zaloshnjës, Ali Farmaqit. Në vitin 1906 çeta e Lace Backës së bashku me çetën e legjendarit Mihal Grameno kanë shpartalluar forcat turke në fshatin Staraveckë. Po këtë vitë tridhjetë delegatë me në krye Lace Backën, Zoto Backën, Ali Farmaqin, Servet Zaloshnjën, Riza Kodhelin, Kaso Borockën, Qamil Krushovën, Hysen Radëshin dhe të tjerë morën pjesë në mbledhjen e Frashërit. Në këtë mbledhje u dhanë udhëzime të Komitetit të Manastirit për të krijuar çeta luftëtarësh që do të godisnin pushtuesin si dhe për të çelur shkolla shqipe në çdo fshatë (Shih librin “Riza Kodheli” Haxhi Çemeric, Ilir Buzali, fq. 5 si dhe librin “Riza Cerova” me autor Mane Nishovën, faqa 12). Por të fitasim për betejën e Qafës së Martës. Konsiderohet si më e madhja dhe më historikja . Ajo u zhvillua nga 25 Korrik i vitit 1913. Prof. Skënder Luarasi e ka quajtur me të drejt, “Beteja e Termopileve”. Ashtu si 300 spartanë të cilët luftuan heroikisht kundër ushtrisë perse nën udhëheqjen e mbretit Leonidhas. Ashtu dhe 150 skraparas, korçarë dhe kolonjarë, nën udhëheqjen e komandantëve legjendarë Lace dhe Zoto Backa, Sali Butka, Qamil dhe Xake Panariti, Riza Kodheli pas luftimesh të përgjakshme të cilat zgjatën disa ditë gozhduan mbi 500 forca kriminale andartësh, duke j’u shkakuar humbje të mëdha.

Kjo betejë ishte dhe një fitore strategjike sepse andartët grek të cilët hynë nga Marjani i Korçës, kishin si piksynim pushtimin e Skraparit dhe qytetin e Beratit dhe atëhere mundet të quhej gati e realizuar ëndrra e tyre gati shekullore e “Megali Idhese”. Me të marr veshë dhe kuptuar qëllimin e andartëve, Lace Backa lëshoj kushtimin në të gjithë zonën. Në ndihmë të Lace Backës shkoi Sali Butka i cili si fillim takoj dhe u keshillua me “Beun e Melovës” dhe vendosën të mblidheshin në Turbohovë, në atë që u quajtë “Kuvendi i Burrave” të gjithë zonës. Në këtë kuvend morën pjesë banorët e Tomoricës, Cjerbës, Grevës, Melovës, Grëmshtit, Kucit e tjerë. Kuvendi u mbajtë në shtepinë e Fetah Ymer Koxhabellitu. 58 luftëtarë të lirisë u rregjistruan në çetën e Sali Butkes. Menjëherë pa humbur kohë kjo çetë nën komandën e Sali Butkës u nisë në drejtim të “Qafës së Martës. Në këtë betejë morën pjesë dhe çeta e Servet Zaloshnjës, çeta e Ali Kucit dhe çeta e Muco Kapinovës. Lace Backa me të vënë re andartët të cilët po vini si mizëri nga Marjani mblodhi çetën e tij me gjithë Zoto Backën dhe Riza Kodhelin.

Si një strateg i lindur dhe njohës i mirë i terrenit ai vendosi që duhej kapur pika dominuese e “Shkëmbit të Bardhë” Kjo detyrë j’u ngarkua Zoto Backës i cili me disa trima u nisë menjëherë dhe e zunë atë pozicion sundues (Shih librin “Riza Kodheli” Haxhi Çemeric, Ilir Buzali, fq. 11). Luftimet ishin të rrepta, armiku ishte në epërsi numerike në një raport 1 me 5, por edhe në epërsi ushtarake. Kjo u dukë kur pozicionet e luftëtarëve të lirisë u bombarduan me armë të rënda si topa nga Kisha e Marjanit. Pas shumë orë luftimesh Lace Backa plagoset, por luftëtarët e lirisë e vazhduan betejën. Vëndi ishte mbushur me kufoma andartësh. Nuk vonoj dhe disa ngritën flamurin e bardhë. Beteja ishte fituar por pa komandantin e saj. Në këtë betejë ra dhe Qamil Panariti dhe disa luftëtar të tjerë. Jehona e kësaj betejë i kaloi kufijet e Skraparit dhe Shqipërisë. Fitorja e saj kishte disa efekte. E para u ndal hovi i hordhive. E dyta u shpetua Skrapari dhe Berati. Dhe e treta kjo fitore j’u percolli mesazhin gjithë shqipëtarëve se pa bashkim nuk ka liri.

Kohën e fundit janë disa të ashtëquajtur historian të “rinjë” të cilët propogandojnë në mënyrë të paturpshme se lufta ndaj andartëve ishte luftë me karakter fetar apo etnik. Jo gaboheni të nderuar historian, lexojeni mirë historinë, çeta e Lace Backës luftoj me vëllezrit e saj të çdo besimi kundër çdo lloj armiku. Kjo çetë bashkëpunoj me çetat e Sali Butkës, Qamil dhe Xake Panariti, Servet Zaloshnjës. Por edhe me çetat e Mihal Gramenos, Themistokli Çermenjit. Ishin këto çeta që luftuan njëjloj si në Panarit (1900), Staraveckë (1906) Përmet (1909) kundër turqëve, ashtu dhe në 1913 dhe 1914 bashkpunuan njëjloj kundër andartëve kretiano-grek. E njëjta vlen edhe për çetat e Sali Butkës të cilat bashkëpunuan me çetat e Mihal Gramenos, Spiro Ballkamenit, Themistokli Çermenjit. Ndaj teoria juaj është e vjetër dhe përçarse dhe i ka kaluar koha. Misioni juaj është antishqipëtar.

# Nuk ka një treg të mirëfilltë arti të strukturuar apo kodifikuar

INTERVISTA/ Flet piktori i talentuar Edmond Kojani: Ekspozita "Udhëtim në kohë" synoi, sjelljen në vëmendje të monumenteve të kulturës



Nga Albert Z. ZHOLI

Edmond Kojani është një piktor që ka hapur ekspozitë qysh në sistemin socialist. Vlorë i ka dhënë atij aromën e detit për një ideim dhe forcë interpretuese krejt të ndryshme. Plot 12 ekspozita që ka hapur (në Vlorë të parën në vitin 1988) në Vlorë, Greqi, Tiranë, Durrës, Fier, Sarandë, Berat, etj dhe rreth 100 piktura në gjininë e peizazhit përbëjnë arkivin e tij që do ta kishte zili çdo piktor. Por ekspozitën e tij të fundit të para disa ditëve në Muzeun Kombëtar "Udhëtim në kohë" ai e quan të veçantë për specifikën e tij. Qëllimi i ekspozitës ishte promovimi dhe sjellja në vëmendje e monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike si pjesë e trashëgimisë sonë kulturore.

## Ekspozita e fundit në Muzeun Kombëtar titullohet dhe me sa piktura u paraqitë?

Ekspozita ime e fundit në Muzeun Historik Kombëtar titullohet "Udhëtim në kohë" dhe përbehet prej 35 veprash, peizazhe në vaj. Ishte një ekspozitë që ngjalli shumë interes për vetë tematikën e saj.

## Çfarë kishte si qëllim kjo ekspozitë? Mbi çfarë baze apo kërkesash u organizua ajo?

Qëllimi i ekspozitës ishte promovimi dhe sjellja në vëmendje e monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike si pjesë e trashëgimisë sonë kulturore. Kjo për sa i përket tematikës të saj. Por kërkesa ime në realizimin e tablove ishte thjesht artistike. Imazhet e objekteve të pasqyruara vinë të përpunuara në filtrin e laboratorit të krijues, pa paragjykimin detyrimisht të konkretësish. Ato i dominon drita apo drite -ngjyra, ajo drite e brendshme e ngjyrave të pikturave të mia, si instrument kryesor për të paraqitur realitetin.

## Sa ekspozita keni hapur, ku dhe cila ka qenë më e suksesshmja?

Kam hapur 12 ekspozita (në Vlorë të parën në vitin 1988) në Vlorë, Greqi, Tiranë, Durrës, Fier, Sarandë, Berat. Nga këto do veçoja dy të fundit "Gjirokastra në penelin e Edi Kojanit" në 2015 në MHK dhe "Udhëtim në kohë" ku ka më shumë siguri profesionale. Kontrapunti i ngjyrave, ngjyra tonesh të larta e të ulëta. Këto jo si nevojë më shumë e gjendjes sime shpirtërore por sipas nevojës ekspresive. Po kështu marrëdhënia me objektin nuk shprehet tërësisht me narracion por dhe me mjete formale të koloritit, linjës, formës, kompozimit dhe kontrastit në ekspresionin e tyre.

## Pikturat tuaja janë në vaj, kjo është teknika-boja që ju preferoni dhe pse?

Teknika e vajit të mundësin të shprehesh maksimalisht në thellësi e në gjerësi. Me anë të kësaj teknike arrin të thellosh efektin fillestar emocional dhe pasurinë e dëshiruar koloristike.

## Sa piktura me peizazhe ruan në arkivin tuaj?

Kam rreth 100 piktura në gjininë e peizazhit nga disafish të krijuara.

## A mund të jetoj sot në piktor vetëm duke pik-

## turuar?

Është e vështirë, por nuk mund të themi që jemi tërësisht në një terren të shkretët. Ka artistë që janë të kërkuar në treg falë punës e artit që ofrojnë. Gjithsesi ky problem ka kontradiksionet e veta me ulje ngritje të ndikuara nga faktorë të ndryshëm.

## A është bërë kulturë nga shqiptarët pasja e një pikturë në shtëpi?

Elemente të kësaj kulture kanë ekzistuar në Shqipëri dhe mund të themi që kjo kulturë është zgjeruar e nuancuar dukshëm. Kjo duket që nga prania e ndjekja e ekspozitave të pikturës nga qytetarë e artdashës. Sipas shkallës së kulturës e raporteve shoqërore të secilit. Artdashësit konsumojnë art. Një pjesë e mirë e tyre janë selektive në zgjedhje të orientuar si nga instinkti emotiv i tyre ashtu dhe nga emri i artistit. Jo të rrallë janë ata që janë kthyer në koleksionistë të vërtetë.

## Cilat janë problemet e piktorëve shqiptarë sot dhe cilat janë pikturat më të preferuara ato kalsike apo abstraksioniste?

Nuk ka një treg të mirëfilltë arti të strukturuar apo kodifikuar. E kam fjalën për mungesë menaxheri apo galerie që me kredibilitetin e tyre të krijojnë pak a shumë staturë artistësh, kuotim vlerash. Iket me opinionet kolegjesh e deri diku të disa segmenteve me një fare asesi në këtë drejtim. Gjithsesi po krijohet disa koordinata të këtij sistemi por të orientuar mbase në vektorin e artit postmodernist.

## Piktorët tanë a janë konkurrues me piktorët në Evropë?

Pse jo...ka artistë si Helidon Haliti, Gazmend Leka por dhe të tjerë që janë avangardë e këtij rivaliteti.

## Portreti, natyra e qetë, peizazhi, kompozimi, cila gjëni dominon në pikturat e tua, apo më mirë në cilën gjëni e gjëni më mirë veten?

Peizazhi dominon si gjëni në krijimtarinë time. Aty gjendem ë burimin e përhershëm të përjetimit ndjesor.

## Je penduar që je bërë piktor?

Jo aspak...do pikturoja sikur dhe një tjetër jetë të kisha, pasi ndjej që kam e dëshiroj të bëj shumë gjëra në pikturë e me pikturën.

## Cilët janë piktorët e preferuar tuaj në botë?

Tintoretto-për anën kompozicionale. Goya, për ekspresivitetin shprehës. Sisley -për dritën e koloritin. Nikolay Fechin-për tensionin e penelatës.

## -Në ekspozitat dhe konkurrimet a keni marrë çmime?

Vlerësimin për punën time e kam ndjere që para viteve 1990 ku kam marrë çmim të 2-të në Ekspozitën Kombëtare të talentëve të reja në vitin 1988. Gjithashtu kam punë të vlerësuara që ndodhen në Galerinë e qytetit të Vlorës, etj. Çmimi i 2-të në Ekspozitën ballkanike në Pejë, në vitin 2007. Vlerësim për punën më të mirë në koloninë e organizuar nga Bashkia Korçë. Personazh i vitit 2015 në qytetin e Vlorës. I vlerësuar nga kritike arti e artistë shqiptarë dhe pjesë e koleksionit të koleksionistëve në vend e jashtë.

# Ullinjët e Beratit në Uells

Nga NAMIK SELMANI, shkrimtar

Shfaqja e ansambllit artistik të Shoqatës Kulturore e Trevës së Beratit "Qyprlinjtë e Roshnikut ishte befasia më e madhe e atij Festivali Ndërkombëtar që organizohej në bition 2016 në qytetin Llandomen të Uellsit. Një qytet tipik me arkitekturën e qyteteve veriore të Evropës, të Britanisë së Madhe. Qoftë edhe me kulturën e mikpritjes dhe të atij bashkimi shpirtëror me artin e bukur që bën çdo komb sa do i vogël qoftë ai. Duket se jehona e tij do të shihej jo vetëm me Çmimet e shumta që do të merreshin atje, por dhe me ngjarje të tjera shumë më të bukura që i kalonin kufinjët e një skene dhe u bënë Ura të forta mes dy kombeve ku vetë Presidenti i Uellsit do të ishte personazhi i këtyre ngjarjeve atë ditë dhe më vonë. Grupi artistik përfaqësohej nga 18 artistë që kishin një repertor mjaft të larmishëm. Festivali bëhej në qytetin Llangollen. Aty u zbulua dhe një pllakë që i bënte jehonë kësaj ditë simbolike. Në konkurrimin e festivalit ndërkombëtar grupi i Beratit në mënyrë unanime, edhe pse morri për herë të parë pjesë në të, mori Çmimin e Publikut, Çmimin e parë për kostumografinë më të mirë. U mor Çmimi i Skenës. Një Çmim të veçantë mori orkestra e grupit që u vlerësua për mjeshtërinë e ekzekutimit. Vetëm për një zgjatje disaminutëshe jasht programit të caktuar nga organizatorët bëri që të mos merrej i Çmimi i Madh i Festivalit.

Në ceremoninë festive të ditës së fundit mori pjesë dhe vetë presidenti i shtetit të Uellsit, gjë që ishte një nder i madh për pjesëmarrësit. Grupi drejtohej nga vetë Presidenti i Shoqatës Fitim Mimani që është dhe vetë instrumentist mjaft i mirë dhe që ka një përvojë shumëvjeçare dhe mjaft trofe artistikë nga shumë vende. Me shfaqjet e dhëna në Turqi, Bruksel, Poloni, Kosovë, etj. Fitimit atë ditë si fitimtar i mjaft Çmimeve të asaj dite, atij i takonte balli i nderit të festës, por ai vuri re se në të mungonte flamuri kombëtar shqiptar. Këtë gjë ia vuri në dukje edhe vetë Presidentit. Ishte një mungesë protokollit, një pakujdesi e vogël, por dhe e drejtë e mohuar e kombit tonë, natyrisht që lidhej edhe me fitoret e merituar të grupit. Brenda një kohë të shkurtër u gjet flamuri kombëtar shqiptar dhe u vu në radhën e flamujve të tjerë të Evropës.

Në prezantimin që iu bë programit dhe artistëve të grupit, nuk u harrua fakti se vetë Fitim Mimani kishte dhe titullin e lartë të Ambasadorit të Paqes të marrë para pak kohësh nga misioni i OKB-në Tiranë. Programi befasoi të gjithë shikuesit që nga ai më i thjeshtë deri te vetë presidenti. Brenda disa minutash u vunë në të gjithë në lëvizje dhe flamuri kombëtar shqiptar u vu në radhë madje në fillim falë edhe renditjes alfabetike.

Atë çast presidenti i Shoqatës Fitimi, që vinte nga një zonë ku rritet ulliri, që është në të njëjtën kohë dhe simboli i paqes në botë. i shprehu dëshirën që të sillte në Uells një ullirin e parë nga Shqipëria në shenjë të mirënjohjeje për këtë mikpritje që iu bënë atyre. Apo edhe për të ngritur një Urë bashkimi shpirtëror të kombeve. Presidenti i Uellsit e mirëpriti me një buzëqeshje mjaft dashamirëse dhe me pak emocion, i kërkoi atij që të sillte jo një, por tre të tillë. U vendos do të sillleshin nga



Shqipëria e, më konkretisht, nga Berati i begatë me këtë dru të bekuar. U deshën 4 muaj që të bëheshin të gjithë punët organizative dhe protokollare pasi u zyrtarizuan sipas rregullave ndërkombëtare për t'i dërguar, qoftë edhe si objekte dhurimi këta tre drurë ulliri të përmasave të mëdha si dru dekorativ që ishin. Për t'i përcjellë në rrugë tokësore u zgjodh linja Berat -Londër, për të cilën u deshën dy ditë me udhëtim me një makinë furgon. Nga Londra në Uells u dërguan nga një shofer tjetër që Fitimi e kishte shok dhe që e bëri vullnetarisht. Ullinjët u nisën më datën 29 nëntor 2016 dhe mbërritën në datën 2 dhjetor 2016 në Uells. Në mungesë të presidentit atë ditë mori pjesë zonja Luiza që ishte në të njëjtën kohë dhe deputete e Uellsit në Dhomën e Deputetëve të Uellsit në Londër. Në takim natyrisht ishte dhe vetë zoti Fitim Mimani e një delegacioni i Shoqatës. Pas ceremonisë sërisht mori ftesën për të marrë pjesë në Festivalin e radhës që do të bëhej në Tiranë.

Për të qenë serioz në detyrën artistike që morën, grupi u mblodh që në muajin prill edhe pse shfaqja bëhej në muajin korrik. Objektivi ishte i qartë që të përsëritej edhe një herë suksesi i vitit të kaluar. Për arsye të mosmarrjes së vizave nga ana e Anglisë në ditët e Festivalit shkoi vetëm një delegacion prej 6 anëtarësh i drejtuar nga zoti Fitim Mimani që me këtë rast në mungesë të shfaqjes së grupit do të bënte ceremonin zyrtare të dorëzimit të ullinjve në prani të vetë Presidentit të Uellsit, zotit Teri. Ishte muaji korrik i vitit 2017. Njëri prej ullinjve u vendos në hyrje të ndërtesës ku u organizua Festivali Ndërkombëtar Folklorik dhe dy prej tyre u vendosën në bashkinë e qytetit.

Në mbishkrimin e dhuratës ishte vënë ky shënim "Dhuratë nga Ambasadori i Paqes nga Shqipëria në Shqipëri Zoti Fitim Mimani" Në takim Zoti Fitim kërkoi që të jepej dhe një shfaqje bamirësie në kohën e vendin e duhur dhe të ardhurat e tyre të përdorreshin nga njerëzit në nevojë, gjë që u mirëprit na të gjithë njëzëri. Gjithashtu ai i kërkoi zotit Teri që të ndërmjetësonte edhe në Oborrin e Mbretërisë së Anglisë që të dërgonte në këtë rezidencë dy ullinj Berati, ullinj Shqipërie që besoj se janë të parët që i jepen kësaj mbretërie. Ai i tregoi dhe një arsye të fortë personale dhe kombëtare se pse donte ta bënte këtë gjest krejtësisht vullnetar dhe bamirës. Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare sipas rrëfimeve të babait të tij vërtetohet se një kohë prej 6 muajsh në atë shtëpi karakteristike të Roshnikut të kthehej në vendqëndrim për Misionin anglez. Duket se ullinjët shqiptarë qofshin ata të Beratit, të Vlorës, të Himarës, të Elbasanit, po dërgonin në Uells në Londër e në Evropë një copë të shpirtit paqësor të këtyre njerëzve dhe të këtij kombi.



# I pelasgi e la loro lingua Pellazgët dhe gjuha e tyre

Di LEONIDA NDRENIKA

## FILOLOGIA

She la lingua albanese o shqype è quella dei Pelasgi l'attestano von Hahn, A. Schleicher, Otto Blau, Thomopulo( fjal greke) ed altri. Pott ha mantenuto la sua opinione che la lingua albanese è rimasta dall'illiro – pelasgico. Bopp nella sua pregevole opera mette in luce la individualità propria della lingua albanese e la sua indipendenza senza annetterla a nessuna lingua indoeuropea. Il saggio Schleicher però ha definito come gruppo di lingue indo - europee che si rappresentano dall'albanese, italico e greco.

Hahn connette i costumi degli Albanesi con gli Etruschi e opina che la lingua albanese e illiro - pelasgica. Meyer nell'albanese ha visto l'illirico moderno.

Le iscrizioni messapiche spiegate per mezzo dell'albanese, hanno fatto sì che molti hanno studiato la nostra lingua; però la connettono all'illirico invece di pelasgo - illirico (S. Bugge, Bezenberger's Beitraege, XVIII, p. 193; Kretschmer, Einl. in d. Gesch. d. griech. Sprache, 1895, p.262; Ribezzo, la lingua degli antichi Messapi, Napoli 1907).

Hirt connette l'albanese alla lingua dei Traci; Pauli parimenti. Pederson, il grande glottologo di Copenhagen annette l'albanese alla lingua dei Traci (Zeitschrift f. verl. Sprachforschung, XXXIX, p. 334; Bariç in albanorumaenische Studien, 1919, p. 19; Sbornik Belic, 1921, N. 3; Archiv za arbanasku starinn, jeziki i etnologijn, II, 1925, p. 153...; Weigand in Sind die Albaner die Nachkommen der illyrer oder der Thraker? nel Balkan – archiv, III (1927) p. 227...; Bariç opina che l'albanese è un dialetto traco illirizzato; Joki di Vienna nell'articolo riassunto suo Albaner, pubblicato in Reallexicon der Vorgeschichte di Eberth (1924), desume che l'albanese ha parantela sia con la lingua traca sia con la lingua ilirica. Schuchardt mette in relazione il basco con l'albanese.

Le iscrizioni carie decifrate pel tramite dell'albanese da Otto Blau, vengono coronate dal successo attuale da Axel Persson il quale nell'antico idioma cretese, mercè le spiegazioni sue relentiissime, trova parecchie voci che passarono nel greco, sono rimaste nell'albanese di oggi ed in queste lingue i relitti dell'idioma parlato in lontanissimi tempi dai dominatori cretesi si ritraciano, si identificano dimostrando la loro tenace forza conservatrice attraverso i millenni.

Noi riconosciamo basandoci sulle asserzioni di molti scrittori antichi e moderni che i Pelasgi hanno abitato in Europa meridionale e Asia Minore. Ma soprattutto insistiamo nel riconoscere che i divini Pelasgi hanno avuto sede in Epiro; sono gli stessi in Illiria, Macedonia, Tessaglia, in tutta l'Ellade e Peloponneso in creta e nell'Ageo, in Asia Minore ed in Tracia, in Sicilia ed in Italia tutta. Sono gli stessi Pelasgi che si combattono una tribù contro l'altra in Troia; sono i Pelasgi che hanno introdotto i riti in (Etruria) Italia e in Ellade. La loro lingua non è altro che la lingua shqype, un poco solamente alterata, rimane sempre vergine: il latino e il greco sono sue diramazioni che alla loro volta sono sviluppate, e per spiegare direttamente ciò veniamo ad osservazioni nostre filologiche incominciando dalla stessa parola Pelasgi.

PELASGE, viene dal nome albanese plak e gjin



Il potere di Alessandro era l'esercito dei pelasgi, odierni albanesi

che significa vecchio e uomo: essendo i Pelasgi autoctoni di Epiro ed in Europa, questo nome è dato a loro come uomini vecchi, cioè i primi abitanti del luogo. Strabone dice che in Epiro sempre le tribù si governano democraticamente da un senato detto placonia; anche oggi in Epiro, tanto ellenico quanto albanese, le placonie esistono moralmente ed i giovani rispettano il plak primo, come pure gli abitanti di ogni comune e cercano a lui di occuparsi alle loro contese. Esiste pure in Atene da tempo immemorabile la tribù Plaka che parlava fino a 20 anni fa la lingua albanese anche ufficialmente, ma ultimamente va ellenizzandosi e poche famiglie ancora parlano l' albanese, resistendo alla penetrazione dell'esca ellenica. Molte famiglie delle colonie albanesi in Italia hanno il cognome Plako Plaku (Napoli, Venezia, Cosenza) e conservano non solo il nome dignitario ed etnico ma anche il carattere e l'individualità con tutte le miracolose virtù della superba stirpe (1).

SHQYPERIA, viene da Shqype (aquila) e ri (rimango), cioè luogo dove rimane l'aquila, abitatori di montagne dove rimangono l'aquile; l'aquila d' altro canto e il simbolo di Giove, e gli Albanesi o Pelasgi stando con le aquile alle montagne presero il nome del simbolo divino. Pirro, dalle sue vittorie in Italia, fu acclamato dai suoi militi aquila; Il loro simbolo divino, come tra i cristiani la croce, e Seleuco stratego di Alessandro Magno fece edificare (costruire) la nuova capitale della Assiria nella forma di aquila, come fin'oggi resta Janina capoluogo dell'Epiro ellenico, edificata dai Comneni.

Accenna Omero che i Feaci, abitanti di Sceria (oggi Corfu) erano di origine dall'Hyperia vicina.

Secondo la mia modesta opinione, l'Hyperia di Omero non è altro che la Shqyperia di rimpetto o Epiro; quest'ultimo nome è pure pelasgico e significa sopra (epèer, yper siper in alb.), la sopra del mare costa, forse distinguersi dalle isole di fronte. Esiste il verbo shqypëronj (comprendere, antilambanein che si usa molto in Albania nel senso di spiegare, cioè di parlare nell'idioma comune, di parlare chiaro.

## FILOLOGIA

Se gjuha shqipe është ajo e Pellazgëve e dëshmojnë edhe von Hahn, A. Schleicher, Otto Blau, Thomopulo dhe të tjerë. Pott ka mbajtur mendimin se gjuha shqipe ka mbetur nga Ilirishtja pellazgjike. Bopp në veprën e tij të çmuar thekson individualitetin e gjuhës shqipe dhe pavarësinë e saj, pa e aneksuar atë në asnjë gjuhë indo-evropiane. Megjithatë i urti Schleicher ka përkufizuar si një grup gjuhësh indo – evropiane, që pëfaqësohen nga shqipja, italishten dhe greqishten.

Hahn lidh gjuhën shqipe me gjuhën etruskë dhe mendon se shqipja është ilirishtja Pellazgjike. Meyer në gjuhën shqip shite ilirishten moderne.

Shenimet messapiche të shpjeguar me gjuhën shqipe, kanë bërë që shumë të studionin gjuhën tonë. Por ata e lidhin atë me shumë me ilirishten se me gjuhën pellazge(S. Bugge, Bezenberger's Beitraege, XVIII, p. 193; Kretschmer, Einl. in d. Gesch. d. griech. Sprache, 1895, p.262; Ribezzo, la lingua degli antichi Messapi, Napoli 1907).

Hirt e lidh gjuhën shqipe me gjuhën etruskë. Pauli gjithashtu. Pederson, gjuhëtar i madh nga Kopenhageni e lidh gjuhën shqipe me atë të trakëve (Zeitschrift f. verl. Sprachforschung, XXXIX, p. 334; Bariç in albanorumaenische Studien, 1919, p. 19; Sbornik Belic, 1921, N. 3; Archiv za arbanasku starinn, jeziki i etnologijn, II, 1925, p. 153...; Weigand in Sind die Albaner die Nachkommen der illyrer oder der Thraker? nel Balkan – archiv, III (1927) p. 227.

Bariç mendon se shqipja është një dialekt trak i ilirizuar. Joki nga Vjena, në artikullin e përmbledhur mbi shqiptarët, të botuar në Reallexicon der Vorgeschichte di Eberth (1924), tregon se shqipja ka prejardhje si nga gjuha e trakëve po ashtu dhe nga ilirishtja.

Resgjistrimet carie të deshshifruara nëpërmjet shqipes nga Otto Blau, kurorëzohen me suksesin

aktual nga Axel Persson i cili në dialektin lashtë Kretës, gjen shpjegimet e tij të vryera me zbulimin e shumë fjalëve që kaluan në greqisht, por që kanë dhe në shqipen e sotshme. Këto gjuhë, të cilat janë folur dhe në kohët e largëta nga sundimtarët e Kretës, identifikojnë këta të fundit me një forcë konservative përmes mijëvjeçarëve.

Ne pranojmë duke u mbështetur në pohimet e shumë shkruarëve të lashtë dhe modernë që pellazgët banuan në Evropën Jugore dhe në Azinë e Vogël. Por mbi të gjitha ne insistojmë që të njihet fakti se pellazgët hyjnorë kanë qenë të vendosur dhe në në Epir. Bëhet fjalë për të njëjtët pellazgë që kanë jetuar në Iliri, në Maqedoni, në Tessaglia, në Greqi, në Peloponez, në Kretë, në Egje, në Azinë e Vogël, në Traki, në Sicili dhe në të gjithë Italinë. Ata janë të njëjtët Pellazgë që luftuan njëri fis kundër tjetrit ne Trojë. Ata janë pellazgët që prezantuan ritet në (Etruria) Itali dhe Greqi. Gjuha e tyre nuk është asgjë më shumë se shqipja, ndryshohon vetëm pak por përsëri mbetet e virgjër. Latinishtja dhe greqishtja janë degët e saj të cilat janë zhvilluar më pas nga ana e tyre, dhe për të shpjeguar këtë po ju japim vëzhgimet tona filologjike duke filluar me vet fjalën Pellazg .

Fjala PELLAZG, vjen nga emri shqiptarë plak dhe gjin që do të thotë plak dhe njëri, duke qenë pellazgët autoctonë të Epirit dhe të Evropës, ky emër u është dhënë atyre si pleqtë pra banorët e parë të vendit. Straboni thotë se fiset në Epir gjithmonë qeverisen në mënyre demokratike nga një senat i quajtur placonia. Edhe sot në Epir, sa grekë aq dhe shqiptarë, placoniat ekzistojnë moralisht dhe të rinjtë respektojnë plakun e parë, si dhe banorët e çdo komune i kërkojnë atij të merret me problemet tyre. Ekzistojnë edhe në Athinë nga kohra të lashta fisi Plaka i cili fliste shqip deri në 20 vjet më parë, madje edhe zyrtarisht, por në fund të fundit ajo u helenizua. E megjithatë aty ka akoma disa familje që ende flasin shqip duke i rezistuar kështu depërtimit helenik ndërmjet shqiptarëve. Shumë familje të kolonive shqiptare në Itali kanë mbiemrin Plako Plaku (Napoli, Venezia, Cosenza) dhe të mbajë jo vetëm emrin, por edhe karakterin dinjitoz dhe etnik me të gjitha virtytet e mrekullueshme të kesaj race të shkëlqyer (1).

Fjala SHQIPËRIA, vjen nga Shqype (shqiponjë) dhe rri (mbetem), që domethënë, vendi ku rri shqiponja, banorët e maleve ku qëndrojnë shqiponjat. Nga ana tjetër shqiponja është dhe simbol i Jupiterit, dhe shqiptarët ose pellazgët duke ndenjur me shqiponjat nëpër male morrën emrin e simbolit hyjnor. Pirro, nga fitoret e tij në Itali, u vlerësua nga ushtarët e tij si shqiponjë. Simboli i tyre është hyjnor, siç është në mesin e të krishterëve kryqi. Seleuco strateg i Aleksandrit të Madh kishte ndërtuar kryeqytetin e ri të Asirisë në formën e një shqiponje, siç mbetet deri sot Janina si kryeqyteti i Epirit grek i ndërtuar nga Comneni.

Homeri përmend se fenikasit, banorët e Sceria (sot Corfu) ishin me origjinë nga Hyperia aty pranë. Sipas mendimit tim modest, Hyperia i Homerit është asgjë tjetër veçse Shqipëria ose në atë kohë Epiri. Emri Epir po ashtu është pellazg dhe do të thotë sipër, mbi bregun e detit.

(Perktheu Kiara Lalo)

Tek sa qëndronte para klasës së saj në ditën e parë të shkollës, duke vështruar nxënësit, ajo u tha atyre një gënjeshtëri: "Ju dua të gjithëve njëllorj."

Në rrjeshtin e parë, midis nxënësve, që ulur një fëmijë që quhej Tedi Stodard. Zonja Tomson e kishte ndjekur Tedin për vite me radhë dhe kishte vënë re që ai nuk bëhej shumë me të tjerët, që rrobat e tij nuk ishin të pastra dhe gjithnjë dukej sikur kishte nevojë të lahej. Për më tepër që fëmijë i papëlqyeshëm. Erdhi puna që ajo kishte filluar të gjente kënaqësi kur i shënonte gabimet e tij me bojë të kuqe duke vënë kryqë të mëdhenj mbi to, dhe së fundi i bënte vlerësimin me një notë të madhe pakaluese.

Në shkollën ku punonte zonja Tomson kërkohet që mësuesit të shikojnë përparimin e nxënësve në të kaluarën, dhe ajo e kish lënë Tedin për në fund fare. Sidoqoftë, kur filloi të lexonte shënime të kishin lënë kolegët e saj në të shkuarën për këtë nxënësi, ajo u habit.

-Mësuesja e klasës së parë kishte shkruar: "Tedi është një djalë i zgjuar dhe gazmor. Ai i bën detyrat pastër dhe ka sjellje të mira. Është kënaqësi ta kesh nxënësi". -Mësuesja e klasës së dytë kishte shkruar: "Tedi është nxënësi i shkëlqyer. Shokët e klasës e duan shumë, por këto kohë ai është i papërqëndruar sepse nëna e tij është e sëmurë dhe duket se ka një sëmundje të pashërueshme".

-Mësuesja e klasës së tretë kishte shkruar: "Vdekja

## Për mësuesit-mesazh i mrekullushëm

### PERKTHYER NGA ALBANA LIFSCHIN.

e nënës e ka dëshpëruar shumë Tedin. Ai përpjet t'i bëjë detyrat dhe të mësojë, por duket babai tij nuk interesohet për mbarëvajtjen e djalit në mësim. Kjo do të ndikojë tek Tedi nëse nuk merren masa për të përmirësuar gjendjen"

-Mësuesja e klasës së katërt shkruante: "Tedi qëndron i tërhequr dhe nuk tregon shumë interes për shkollën.

Nuk ka shumë shokë dhe shpesh e zë gjumi në klasë". Zonja Tomson e kuptoi se ku qëndronte problemi me Tedin dhe i erdhi turp nga vetja. Ajo u ndje akoma edhe më keq kur nxënësi i sollën asaj dhuratë për Krishtlindje të mbështjella në letra të bukur me shkëlqim e lidhur me fllongo të kuqe, me përjashtim të Tedit. Dhuratat e tij ishte e mbështjellë keq me një letër ngjyrë kafe që e kishte futur në një qese letre të marrë nga një dyqan ushqimesh. Asaj i desh ta haptë atë përpara gjithë klasës. Fëmijët qeshën kur panë që ajo nxorri prej andej një byzlyk të cilit i mungonin disa gurë dhe një shishe parfumi të përgjysmuar. Fëmijët pushuan së qeshuri kur panë që mësuesja e tyre e lëvdoi dhuratën e Tedit, dhe e vuri byzlykun në dorë dhe pastaj hodhi edhe pak parfum mbi kyçin e dorës.

Tedi atë ditë qëndroi në shkollë më gjatë se çdo ditë

tjetër vetëm për t'i thënë mësueses: "Zonja Tomson, ju sot mbani aromën e nënës sime". Kur fëmijët u larguan, ajo uqoi për gat një orë. Që nga ajo ditë Zonja Tomson pushoi së mësuar leximin, gramatikën e matematikën, dhe filloi të mësonte ...nxënësit. Tedit i kushtoi një vëmendje të veçantë. Ndërsa punonte me të, filloi të shikojë shenjat e para të rezultatit të përkushtimit të saj. Sa më shumë e inkurajonte, aq më shumë aktiv bëhej ai. Nga fundi i vitit shkollor Tedi qe bërë një nga nxënësit më të mirë të klasës. Dhe pavarësisht nga gënjeshtria që ajo kishte thënë ditën e parë të shkollës (" Ju dua të gjithëve njëllorj) Tedi u bë një nga nxënësit e saj më të preferuar. -Një vit më vonë ajo gjeti nën derë një shënim nga Tedi ku djalë thoshte se ajo ishte mësuesja më e mirë që kishte pasur në gjithë jetën e tij.

-Gjashtë vite më vonë, asaj i erdhi një tjetër letër nga Tedi. Atë kohë ai i shkruante se kishte mbaruar shkollën e mesme, dalluar si i treti në klasën e tij, dhe ajo ende kishte mbetur mësuesja e tij më e mirë.

-Katër vjet pas asaj letre, ajo mori një tjetër nga Tedi. Ai i tregonte se kishte studiuar me ngulm me lëksionet herë -herë të vështira, dhe së shpejti do ta përfundonte fakultetin më rezultate të larta e certifikatë nderi. Ai e siguronte mësuesen, se përsëri ajo mbetej mësuesja më e mirë për të .

-Kaluan edhe katër vite të tjera dhe sërisht një letër tjetër prej Tedit. Kësaj radhe ai i spjegonte se megjithëse mori diplomën e studimeve të larta katër vjeçare, kishte vendosur të shkoste edhe më tutje. Dhe përsëri ajo mbetej mësuesja më e mirë që kish pasur tërë jetën... Dhe firmoste në fund të letrës emrin e tij, por këtë radhë firma qe disi më e gjatë: Theodore F. Stoddard, MD. Por historia nuk mbaron këtu. Një letër tjetër i erdhi zonjës Tomson atë pranverë. Tedi thosh se kishte takuar një vajzë dhe kishte ndërmend të martohej. Ai spjegonte se babai i tij kishte vdekur disa vite më parë, dhe pyste nëse ajo ditën e martesës së tij do të qëndronte në vendin e rezervuar për nënën e dhëndërit. Sigurisht ajo pranoi. Dhe imagjioni: ajo kishte vënë atë ditë byzlykun e nënës së tij, dhe kishte hedhur parfumin e saj. Ata përfunduan njëri tjetrin dhe Tedi i pëshpëriti: "Faleminderit Zonja Tomson që patët besim tek unë, kur isha fëmijë, që më bëtte të besoj se unë mund të ndryshoja jetën time." Zonja Tomsoni iu përgjigj: "Jo, Tedi e ke gabim. Isha unë që mësova nga Ty. Para se të takoja ty, unë nuk dija të jepja mësim". Më pëlqen shumë kjo histori. Sa herë që e lexoj më rjedhin lotët. I njëri ngrohtësi zemrës së dikujt. Përpiguri të sillni një ndryshim të bukur në jetën e dikujt... Sot? Nesër? Vetëm bëjeni...

Kujtime nga AGIM BULGARECI

Er dhi data 31 dhjetor në mëngjes. Na thanë se, "Le të shkojë në shtëpi kush të dëshirojë për shtatë ditë." Mendova ta festoja Vitin e Ri në shtëpinë time në Arbër prandaj ju thashë eprorëve se do të shkoja në Korçë. Ata më këshilluan të mos shkoja sepse me Korçën, nga Prrenjësia, rrugët janë tërësisht të bllokuara nga bora. Nuk i dëgjova pasi s' më mbante vendi. Nuk isha mësuar të largohesha aq gjatë nga shtëpia. I thashë shokut tim më të ngushtë, Astrit Jaupit, që të shkonim bashkë por ai jo vetëm që më kundërshtoi por edhe më këshilloi që të mos shkoja.

U nisa. Prita nja një orë në dëborë e të ftohtë në dalje të lagjes, afër Pusit të Mezinit, rrugë e vetme nga kalohej për në Rrogzhinë ku do të merrja trenin deri në Prrenjës dhe prej Prrenjës, nëse do mundesha, do shkoja, po me makinë të rastit, për në Korçë. Hipa prapa në një makinë me karroceri të zbuluar dhe u mbështolla mirë me kapotën ushtarake. Në Rrogzhinë s' prita shumë dhe mora trenin deri në Përrenjas. Atje mbrita rreth orës 6 të mëngjes. Gjeta me qindra korçarë dhe pogradecarë që prisnin të kalonin Qafën e Thanës por asnjë makinë nuk mund të kalonte në atë suferinë ku dëborë kishte ngrirë dhe makina mund të binte në humerë. U mblodhëm më të guximshmit dhe i

thamë shoferit se do ta paguanim mirë nëse na shpinte në Korçë. Ai, një i marrë si ne, na kërkoi nga një qind lekë për njeri, kjo e barabartë në atë kohë me rrogën e një dite pune punëtori. Ishim dakord nja dhjetë vetë. Ai e bisedoi me shoferin që hapte rrugët nga dëborë duke i dhënë ca para dhe e vuri të shkonte para tij. U nisëm. Makina ecte në ngjitje të Qafës së Thanës me pesë km në orë dhe në zbritje me dy km në orë!

Rrugës, herë pas here vinin duna me borë nga shpati e malit dhe binin në rrugë e mbi makinën tonë. Na u desh që me lopata të hapnim herë pas here rrugën që nuk merrej vesh se ku ishte! Dësh Zoti dhe mbritëm në Pogradec në orën nëntë të natës. Kishim ngrirë shumë dhe shoferi na propozoi të qëndronim atë natë në Pogradec. Na thanë se "Plloça" ishte krejtësisht e pakalueshme. As edhe një makinë prej dy ditësh nuk kishte kaluar asaj rruge për në Korçë. "Më falni por s' mundem ta kaloj dot 'Plloçën'. Merrini një pjesë të lekëve mbrapsht. Unë do fle këtu sonte. S' dua të vras veten dhe juve." Na tha shoferi. S'kishim se ç' far të bënim. Rruga nuk merrej vesh se ku ishte nga trashësia e borës që vende vende i kalonte edhe dy metrat. Vetëm atje ku kishte plepa mund ta merrje me mënd se rruga do ishte në mes tyre. Nja shtatë vetë shkuan në hotel. Dy të tjerë dhe unë vendosëm që Vitin e Ri ta bënim në "terrorin tonë" të Korçës! Një burrë i vjetër, i sapo njohur mu lut, gati me lot në sy që të mos nisesha se ishte me rrezik të madh. "Të lutem mos shko. Është ç' menduri të kalosh Plloçën kur dëborë ka ngrirë dhe fryn suferinë!" Unë qesha. Mu duk vetja supermënd dhe u nisa bashkë me dy "trimat" e mi. Të tre ishim djem të rinj dhe të fuqishëm. Njeri na tha se ishte nga Petrusha, një fshat sapo kalon "Plloçën" dhe Çerravën dhe se deri atje na garantonte se do shkonim shëndoshë e mirë. U nisëm. Në atë rrugë mu mbush mendja se njeriu paska fuqi çudibërse. Makinat s' mund ta çanin dot rrugën por ne e çamë. Ecëm, sigurisht mes plepave që ishin anës rrugës, mbi dëborën e ngrirë. Kishte hënë por shukullima e dëborës e pengonte të na ndriçonte si duhet. Era e marrë na tha fytyrën megjithëse vetëm sytë na dukeshin nga që ne mbështollëm nga një shall rreth kokës. Deri në majë të Plloçës nuk hoqëm shumë por kur mbritëm atje, afër mesnate, era ishte gati të na flakte si lecka! dhe do na kishte flakur nëse nuk do ecnim me duar e këmbë në mënyrë që trupi të kishte sa më pak kontakt me erën. Kot nuk isha duke u bërë pilot dhe se, kot s'kisha mësuar teorinë e fluturimit dhe atë të aerodinamikës! Fluturim në tokën me borë! Hahahaaaa... Në faktë, ajo që po bënim ishte thjeshtë një Marrëzi me "M" të madhe. Po mendoja je, heronjtë u bëkan nga gabimet dhe budallallëku! Deri atje akoma nuk po ndjeja frikë. Çudi sesi është moshë dhe guxim?! Sot më duket marrëzia më e madhe që kam bërë në jetë por le të vazhdoj ta tregoj deri në fund marrëzinë...

Ai djali nga Petrusha, sapo mbritëm atje, na u lut të shko-

nim në shtëpinë e tij por ne të dy të tjerët s'pranuam dhe vazhduam rrugën për në Korçë. Sapo kishim kaluar Minierën e Petrushës, rruga u bë dyst, s'dalloheshin fare më se ku ishin plepat, rruga, kanali apo fusha pasi rruga më duket se s'kishte plepa anash! Asnjë gjurmë. Asnjë shenjë jete. Ecëm kuturu. Nganjëherë grindeshim pasi kishim mendime të kundërta se ku do ishte rruga. I thashë të më ndiqte pas por ai më tha, "Jo! Nuk është ajo rruga. Të lutem më ndiq mua." S'kishim as ndonjë shkop dhe as ndonjë mjet tjetër që të shponim dëborën, nëse do shpohej, për të parë se poshtë saj ishte tokë e jo gropë. S'bëra më shumë se njëzet metra dhe rashë në gropën që i ruhesha aq shumë! Gropa ishte aq e thellë sa nuk kishte asnjë mundësi ngjitje. Provoja me tërë tërbimin dhe forcën time të ngjitem por ishte krejt e pamundur pasi filloi të më mbulonte bora e cila më godiste me copat e saj të ngrira. Ajo vazhdonte të më mbulonte edhe nga copat e borës që binin gjatë përpjekjeve e mija energjike për të dalë jashtë. Bora më kishte kapur në çarkun e saj të vdekjes. Hyra në një terr dhe pas gjysmë ore përpjekje të kota dhe kur po lodhesha, për herë të parë më hyri frika. Thonë se, njeriu më shumë se nga e papritura kur ndodhet pranë vdekjes, vdes nga frika. Thërrita por s'mora asnjë përgjigje. Shpresa që më mbajti gjallë, ishte vetëm shoku im sipër meje nëse edhe ai s'kishte rënë në ndonjë gropë! Mu kujtuan fjalët e djalit që ngeli në Pogradec i cili mu lut shumë të mos e bëja atë rrugë. Mu kujtua dhe porosia e babait i cili gjithmonë më kujtonte se, "Kur gabon njeriu, Perëndia s'vjen vetë ta ndalojë e shpëtojë nga gabimi por mëson dikë t'i thotë, mos! Prandaj, është shumë e domosdoshme të dëgjosh dikë kur të thotë, MOS apo edhe çdo këshillë tjetër."

Filloi frika të më gërryente. E vetmja shpresë, përveç shpresës së ndihmës së djalit shoqërues, ishte "Topi i Dritës" që lëvizti nga e majta në të djathtën time për dy sekonda dhe u zhduk!

Vitin e Ri e prita në gropën e borës dhe në Petrushë.

Nuk e di sesa ndënja atje në gropë dhe as e mora vesh ndonjëherë se në ç'farë gropë kisha rënë. Do të kisha vdekur nëse "topi i dritës" do ma hiqte frikën dhe nëse ai djali që ishte me mua mos kishte parë minatorët me drita dore që dilnin apo hynin në minierë të cilëve ju kishte thënë se, një njeri është zhdukur brenda dëborës dhe ata me lopata dhe kazma filluan kërkimin tim. Kur po i humbisja edhe shpresat e fundit se do më gjenin, dëgjova zëra. Ju bërtita sa kisha në kokë, "Jam gjallë!"

Pashë se u hap bora sipër meje dhe u dukën dritat me petromaks që mu drejtuan mua, pastaj një litër u var poshtë dhe më minatorët pyetën nëse kisha mundësi të lidhesha. Mund të kisha vdekur edhe nga gëzimi shumë i madh! E lidha litarin rreth belit me sa më shumë nje nga frika se mos zgjidhej. Filloi tërheqja dhe shpëtimi im. Atë natë fjeta në Minierën e Petrushës.

Falenderova Zotin dhe Minatorët.



## Fjala e Lamtumirës për Aleksandër Laloni

Nga PETRIT RUKA

Miq, shokë, të afërm,

Jemi sot këtu për t'u ndarë me një nga shpirtat më të dashur të muzikës shqiptare, me Aleksandër Laloni. Jemi mbledhur t'i japim lamtumirën një njeriu që ishte dhe është një vlerë e madhe dhe e pazëvendësueshme kombëtare. Jemi ende të pandërgjegjshëm aq sa duhet se çfarë pasurie kolosale po humbasim sot teksa po përcjellim njerin prej kompozitorëve më të shquar e më të dashur për miliona shqiptarë që kanë në veshet e tyre sot meloditë e tua të pavdekshme.

I dashur Sandër, vëllai dhe miku ynë i shtrenjtë,

Unë e di mirë më mirë se kushdo, që ti njeriu më rebel dhe antikonformist, që kam njohur në këtë jetë, do të doje sot, që ne t'i shmangnin fjalët e mëdha. Por kjo është tej fuqive tona, të paktën sot. Na lerë të të themi se ne të gjithë e besojmë me gjithë shpirt se ti ishe dhe je një artist i madh, i jashtëzakonshëm në gjithçka që bëre dhe le pas në jetën tënde. Na lerë të paktën vetëm sot të ta themi, se sapo kemi humbur një nga shpirtat më të trazuar dhe më femitorë që mund t'i vijnë botës tonë artistike, një nga melodistët më të famshëm e më të papërsëritshëm të muzikës shqiptare. Na lerë të të themi se me muzikën tënde ti i ke dhenë jetës sonë një dritë që nuk do të vdes kurrë dhe se me të e ke zbuluar jetën tonë.

Na lerë të të themi se ishe një njeri i jashtëzakonshëm me dashurinë tënde të pakufi për shokët e tu dhe miqtë e tu. Të të themi se ishe një lajm i gëzuar me çdo këngë tënden, me çdo intervistë tënden, me çdo grindje tënden të bekuar me të gjitha pushtetet, me çdo kafe tënden ku çdo bisedë e ktheje në një festë dhe ngjarje që tregohet si një lajm i ri, me dashurinë tënde të papërsëritshme për Margën, për Endrin dhe Marinin, fëmijët e tu, me trishtimet, gëzimet dhe zhgënjimet e tua që ishin edhe ato një muzikë tjetër që nuk u shkrua dot në pentagram, po që është inçizuar ne veshët dhe shpirtat tanë.

Sandër i dashur, që nga sot, pianoja jote e stërdjegur nga mijëra cigare gjysmë të fikura mbi tastat e bardha nuk do të kumbojë më për të nxjerrë mrekulli si muzika jote. Ky do të jetë "Dimri i fundit" që do të pllakos mbi të. Por njëkohësisht sapo kanë filluar të bëhen më të shtrenjta e më të pavdekshme ato miliona nota që enden nëpër qiejt e Shqipërisë, që ti e deshe aq shumë dhe që tërë jetën i dhe më të bukurën që dite të nxjerrësh prej asaj zemrës tënde të artë.

Lalo i dashur, e di që si kishe qejf fjalimet e gjata dhe unë do ta mbyll këtu. Por më lerë të të them për të fundit herë se sa shumë të kemi dashur e mbase bëmë gabim që nuk ta thamë aq herë sa duhet deri dje.

Të kemi dashur shumë shoku ynë, vëllai ynë, maestroja ynë i papërsëritshëm! Shumë!

Akoma më shumë do të të duam nga sot e tutje me mungesën tënde që do të shkëlqejë përmes mallit tonë të pafund.

Shko dhe çlodhu tani! Bëj atje lart muzikën tënde të madhe e të rrallë bashkë me engjëjt që po presin një engjëll tingujsh!

Jemi krenar që bëmë bashkë me ty një copë rruge në këtë jetë! Faleminderit Sandër i dashur që ishe në jetën tonë. Nuk po të themi lamtumirë, sepse për njerëz të tillë si ty, nuk ka kurrë lamtumirë.

Tani shko dhe çlodhu vëllai ynë!

## Dështim & Gëzim

Nga SKËNDER KAMBERI

Ditët e numëruara të lehtë shkuan shumë shpejt. Kthimi në Vlorë ishte pa ndonjë gjë të veçantë. Rutina e shkollës filloi përsëri. Kujtimi i datës tridhjetë e një dhjetorit s' më linte të qetë. Desha t'ju tregoja shokëve por pasi u mendova gjatë, mu dukur një budallallëk dhe nuk i thashë askujt. Vendosa ta shkruaja ngjarjen si tregim. E tejzgjata historinë, e zbulurova duke e lënë fantazinë krejt të lirë dhe i vura një emër tjetër personazhit kryesor, sikur s' më kishte ndodhur mua. Tregimi mu duk interesant dhe mendova ta botoj. Në atë kohë kam qënë korrespondent i revistës "10 Korriku" dhe gazetës "Luftëtari", organe të shtypit ushtarak që vareshin nga Drejtoria Politike e Ushtrisë. Ja nisa revistës "10 Korriku" dhe prita të ma botonin. Përgjigja nuk vonoi ku më shkruanin, "I dashur Agron, tregimi juaj s'ka asgjë interesante për t'i thënë ushtrisë popullore. Thjesht tregimi juaj është një marrëzi..." ! E grisja tregimin dhe fillova të përgatitem politikisht në letërsi. Për këtë, një ditë i tregova shefit të shtëpisë së oficerave në Vlorë, Ibro Jonuzit se, çfarë më kishte ndodhur pasi të ai ne mblidheshim një herë në muaj për aktivitete letrare në rang ushtrie në Vlorë. Aty vijnin letrarë edhe nga Akademia e Marinës etj. Ç'është e vërteta, regjimi komunist na shtynte të shkruanim por nën kontroll të rreptë. Temat ishin të kontrolluara dhe të politizuara. Parapëlqeshin reportazhet dhe tregimet nga jeta me motiv heroizmin e Njeriut të Ri Socialist. Gjë që mua s' më tërhiqte fare. Desha që fantazinë time ta lija të lirë, ashtu siç bëra me tregimin që ma quajtën një marrëzi dhe mua një të marrë! Atë ditë, atje tek Ibro, ndërsa unë isha gamet i mërziut, na vjen një piktor i Vlorës, Skënder Kamberi, dhe na foli për artin e pikturës. Më pyeti mua pse dukesha shumë i mërziut, ndërsa unë i thashë se nuk isha i mërziut por ashtu e kisha pamjen...

Ai qeshi dhe më ftoi të më vizatonte portretin. Pranova. Për pak minuta më vizatoi dhe ma dha pikturën. Atje pashë veten me "buzët një pëllëmbë" dhe me "hundën për tokë"! I them Skënderit, "Çfarë ke bërë kështu?! Unë s'jam lopë!" Të gjithë sa ishim atje qeshëm. Qesha dhe unë. Ç'farë mund të bëja tjetër! Ibroja i shpejtoi se më kishin "kritikuar" për tregimin. "Dëgjo ti djalosh! - filloi piktori të më flasë. - S'bëhesh dot kurrë artist apo letrar por nuk pranove kritika dhe madje edhe sharje. A e di ti se ç'farë më ka ndodhur mua njëherë? Kisha pikturuar një vajzë nga ky qytet. Piktura ishte origjinale. Vajza më tërhoqi shumë pasi ishte e bukur dhe kishte një veçori që e bënte të veçantë, ajo e kishte qafën shumë të gjatë dhe unë, sigurisht, ja pasqyrova po ashtu, siç e kishte. E vura në ekspozitën time që hapa para disa vitesh. Në atë ekspozitë vjen Sekretari i Parë i Partisë. Ai sapo e pa pikturën time të vajzës me qafë të gjatë, tha "Ç'janë këta piktorë dekadentë që bëjnë piktura moderniste?!" Mua më erdhur për të qeshur e për të qarë. Një herë, në radhë të parë, një vepër arti s'mund të jetë edhe dekadente edhe moderniste. Që këtu duket se ai ja fuste kotë..."

Mua mu drodh trupi. Po ky qënka i çmendur! Mendova. Si mund të flitej ashtu për figurën kryesore të Partisë në Vlorë?! Por piktori s' më la të mendoja gjatë pasi e vazhdoi historinë deri në fund.

"I thashë, Shoku Sekretar! Vajza është origjinale aty. Ajo ka po atë qafë aq të gjatë sa edhe në pikturë edhe nëse doni ta vërtetoni ju siguroj që qafa s' do t'i shkurtohet derisa ta shikoni ju. Nëse dëshironi unë ju jap emrin dhe adresën e saj? Por ai u tërbua dhe më tha se unë ja fusja kotë dhe se nuk ka njeri me qafë aq të gjatë si të sorkadhes! Unë qesha dhe e ktheva në shaka duke i thënë se mbase ajo mund të ishte bijë sorkadheje. Qeshi edhe ai dhe me kaq u mbyll ajo histori e cila edhe mund të merrte një kthesë të treqikshme jo vetëm për artin tim të pikturës por edhe për jetën time. Ta tregova këtë tu aviator i dashur pasi ti je i ri dhe sapo ke filluar t'i biesh murit me kokë. Bëj kujdes se muri s'ka për të lëvizur. Do jetë vetëm koka jote ajo që mund të lëvizë e ndoshta mund të çahet."

Kur iku Skënder Kamberi i thashë Ibro se ky piktor qënka i çmendur. Si mund t'i flitej ashtu Sekretarit të Parë?! Ibroja ma ktheu:

"I ke rënë pikës. Skënderi është piktori më i mirë që ka Vlora por është ca i rrjedhur..."



Nga JAHJA DRACOLLI

Flamuri dhe stema arbërore sipas burimeve historike të shek. XIII konsiderohen për më të moçmet në Ballkan!

Pas themelimit të Perandorisë Latine në vitin 1204 nga Republika e Venedikut, mbretëria e Francës, e ndonjë vendi tjetër europian, shteti i Arbërit, Epirit dhe Moresë (sikurse që kishte vepruar më parë mbretëria e Kroacisë në vitin 1102 me mbretërinë e Hungarisë), do të kërkojnë mbrojtje nga bujaria e shteteve në fjalë, të cilat kishin sjellur në Arbëri edhe traditën europiane të heraldikës.

Derisa, sipas traktatit në Viterbo të Italisë (1267), Epiri dhe Morea do të inkuadrohen nën mbrojtjen e Karlit I Anzhuin, këtë veprim do ta parapëlqejnë

edhe kryezotërinjtë arbë në vitin 1272, vit ky që përkon edhe me themelimin e Mbretërisë së Arbërit (De Regnum Albania) në krye me Karlun I (Rex Albania), me seli në Durrës. Në këtë kontekst, heraldika arbërore, e cila ruante simbolikën, që nga kohët më të hershme të qytetërimeve të Mediteranit, fuqishëm do inkuadrohet në rrjedhat e mëtejshme të Europës Perëndimore, në veçanti të shteteve italiane të kohës. Kjo traditë e pasur europiane do të manifestohet sidomos te heraldika e familjeve të njohura arbërore, si, bie, fjala te kastriotët, dukagjinët, të cilët zotëronin edhe me Rrafshin e Dukagjinit dhe trevën e Prizrenit së bashku me qytetin.

Vendosja e pushtetit osman do ta ndalojë këtë proces të trashëgimisë tonë të pasur, e cila do të vazhdojë sërish vetëm nga 28 Nënori i vitit 1912!

# Krijimtaria e shkrimtarit Ramazan Hushi dhe qyteti i Kavajës

Nga FATMIR MINGULI

*Krijimtaria e shkrimtarit Ramazan Hushi dhe qyteti i tij. Unë të them: në se në venat e tua nuk qarkullon trashëgimi i mijra vjeçarëve dhe se në zemrën tënde nuk këndon poema e kujtimeve të largëta, ti nuk je më një njeri dhe nuk përfaqëson një popull dhe nuk mund të mburesh se je antar i një qyteti fisnik.*

Çesare Teofilato

**R**amazan Hushi duke botuar librin me tregime humoristike “Zyra e gënjeshtrove” ka treguar se është i vendosur për të vazhduar punën e tij krijuese, të filluar në vitin tashmë të largët, 1981, kur botoi librin me tregime për fëmijë “E shtuna e bukur”. Mbas këtij libri të parë ai ka botuar dhe 11 libra për fëmijë, 5 libra me letërsi humoristike, 2 libra me letërsi erotike, 3 më prozë për të rritur, (tregime dhe romane), 5 libra me studime që lidhen me qytetin e Kavajës dhe për njerëz të shquar të saj. Duke lexuar librin “Zyra e gënjeshtrove” shpreh mendimin se tregimet e reja të Ramazanit, janë në nivel më të lartë artistik dhe japin vetë profilin krijues të këtij shkrimtari të prozës. Nuk është fjala se katër tregime si ai me titull “Si ma botuan tregimin” të këtij vëllimi, kanë subjekte nga puna e shkrimtarit dhe peripecive që vuajnë sot shkrimtarët në vendin tonë, por për të gjithë tregimet që përfshihen në këtë libër të ri.

Jo vetëm këto tregime por dhe të tjerët që ndahen në pjesën e parë të librit ndjehet qytetari i ndjeshëm për gjithë sa ndodhin në kalvarin e viteve të tranzicionit, ku si prototop është tregimi “Kush jam unë” dhe autori troket në dyert e njerëzve të thjeshtë dhe i rikujton fisnikërinë njerëzore, të kaluarën të konvertuar në të tashmen. Humori, kjo armë e fortë e shkrimtarit Ramazan Hushi, ushqen tregimet e tij, njerëzit e thjeshtë dhe artistët e humorit bashkë me ta janë lënda e parë, ngjarjet janë lidhësi i narracionit për prozën e begatë të Ramazan Hushit. Por të tre këta komponentë nuk do bënin krye pa fantazinë dhe përkujdesin e autorit i cili di të ekuilibrojë në mënyrë perfekte, duke i dhënë dritë këtij triniteti i cili është i pranishëm pothuaj në shumë libra të tij.

Në pjesën e dytë të librit “Zyra e gënjeshtrove” janë thurur tregime të bukura, shumë tërheqëse, të vetme në lloin e vet, ku Nikolin Xhoja, Fadil Hasa, Mit Marku, Rrem Hoxha, artistë të zonës sonë, janë “implicuar” në ngjarje të çuditshme sa të tipit aventurë aq dhe brenda

konceptimit shqiptar. Si këta artistë janë dhe shumë të tjerë në këtë libër e që përfaqësojnë qytete të tjera të Shqipërisë. Libri “Zyra e gënjeshtrove” ka ndriçuar më tej portretin narrativ të Ramazan Hushit në gjininë e prozës në përgjithësi dhe në atë të tregimit në veçanti. Duke qenë një shkrimtar që e do qytetin e tij, njerëzit e Kavajës, ai dhuron ngrohtësi të lexuesi. Jeta e tregimeve të Ramazanit e ka zanafillën të rrugica e Caruqve në lagjen Zguraj me kafenenë e çuditshme të xha Hamitit dhe më tej hapet në gjithë Kavajën dhe Shqipërinë e shkon drejt në Itali ku djemtë dhe vajzat kavajase kanë ndërtuar jetët e tyre. Fakti që Ramazan Hushi është një shkrimtar i fortë i prozës e vërtetojnë tre librat e tij “Lotët e kuq”, “Në orën e hartimit” dhe “Trekëndëshi i Bermudes”, libra që kanë shënuar një stad të lartë në krijimtarinë e tij. Tek këta libra proza merr formë të reja dhe njëkohësisht dhe një narracion ndryshe, ku qetësia personale e autorit i hap rrugë shpërthimeve të ndjenjave, shpërthime plot me figura artistike, ku alegoria dhe metaforat janë mbizotëruese. Ndërsa nga pikëpamja e ndërtimit të subjektit Ramazan Hushi përdor artificën e të “papriturës” çka e bën lexuesin të ndjekë leximin me interes. Janë pikërisht këta faktorë në krijimtarinë e Ramazan Hushit që e bëjnë stilin e tij të personalizuar nga një libër të tjetri.

Puna e palodhëshme e çon Ramazan Hushin të kontribuojë edhe ndryshe për qytetin e tij. Janë librat studimorë tashmë të njohur mirë në publik si Antologjia “Zërat e qytetit tim”, “Lëvizja kulturore-artistike në Kavajë”, “Fahri Berberi”, “Apologji për qytetin tim” dhe libri Usta Muratit. Me këto botime studimore Ramazan Hushi e bën veten e tij një nga përfaqësuesit e qytetit të Kavajës, para në aspektin e krijimtarisë letrare. Është me vend të përmend se edhe në këta libra studimorë vërehet po ai kujdes në ndërtimin struktural, njëlloj si në librat letrarë të tij si dhe nuk shfaqen kurrsesi shenja të euforisë e të shtesave të paqena. Ka një intersektim midis këtyre librave ku shfaqet po ai përkushtim i Ramazan Hushit edhe si mësues, edhe si shkrimtar, edhe si prind edhe si antar i qytetit fisnik të Kavajës.

Në këtë vëzhgim mbi krijimtarinë e Ramazanit, do të doja të theksoj se libri “Zyra e gënjeshtrove”, ndonëse është nën okielon e humoristikës, paraqet probleme të fuqishme që deshin njerëzit tanë në kohët e trazuar, por që Ramazan Hushi ka ditur ti qëmtojë e ti paraqesë me elegancë dhe me vërtetësi ato të meta qoftë të njerëzve të veçantë, qoftë dhe të njerëzve të politikës shqiptare. Ky libër është edhe si një dëshmi, si një rrjedhojë e 27 librave të shkruara nga ky autor në 36 vite radhazi.

## KONGRESI 3<sup>o</sup> NDËRKOMBËTAR I MJEKËSISË, AKTIVITET SHKENCOR MULTIDISIPLINOR I SPITALIT AMERIKAN

Nga Prof. LUTFI ALIA

**N**ë këto 25 vite, Shqipëria ka bërë progrese të mëdha. Përveç politikës shqiptare, që grindet me veten, duke ndikuar në ngadalësimin e ritmeve të zhvillimit të vendit, fushat e tjera të jetës vazhdojnë ecurinë në rritje, me synim të arrijnë standartet europiane. Në këto progrese të gjithanëshme shqiptare dhe mjekësia ka pësuar ndryshime. Krahas ndërtimit të shumë institucioneve të reja cilësore, shërbimi shëndetësor gjithnjë e më shumë po intensifikon masat në parandalimin e sëmundjeve, po zbaton teknika diagnostike joinvazive bashkëkohore, kryen ndërhyrje kirurgjikale me pak traumatike dhe shumë rezultative, po shton rastet me transplant të organeve, praktikon protokolle terapeutik me medikamente të reja më të fuqishme dhe më efektive, duke ndikuar në kurimin e sëmundjeve dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës të semurëve. Ndryshime janë bërë në fuqizimin e edukimit shëndetësor, në parandalimin e sëmundjeve dhe në zbatimin e kritereve për të plotësuar kërkesat e shumta shëndetësore të semurëve dhe të subjekteve të shëndosha, të cilët po i përshtaten ndryshimit të skenareve të jetës së sotme tepër intensive dhe të rrëmujshme, që kanë ndikuar dhe në transformimin e menyres të menduarit.

Sot, mjekësia shqiptare po konfrontohet dhe me koncepte, që rrjedhin nga studimet në fushën e ekonomisë sanitare, për sigurimin e burimeve financiare në mbështetje të shërbimit shëndetësor, por dhe në vlerësimin e raportit kosto-perfitim të mjekimeve terapeutike, të teknikave e metodave diagnostike dhe aplikimit të ndërhyrjeve kirurgjikale sa më efektive. Ritmet e shpejta dhe nivelet e larta të zhvillimit të mjekësisë, kanë revizionuar e zgjeruar fushën e veprimtari dhe mënyrën e ndërhyrjes të mjekut, duke përfshirë në trajtimin e sëmundjeve ndikimin e kushteve mjedisore, stilin e jetës, gjëndjen sociale të pacientit, respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore për mirëqenie shëndetësore të popullatës.

Këto aspekte organizative dhe profesionale të shërbimit shëndetësor, nuk mund të kuptohen pa zhvillimin e kërkimeve shkencore, sepse mjekësia nuk është thjeshtë profesion, por është shkencë, është art, kulturë dhe mision i lartë humanitar dedikuar shërimit të jetës të lënduar nga sëmundjet. Në këto vite fillimi të mijvjeçarit të tretë, shkencat



mjekësore shqiptare ka intensifikuar dhe zgjeruar studimet shkencore rreth problemeve themelore në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe mjekësor. Shërbimi shëndetësor publik dhe ai privat, krahas impjemeve për parandalimin, diagnostikimin dhe kurimin e sëmundjeve, i janë përkushtuar studimeve shkencore, duke kontribuar në rritjen e nivelit profesional të personelit mjekësor, ashtu si dhe në parandalimin, diagnostikimin e hershëm, mjekimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës të semurëve. Ndër institucionet shëndetësore në avantgardë në kujdesin mjekësor dhe në veprimtari shkencore, është Spitali Amerikan i Tiranës. Në politikën e zhvillimit të Spitalit Amerikan, krahas aktiviteteve mbështetëse të shëndetësisë publike, vend më rëndësi ka dhe veprimtaria kërkimore-shkencore e konkretizuar me rritjen e nivelit profesional të personelit mjek - infermjere dhe në perfeksionimin e cilësisë të shërbimeve mjekësore në mbrojtjen dhe shërimin e jetës të semurëve në Shqipëri dhe Kosovë. Franz Ribeko ka thënë: “Shkencat nuk është prona e askujt, ajo i përket të gjithëve”, andaj kjo eksperiencia profesionale dhe shkencore, nuk është kufizuar brenda mureve të Spitalit Amerikan, por është bërë publike, është përgjithësim në disa aktivitete shkencore, në veçanti me tre kongreset. Pas dy kongreseve të sukseshme të viteve 2015


dhe 2016, me 16 - 18 nëntor 2017, Spitali Amerikan, organizoi Kongresin e 3<sup>o</sup> të Mjekësisë, aktivitet shkencor multidisiplinor i fokusuar në inovacionet në mjekësi, si faktor më rëndësi në rritjen e nivelit organizativ dhe të kujdesit shëndetësor e mjekësor, për të semurët që trajtohen në sistemin e shtatë institucioneve mjekësore të Spitalit Amerikan.

Kongresi i 3<sup>o</sup> i zhvilloi punimet në Hotel Plaza, me pjesëmarrjen e 2000 mjekëve dhe infermjereve, nga institucionet shëndetësore të gjithë rrethëve të vendit dhe nga Kosova.

Në kongres morën pjesë dhe mbi 100 studiues të huaj nga Europa, Amerika dhe Azia.

Frekuentimi masiv, niveli organizativ, tematika e gjërë shkencore dhe pjesëmarrja e të huajve nga 23 vende të botës, janë tregues të përmasave dhe të nivelit ndërkombëtar të këtij kongresi. Në këtë aktivitet të rëndësishëm shkencor, studiuesit shqiptar dhe të huaj prezantuan 400 referate dhe posters, me një tematikë të gjërë dhe komplekse, të përqëndruar në zgjidhjen e problemeve të mjekësisë shqiptare si në parandalimin e sëmundjeve, diagnozën e herëshme, trajtimin terapeutik dhe kirurgjik të patologjive, që lëndojnë shëndetin e njerëzve. Këto rezultate u balafaqan me eksperiencën shkencore të vendeve të

(Vijon në faqen 24)



## ZHGËNJIMI

Nga KRISTAQ TURTULLI

*Apologjia e vërtetë e një pensionasti (fragment i shkëputur nga novela me të njëjtin titull).*

**P**ërse më dole përsëri përpara o Reshat Meçka. Shko ore tutje, qyteti ka boll trotuare ku mund të ndalosh makinën. Më vështrova me indiferentizëm nga lart poshtë, ngrite krahun, shtrova me madhësi ato pesë qime të lyera me bojë, në gisht të shkëlqen unaza e artë me gurin e çmuar vezullues të viktimave. Nuk të hyri asgjë gjemb në këmbë o Reshat Meçka. Kërceve si karkalec nga një magazinë në tjetrën, nga një shef kuadri në anëtar byroje. Në gërmadhën e vjetër të Naumit, tregtarit të pushkatuar ndërtova shtëpi elbasanase, me oborr të madh përpara dhe prapa. Me ndryshimin e sistemeve e ndërtova shtëpinë trekatëshe, i nxore takëmet e vjedhura të borgjezëve të dikurshëm, unazat dhe xhevahiret e fshehura dhe hape dyqanin e bizhuterive në qendër të qytetit...

Unë mbeta gdhë, ai që isha, djaloshi idealist plot ëndrra dhe dëshira të pambukta, që hëngra cillën e granatës në pritën e parë. Përballova dhimbjet e tmerrshme kur mu pre këmba me sharrë druri pa narkozë.

O Reshat Meçka, o qen i biri i qenit e kupton çfarë po ndodh me mua! Në çfarë luftë rraskapitëse jam me veten. Në këtë botë të flamosur nuk e di a ec apo zvarritem, por kaq di, që jam kokulur si dikur, kam qenë dhe mbetem i ndershem, me merakun e përhershëm të rrëzimit të papritur, duke hequr këmbën e drunjë zvarrë. E di ti o pushat, nuk mu ndanë asnjëherë radhët e gjata dhe, kur më mbaron pensioni marr bukë me listë, zvarritem si një breshkë e vjetër, tërheq pas vetes protezën e plasarit dhe të drunjtë. Ndërsa ti o Reshat Meçka nuk je njeri, por je lubi, oktapod, përbindësh, dreqi me brirë. Nuk e di, në jam naiv, i trashë nga mendja, i luajtur nga fiqiri, apo pleqëria dhe rrëgjimi i halleve më ka katandisur për ibret të zotit, në një thes të vjetër me byk e kashtë. Por përsëri ta them me bindje o Reshat Meçka që jam njeri. Ndoshta e mira e shumëvuajtura ime Anjeze e djali im Xhuvë kanë të drejtë dhe kjo kaploqja ime e shkretët nuk do të bindet, kam mbetur qytik, me mendime të prapambetura si më parë për: liri e demokraci të vërtetë. O Reshat Meçka me shokë që qysh në fillim tradhtuat idealin, gjakun e të rënëve, vodhët, u pasuruan brenda një nate, jeni më të keq se të këqijtë. Cilët kanë qenë dhe janë katilë dhe rezilë, ata që u munduat ti shfarosnit me zjarr e me hekur, apo jeni ju Reshat Meçka me shokë...?

# “Kongresi i Manastirit, ngjarje përcaktuese në rrugëtimin shqiptar “Një komb-një gjuhë”

Nga Valter MEMISHA

**H**istoria e një gjuhe është historia e popullit që e flet, shkruan patriarku i shqipes, Eqrem Çabej. Vetiu i drejtohej historisë së shqipes e të shqiptarëve, histori që ndërthet pafundësi ngjarjesh e ndër to gjen asosh që përqendrojnë përpjekjet e luftërave shekullore të popullit tonë dhe shërbejnë si gur shënues të rrugës në të cilën ka ecur e ai e gjuha jonë. E një nga këta gurë është Kongresi i Manastirit, të cilin e përgatitën dhe e realizuan rilindësit tanë të mëdhenj, ata që përpunuan ideologjinë kombëtare shqiptare e që hartuan programin kombëtar shqiptar, ata që veprën, madje edhe jetën, ia kushtuan shqiptarisë e Shqipërisë, ata që luftuan edhe për shkrimin e shqipes së ndaluar me ferman sulltanor për shekuj me radhë dhe, ndër të tjera, për të unifikuar këtë shkrim përmes hartimit të një alfabeti të vetëm.

Rruga për te ky kongres ka qenë e gjatë e qëndrore, e vështirë e heroike, me luftë të brezpasbrezshme e me humbje të pallogaritshme, por për fund, fituese. Fituese, sepse nuk u realizuan synimet e pushtuesit turk që sundoi me politika e metoda shfarosëse për 500 vjet, fituese sepse nuk u realizuan as synimet asimiluese e gllabëruese të fqinjëve jugorë e veriorë. Shenja e parë, e patjetërsueshme e fitores dhe e vitalitetit është ruajtja e gjuhës amtare, sepse po të ishte asimiluar ajo, edhe populli ynë do të kishte fatin e keq të mosekzistimit të mëtejshëm. Përpjekjet për shkrimin e shqipes dhe, natyrshëm dhe pazgjidhshëm me këtë, hartimi i një alfabeti të saj, mund të shihen në periudhën parakombëtare e në atë kombëtare të saj. Periudha e parë karakterizohet nga përdorimi i shumë alfabetesh dhe i shumë mënyrave të shkrimit. Me informacionin që kemi deri më sot, fillohet për një shkrim të organizuar e sistematik, zbrisin në shekullin XVI, kur botohet “Meshari” i Gjon Buzukut. Alfabeti i përdorur për këtë veprë është ai latin, por i stilit gotik, alfabet që përdorej në Italinë e Veriut, e kështu edhe në Venedik, ku u shtyp vepra. Gjithashtu për të realizuar shtypjen e veprës, për disa tinguj të veçantë të shqipes u përdorën edhe 5 shkronja nga alfabeti cirilik (Por siç thotë akademiku E. Çabej, “alfabeti i Mesharit karakterizohet nga polivalenca e mjaft grafive dhe poligrafia e mjaft tingujve”).

Me këtë alfabet, por më të stilizuar, në shekujt vijues, u shkruan edhe veprat e autorëve të tjerë të letërsisë së vjetër, si Budi, Bardhi e Bogdani apo vepra “Kuvendi i Arbrit (1706). Shekulli XVIII dhe fillimi i shekullit XIX shpërfaqin dy procese në rrugëtimin kombëtar: shpesh lëvruarit e shqipes u përpoqën ta zgjidhnin problemin e shkrimit, duke u mbështetur në alfabetet e gjuhëve të tjera: në atë latin, grek, turko-arab e sllav. Në anën tjetër, u krijuan disa alfabetet me tipare origjinale (veçojmë alfabetin e Dh. Todrit / Theodor Haxhiullipit, me 52 shkronja). Periudha kombëtare e shqipes që lidhet me Rilindjen, e çon në një stad tjetër procesin e shkrimit të saj. Pazgjidhshëm me forcimin e ndjenjës kombëtare dhe të luftës për autonomi e më tej për pavarësim të plotë, edhe në këtë periudhë vërehet një shumësi alfabetesh me dy pamje: alfabetet e hartuara nga përpjekjet vetjake të disa personaliteteve të shpikura, si dhe alfabetet e hartuara nga përpjekjet e organizuara të atdhetarëve, që synonin drejt një alfabeti të vetëm. Rol të madh luajnë në këtë mes shkrimtarët rilindës, për të cilët akademiku Rexhep Qosja shkruan se “prej fillimeve mendojnë se përpjekjet për shkrimin e gjuhës shqipe, për alfabetimin e saj, për shkollën e saj janë, së paku për një kohë, mjeti më efikas i luftës për pavarësinë kombëtare; ata mendojnë se çështja e gjuhës shqipe - e alfabetimit dhe e shkollës së saj - në të vërtetë është mjet më efikas i mobilizimit të vetëdijes dhe i krijimit të kohezionit kombëtar.” Ku ta kërkojmë a më saktë të ripojmë rëndësinë e Kongresit të Manastirit?

1. Kjo ngjarje lapidare, përcaktuese e vizionare, nuk është rastësore, nuk është pjellë e rrethanave çastore. Kongresi kurorëzon një rrugëtim dhjetëvjeçar që i kishte filluar e veta sidomos në vit ‘60 të shekullit XIX, me veprimtarë të shquar si K. Kristoforidhi, J. Vreto, Pashko Vasa, Ismail Qemali, Hasan Tahsini e të tjerë. Naum Veqilharxhi, më 1836 në Enqiklikën e tij, shkruante se “Sa kombe që kanë mbetur në padije, u ngjasin gjithnjë robëve, duke punuar nga ditë për fatbardhësinë e të qytetëruarve e të fuqishëmve; ata vetëm atëherë kanë për të dalë nga gjendja e bagëtishme ku gjenden, kur të nisnin të lërojnë gjuhën e tyre kombiare. Po kjo nuk fitohet ndryshe veçse me shkronja të veçanta kombiare që janë filluar para meje.”

Kurse Sami Frashëri 29-vjeçar, në “Alfabetare e gjuhës shqip”, më 1879, të shkruarit e gjuhës amtare e quante mjet të domosdoshëm për të shpëtuar qenien e shqiptarëve si komb: “Është për t’u çuditur qysh ka rrojtur gjer më sot kombi i shqiptarëve, duk me mos shkruar e duk me mos kënduar gjuhën e tyre... Komb’ i shqiptarëve, nga të mosshkruarit’ e gjuhës së vet, ka humburë gjer më sot më të shumë’ e njerëzet; po, në ka humburë aqë në kaqë mijë vjet, ata që kanë mbeturë do t’i humpnjenë në fort pakë kohë, se koh’ e sotme nukë ngjan me kohërat’ e vjetëra; sot kombetë piqen’ e përzejnë fort çpejt, edhe ata që janë më të fortë e

më të diturë, mundinë kurdoherë ata që janë të dobët’ e më të paditurë.” Sipas akademiku Sh. Demiraj ishte koha kur kishte dalë si detyrë e dorës së parë vendosja e një alfabeti të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe, gjë që kishte edhe rëndësi politike të dyfishtë. Mungesa e një alfabeti të përbashkët jo vetëm që ngjallte përçarjen, që shfrytëzohej nga armiqtë për të mbjellë e për të thelluar dasitë krahinore e fetare midis shqiptarëve, por ishte njëkohësisht edhe një pengesë e madhe për lëvizimin e gjuhës shqipe e, si rrjedhim, edhe për arsimimin



dhe zgjimin e popullit shqiptar”. Akademiku veçon vendimin e atdhetarëve shqiptarë, veçan atë të “Shoqërisë së shtypurit shkronja shqip” për të krijuar një alfabet të përbashkët, që njihet si “alfabeti i Stambollit” (1879), i cili të kishte “aq shkronja të thjeshta njëtrajtëshe sa tinguj të thjeshtë e të pandarë ka gjuha jonë shqipe”.

2. Pas Lidhjes së Prizrenit, Kongresi i Manastirit është i pari tubim i madh mbarekombëtar, “është i pari kongres shqiptar përfaqësimitar, në të cilën morën pjesë shqiptarë pa dallim feje e krahine, që përfaqësonin shumicën e trojeve shqiptare dhe kolonitë shqiptare kryesore. Në Kongres përmes 50 delegatëve (me të drejtë vote vetëm 32 prej tyre) u përfaqësuan klubet e shoqëritë kulturore të Manastirit, Korçës, Elbasanit, Shkodrës, Tiranës, Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Beratit, Starovës, Leskovikut, Kolonjës, Shkupit, Selanikut, Janinës, kolonitë e shqiptarëve të SHBA, të Bukureshtit, e Kostancës, të Sofjes, e Filipopolit, të Egjiptit, të arabëreshëve të Italisë etj.”

3. Në Kongres u shtrua domosdoshmëria e një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët, mungesa e të cilit ishte bërë shumë shqetësuese, jo vetëm për shkrimin e shqipes, por ishte bërë pengesë në vetë procesin e formësimit kombëtar. Alfabeti i Stambollit nuk mundi të bëhej alfabeti i vetëm për shkrimin e shqipes, ai u përdor kryesisht në Jug dhe në disa koloni shqiptare në emigracion. Në Veri, fjala vjen në Shkodër ku përdorej alfabeti tradicional i shkrimtarëve të Veriut, u krijuan edhe dy alfabetet të tjera mbi bazën e alfabetit latin - alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” më 1899 dhe ai i shoqërisë “Agimi” më 1901, por përdorej edhe alfabeti arab. Kështu, në një qytet të vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe përdoreshin katër alfabetet në ndryshme. Në Kongres u paraqitën tri alfabetet: Alfabeti i Stambollit, i Shoqërisë Agimi dhe i Shoqërisë Bashkimi. Dihet tashmë se puna për alfabetin nisi me tri mundësi: të pranohej njëri nga tri alfabetet kryesore që përdoreshin, me ose pa ndonjë ndryshim; të formohej një alfabet me elemente të tri sistemeve, duke i shkruar këto tri alfabetet; të krijohej një alfabet krejt i ri. Dhe “Komisioni vendosi të krijojë një alfabet të ri duke marrë një për një tingujt e shqipes për të caktuar mbi kriteret të drejta shkencore e në përshatje sa më të saktë me gjuhën shqipe, gjerat dhe mënyrat sesi do të shënoheshin ato.”

4. Zgjidhja me dy alfabetet që bëri Kongresi, duket pragmatiste por u bë tregues i dukurisë së çështjet që lidheshin me përbashkimin kombëtar, nuk mundi të zgjidheshin brenda pak ditësh. Megjithatë, Kongresi e orientoi përparësinë. Në vendimin e Komisionit, të 20 nëntorit 1908, thuhet: “Pas që u kënduan verbalet e ditëve të tjera e pas që e pamë se puna që kishim bërë, ishte mjaft e madhe, po jo aqë sa të na kënaqte të gjithëve e t’i shërbente si përparimit të gjuhës, si të përhapurit të diturisë ndër ne; të shtyrë edhe nga disa shkakë të përjashtme, u kthyem prapa e me pëlqim të të gjithëve u vendos që të mirret Abeja e Stambollit e me të bashkë edhe një Abece fjesht latine, që të mësohen e të përdoren bashkarisht në mes të Shqiptarëve. Mësimi ndë shkolla do të jetë i shtrënguar e i detyrshëm për të dyja.”

Por siç thotë akademiku M. Domi, jeta e zgjidhi përfundimisht problemin pa pasur nevojë për mbledhje, komisione e vendime, duke lënë në përdorim një alfabet të vetëm. Alfabeti latin i papërzjerë, i përpunuar nga Kongresi, kishte të mirën se ishte homogjen për nga karakteri i germave, i lehtë në të shkruar dhe mjaft i volitshëm në shtyp, se nuk kërkonte shtypshkronja me germa të posaçme, prandaj mund të bëhen botime me të një çdo vend. Kjo që arsyeya kryesore që më pas, sidomos pas vitit 1912, alfabeti i Stambollit mbeti në një

përdorim gjithnjë e më të kufizuar. Nga fundi i luftës së parë botërore, alfabeti thjesht latin i Kongresit të Manastirit ishte alfabeti i përbashkët i gjithë shqiptarëve, alfabeti i vetëm i shqipes. Është alfabeti i sotëm i gjuhës sonë.” Ky alfabet do të tregonte vlerat e veta në shkrimin e shqipes e përhapjen e arsimit e të diturisë në mbarë trojet shqiptare.

5. Alfabeti i sotëm latin i Manastirit, nuk ishte rezultat i kompromiseve pa kriter, ai ka bërë zgjidhje që tregonin pjekurinë që kishte arritur jo vetëm mendimi kombëtar,

por dhe ai shkencor në atë kohë, çka mundësonite gjithë sipërmarrjet e mëtejshme në proceset arsimore e diturore në shtetin e ardhshëm shqiptar. Mjafton të përmendim këtu zgjidhje për vetëqëndrueshmërinë e çdo shkronje, d.m.th, që në të shkruar asnjë shkronjë nuk ndikohet nga rrethimi fonetik, sidomos nga shkronjat ndjekëse (ndryshe nga alfabeti i italishtes, i greqishtes etj., ku fjala vjen c -ja lexohet herë k e herë s, g herë g e herë gj etj). sipas akademikut M. Domi, në alfabetin e ri “janë të pakta inkosekuencat e diagrameve të zgjedhura, sepse nuk janë të rëndomta rastet e fjalëve ku takohen tingujt e shënuar prej germave përbërëse të tyre (t-h, d-h, g-j, s-h, z-h), ose nuk ndeshen fare në gjuhën letrare (x-h). Bën përjashtim vetëm nj”, por problemet që nxjerr kjo janë zgjidhur nga Kongresi i drejtshkrimit 1972.

6. Kongresi i Manastirit ka peshë e rol të pazëvendësueshëm për historinë e gjuhës letrare në njëkohësi. Ai mbylli rrugëtimin e gjatë disa shekullor të alfabetëve të shqipes, afroi shumë dy variantet e saj letrare, orientoi për zgjidhje në fushën ortografisë (dihet se ai u shpreh për një kongres tjetër pas dy vjetësh “për ortografi e literaturë të shqipes”). Ai çeli rrugën për Komisionin letrare, e cila vetëm 8 vjet më pas bëri një punë të vlerësuar për njësimin e drejtshkrimit, duke ecur në vizionin e Rilindjes që shkrimi t’i shërbente ngultijes sa më të qartë të strukturës së fjalës dhe mbi këtë bazë të ruhej sa më shumë e përbashkëta, ajo që i afroonte dialektet dhe jo ajo që i dallonte dhe i largonte. Kongresi kështu, shfaqet jo vetëm si gurë shënues në rrugëtimin tonë historik, por me vendimet për përbashkim kombëtar, edhe përmes shkrimit të shqipes me një alfabet të përbash-

kët, por është hapi i parë i madh solid e përcaktues, në rrugëtimin drejt Kongresit të Drejtshkrimit, 1972, i cili, me moton lapidare të Ali Hadrit Një komb - një gjuhë letrare e njësuar, realizoi ëndrrën e shqiptarëve dhe kurorëzoi përpjekjet e brezave për të pasur një gjuhë të përbashkët, atë që sot quhet shqipe standarde.

7. Kongresi i Manastirit është gur shënues, jo vetëm për shkrimin e unifikuar të shqipes, por edhe për historinë e kulturës kombëtare dhe për vetë historinë politike të Shqipërisë. Ai nuk ishte thjesht kongresi i alfabetit, i Abesë. Pjesëmarrja përfaqësimitare në të dhe mënyra se si i zhvilloi ai punimet edhe pse u shprehën mendime të ndryshme, treguan se populli shqiptar ishte gati të hidhte hapin e madh, atë të luftës për shpalljen e pavarësisë. Nga lëvizja “Me pushkë e penë për mëmëdhenë”, po kalohej në kryengritjen mbarekombëtare “Ja të vdesim, ja të rrojmë për liri!”, e cila u kurorëzua më 28 nëntor 1912

8. Kongresi ka meritën e jashtëzakonshme se e orientoi Shqipërinë dhe kombin tonë nga perëndimi, andej nga lindte dielli për rilindësin e madhe Naim Frashëri. Vetë orientimi për shkrimin e shqipes me alfabetin latin, tregoi edhe një herë se “Shqipëria është një copë vënt nga Evropa dhe shqiptarët janë një nga kombet’ e Evropësë...”

9. Kongresi i Manastirit i tregoi botës se shqiptarët ishin një komb dhe kishin një gjuhë, e cila i identifikonte dhe i bashkonte ata, i bënte ata të ecnin në rrugën mijëvjeçare të ilirësisë e të shqiptarisë. Por vetëm 6 muaj pas shpalljes së Pavarësisë, Shqipëria e shqiptarët copëtohen nga Fuqitë e Mëdha në 6 shtete, kjo me pasojë të pariparueshme edhe pas 100 e ca vjetësh. Pasojat i ndjeu drejtpërdrejt shqippja, e cila sot është e vetnaja gjuhë në Ballkan e në Evropë që del me disa statute. Përfitoj të shprehem besimmadh e shpresëplotë se vitin tjetër, në 110 vjetorin e Kongresit të Manastirit, këtu në Republikën e Maqedonisë të jetë jetësuar plotësisht Marrëveshja e Ohrit. Të nderuar pjesëmarrës, Kongresi i Manastirit na kujton dhe një herë se të gjithë së bashku, pa dallime shtetërore, tërësisht të detyrueshëm si bashkëkombës, të punojmë pandashëm për të ngritur prestigjin kombëtar e ndërkombëtar të shqipes amë, ta vitalizojmë e ta latojmë atë, ta pastrojmë e ta pasurojmë, ta funksionalizojmë më tej e t’ia shpalosim aftësitë shënuese e krijuese, ta bëjmë të qëndrojnë e dinjitetshme krahu simotrave të veta me shkallë të lartë përpunimi e standardizimi, duke realizuar ëndrrën rilindëse dhe vetë përpjekjet e synimet e këtij Kongresi.

## ESSE



# Guri i vendlindjes

Nga XHEVAHIR CIRONGU

**U**dhëtoj drejt vendlindjes sime....pafundësi shikme!... Ja drita e diellit që lind çdo ditë mbi malin e bekuar, Tomorrit kryelart! Mirmëngjes i thotë tokës tonë arbërore dhe përhap rrezet e arta diellore deri në çdo cep të saj. Sa bukur, - them me veten! Ja, Tomorri ynë i cili mbjell mirësitë në tokën shqiptare për shqiptarët, por...ky mal i shenjtërimin udhëton drejt kontinenteve e jep kushtrimin e jetës të mbarë njerëzimit. Aty merr udhë e jetë gjithësisë....pra, mali i Perëndisë, apo siç i thonë me pagëzimin e fjalës aq magjike “Baba Tomorri!” . Yjet zbresin nga kupa qiellore e ulen në sofrën e shpirtit tonë. Vezullime dritash të kristalta të cilat na japin oksigjenin e jetës. Sërisht vështroj malin mitik Tomorrin! Jam larg, e sytë më lotojnë. Thellë në shpirtin tonë, ai lot prek telat e zhuritur të atij mali për vendlindjen tonë Shqipëri. Vajtonë zogjtë, sa edhe pranvera u duket dimër me borë e ngjica. Pse kështu? E preka me shumë mall atë gur të bardhë tomorri këtu në migrim, por edhe në emigrim. E ndjeva peshën e dhimbjes, plagën e atij guri, por edhe thirrjen e tij dashamirëse ta puthje gurin e vendlindjes, gurët e tokës arbërore! Më qortoi duke më thënë: “Bijtë e mij, ejani pranë meje, se tek vendlindja jonë është pjalmi i jetës sonë. Lulet e gurit janë dritjete! Sakaq, ky zë i mistershëm më kumboi fuqishëm deri në skutat e shpirti. Vullkane zjarri m’u ndezën në trupin tim!” . Poetja emigrante Vjollca Koni Ajasllari, në vergjet poetike për vendlindjen jep mesazhe dhimbje me plag malli, e cila e ndjen në gjithë qënien e saj.

“Më prit të shoh majën e Tomorrit / Me qylafin - dimër e verë borë të bardhë, / Të hedh sytë mbi Korçë, Gramsh, Skrapar / Mbi krejt Shqipërinë si Frashëri në vakt”.

...Veç bulza gjaku të vendlindjes sonë aq vlerësuese edhe nga të huajt, sepse aty rreh fort puls i jetës sonë, pavarsisht se ku e kemi ngritur strehën nëpër migrim apo emigrim....Oh! Ja, ajo plagë e shpirtit qan në çdo skut e qelizë nëpër trupin tonë e cila thërret: “Vendlindje, ku Je! Edhe ju o dashamirës, bijtë e mi ejani këtu! Dhe..... (autor Xh. Cirongu, “Kënga e lotit” shkruan:)

“Malli i vendlindjes / Qënka zhur e prush, / Ajo këngë e bukur / Gjoksin plot ta mbush”.

...vazhdon te poezia me titull “Guri i vendlindjes” të shkëputur nga vëllimi me titull “Kënga e Lotit” (autor Xhevahir Cirongu) me këto vergje:

“ Mbi kreshën e malit dielli derdh rreze të artë / Vesën e mëngjesit than fushës së Myzeqesë e Elbasan; / Të heshtura shtëpitë vështrojnë Tomorrin plakë / Guri i vendlindjes nën jastëk mallin mban”.

Tek ata gurë të bardhë të vendlindjes, lexova lehtë bardhësinë shpirtërore, por edhe këngën e Jetës!

# KONGRESI 3° NDËRKOMBËTAR I MJEKËSISË, AKTIVITET SHKENCOR MULTIDISIPLINOR I SPITALIT AMERIKAN

(Vijon nga faqja 22)

tjera. Konkluzionet, propozimet dhe idetë e reja që dhanë referuesit, hapen perspektiva të reja aplikative të mjekësisë bashkëkohore, shërbyen si eksperiencë për të rritur nivelin shkencor të punës në institucionet shëndetësore të vendit tonë.

Shumë personalitete të huaj si Philip Çaushaj (USA), N. E Samalavicius (Lituani), Ho Kyung Chun (Koreja e Jugut), Felice Giangaspero (Itali), Friedrich Ecstein (Gjermani), Giuseppe Marcianno (Itali), Christos Maroudis (Greqi), Jozeph Mensah (Angli), Niklas Zojer (Austri), Antonio Gomez (Spanja), Witney Feltus (USA), K. Yohej (Japan), Sadik Ersoz (Turqi) etj, pa rezerva e pa komplekse theksuan: "Organizimi dhe përmbajtja shkencore e referimeve, janë te nivelit nderkombetar. Ky është kongresi mjekësor i njëjtë me ato që zhvillohen në vendet e tjera të botës, madje në disa aspekte më i bukur".

Përgatitjet për kongresin filluan në muajin shkurt 2017, me ngritjen e strukturave organizative:

- Komiteti organizativ, i kryesuar nga Dr Klodian Allajbeu, drejtori ekzekutiv i Spitalëve Amerikane.
- Komiteti shkencor i kryesuar nga Dr Lindita Shosha, drejtore e strategjisë akademike dhe e edukimit mjekësor te Spitalit Amerikan,

- Sekretaria ekzekutive e kryesuar nga Albana Mehmeti. Tre stafet organizative, shkencore dhe ekzekutive, vepruan ne unitet e të bashkëkoordinuar, duke i konkretizuar punën e tyre intensive, ne realizimin me sukses të këtij aktiviteti të madh shkencor.

Kongresi i 3° i filloi punimet pasditen e 16 nentorit, me ceremoninë mirëseardhjes.

Fjalën e hapjes e mbajti presidentia e kongresit të 3°, Dr Lindita Shosha Mano, e cila i përshëndeti pjesëmarrësit me një fjalim te bukur, sintetik, elegante e plot me emocione.

Pjesëmarrësit në kongres i përshëndeti dhe Ministria e Shëndetësisë Zonja Ogerta Manastirliu, e cila krahas evidentimit të arritjeve të shëndetësisë shqiptare, theksoi sukseset e Spitalit Amerikan në kujdesin mjekësor dhe në veprimtaritë kërkimore – shkencore.

Në vazhdim të traditës të kongreseve pararendëse, Dr Lindita Shosha shpalli vendimin e komitetit organizativ dhe të komitetit shkencor, per dhienien e çmimit "Award of excellence" për kontributet në veprimtari profesionale dhe kërkimore-shkencore te studiuesve: Prof. Kenan Arnautović (USA), Prof. Lutfi Alia (Itali), Prof. Sulejman Cela (USA), Prof. Jera Kruja e Prof. Mentor Petrela (Shqipëri).

## SEANCA PLENARE

Gjate kongresit te 3° u zhvilluan 27 aktivitete shkencore, te mirëprogramuara, te organizuara ne sesione, workshope, simposiume, forume, summit-e dhe "tavalinë e rrumbullakët", ku pjesëmarrësit trajtuan problemet kryesore të mjekësisë shqiptare.

- Sesiioni plenar trajtoi "Inovacionet në mjekësi".

- 16 sesione shkencore iu përkushtuan prezantimit të rezultateve të studimeve në fushat kryesore të mjekësisë si në kirurgji të përgjithshme dhe specialitike, kardiologji, nefrologji-urologji, në okulistikë, patologjia e qafës dhe maksillofaciale, obstetrikë-gjinekologji, kujdesi shëndetësor i të porsalindurit; hematologji, hepatologji, gastroenterologji, neurologji-neurokirurgji, parandalimi diagnoza e herëshme e sëmundjeve të brendshme, imazheria, mjekësia nukleare, laboratorët, anesteziologjia, onkologjia, morfologjia, reumatologjia, endokrinologjia, pneumologjia etj.

- 2 simposiume iu dedikuan kancerit të gjurit dhe trajtimit të patologjive të vijave urinare.

- 3 workshope trajtuan problemet themelore në fushat e dermatologjisë, nutricionit dhe simulimit të traumave.

- 2 forume u mbajtën për cilësinë e kujdesit infermieristik.

- 1 summit per problematiken komplekse kolo-rektale.

- Tavolina e rrumbullakët, iu dedikua përgatitjes profesionale të studenteve të mjekësisë. Punimet e këtyre aktiviteteve shkencore, u moderuan nga studiues shqiptarë dhe të huaj, madje theksoj me krenari se drejtuesit (Key lecture) në shumicën e aktiviteteve të kongresit, ishin mjekë shqiptarë, që i drejtuan seancat dhe diskutimet, me profesionalitet të admirueshëm, komunikuan me auditorin si në gjuhë shqipe ashtu dhe në anglisht, frengjisht dhe italisht. Në sesiionin plenar "Inovacionet në mjekësi" [moderator: Prof Ph. Çaushaj (USA), K. Allajbeu (Al), K. Arnautović (USA), L. Shosha (Al)], u trajtuan risit dhe perspektivat e kirurgjisë se transplantit të organeve, të kirurgjisë robotike, të mjekimit me qeliza staminale dhe mikrokirurgjia në trajtimin e neoplazive të kokës dhe të fytyrës. Në sesiionin e imazherisë të avancuar [moderator Prof A. Carriero (It), I. Allajbeu (Al), W. Feltus (USA)], u prezantuan rezultatet në



Dr Klodian Allajbeu, president i komitetit organizues të kongresit, Dr Lindita Shosha Mano, presidente e kongresit, Dr Alfred Aga, zv-president i kongresit, Dr Fatos Ollashi, sekretar i përgjithshëm i kongresit.

diagnostikimin dhe studimin e shumë proceseve patolojike me teknikat e PET – MRI, RMn, me ekografi dhe shintigrafi. Referuesit theksuan se Shqipëria ka të domozdoshme instalimin e PET – MRI, teknikë bashkëkohore, me efektivitet të lartë për diagnozën e sëmundjeve në veçanti për zbulimin e metastazave në permasa të vogla, që nuk shihen në ekografi.

Gjatë summit-it dedikuar patologjisë kolorektale [moderator: Prof Ph. Çaushaj (USA), J. Nunoo (UK), E. Samalavicius (Lit), L. Shosha (Al)], u prezantuan studime të viteve të fundit, që evidencuan përparësitë e teknikave racionale të laparoskopisë, rezultatet në trajtimin kirurgjikal te divertikujve dhe të neoplazive të këtij segmenti të traktit të tretjes. Në symposium-in për kancerin e gjirit [moderator: E. Mema (USA), I. Allajbeu (Al), E. Huti (Al)], u prezantuan rezultatet në diagnostikimin imazherik, duke evidencuar rëndësinë e zbulimit në stadet më të herëshme të neoplazive të gjurit dhe rezultatet në trajtimin me radioterapi. Në sesiionin e Neurokirurgjisë [moderator: K. Arnautović (USA), M. Petrela (Al), F. Ollashi (Al)], u prezantua klasifikimi i vitit 2016 i OBSH i neoplazive të trurit i bazuar në histopatologji, u referuan studime, që evidencojnë efektivitetin e nderhyrjeve kirurgjikale në patologji vaskulare dhe neoplazi të trurit. Me interes ishin referimet lidhur me trajtimin kirurgjikal të epilepsisë. Në sesiionin Kirurgjia e Përgjithshme [moderator: A. Catona (It), S. Lacitignola (It), L. Alia (It) dhe Teona Bushati (Al)], ishte ndër sesiionet më të ngjeshur me referime dhe tematikë të larmishme, por dhe tribuna ku shume mjekë të rinj referuan me dinjitet profesional e shkencor.

Prof A. Beqiri, në referimin e tij na dhuroi nje fakt ri për historine e mjekësisë sone. Operacionin e parë të hernies inguinale në Perandorine turke e ka kryer nje kirurg shqiptar në shekullin XIX. Në sesiionin patologjite e kokës – qafës dhe maksillofaciale [moderator: Alfred Aga (Al), K. Yohej (Japan), F. Laganà (It), A. Shahini (Al)], u referuan 10 studime shkencore, që prezantuan rezultatet në nderhyrjet delikate e preçeje në ngushtesine e kaviteteteve dhe te organeve të vogla, të grykës dhe të rajonit maksillo-faciale.

Në sesiionin kardiologji dhe kardiokirurgji 1 [moderator: F. Eckstein (Ger), J. Besik (Çek), B. Kojcic (Kos) dhe E. Priifti (Al)], u referuan studime, që pasqyrojnë inovacionet në metodat e trajtimit të sëmundjeve të zemrës, si dhe të nderhyrjeve kirurgjikale në zemer dhe në vazat e mëdha të gjakut. Në sesiionin paralel kardiologji & kardiokirurgji 2 [moderator A. Kojciqi (Al), S. Celaj (USA), A. Nona (Al), C. Campa-nella (It)], u prezantuan punime shkencore, të realizuara ne klinikat tona dhe të vendeve të tjera, ku janë trajtuar të shumë të sëmundjeve të zemrës. Në sesiionin e ortopedisë & kirurgjisë plastike [moderator: Gj. Çausi (Al), Gj. Belba (Al), C. Bytyqi (Kos), G. Bassi (It)], referuesit prezantuan rezultatet e metodave të reja kurative dhe të ndërhyrjeve kirurgjikale inovative në ortopedi. Në kete sesiion u referuan rezultatet e disa teknikave të kirurgjisë plastike në Shqipëri dhe

në Kosovë. Sekretaria e regjistrimit të infermjereve dhe studenteve.

Pasditen e 17 nëntorit, u organizua "Tavolina e rrumbullakët", një bashkëbisedim me studentët e mjekësisë dhe infermjerisë [moderator: Ph. Çaushaj (USA), K. Allajbeu (Al), Th. Caputo (USA)]. Përgatitja profesionale dhe shkencore e studentëve në fakultetet e mjekësisë, mbështetet në një varg disiplinash, që i ofrojnë mjekëve dhe infermjereve të ardhshme njohuri bazë profesionale, por dhe artin e shkencën për te mbrojtur e forcuar shëndetin e njeriut. Pra, te behesh dhe te punosh mjek dhe infermier në mjekësi-veçarini e trete, do te thote te kesh formim baze profesionale dhe nivel shkencor. Studimi i mjekësisë nuk mbaron me marrjen e diplomës, por vazhdon gjatë tërë jetës profesionale. Prof William Osler, i këshillonte mjekët e sapo diplomuar, me një sentencë, që tingëlton aktuale dhe në realitetin e sotëm: Të dashur kolege! Krahas urimeve për diplomën dhe sukseseve në profesion, duhet t'i u jap dhe dy lajme: një të mirë e një të keq. Lajmi i mirë është: brenda një dhjetëvjeçari pune, gjysma e atyre që keni mësuar do t'i harroni. Lajmi i keq është: askush nuk do të jetë ne gjendje të vlerësojë sa do të jetë kjo gjysëm".

Këtë profeci të Sir William Osler, sot e shohim të konkretizuar me nivelin, që kanë arrit shkencat mjekësore, që i kanë rritur shumëllojshmëri konceptet të mekanizmave etiopatogenetikë dhe të mjekimit të shumë sëmundjeve.

Në sesiionin e anesteziologjisë [moderator: S. Beqiri (Ger), B. Arapi (Al), A. Abdyl (Al)], u prezantuan studime, që evidencuan përparësitë e teknikave bashkëkohore të anesteziës, të konkretizuara me eksperiencën në klinikat shqiptare. Në sesiionin gjinekologji & obstetrikë [moderator: Th Caputo (USA), G. Pisto-fidis (Gre), Z. Delia (Al), G. Gok (Tur), E. Peçi (Al)], referuesit prezantuan studime, për diagnostikimin e hershëm dhe kurimin e disa sëmundjeve, që lëndojnë shëndetin e grave, me ndikim në fertilitet dhe në shtatzani. Në sesiionin gjinekologji & obstetrikë dhe neonatologji [moderator: Th Caputo (USA), A. Antsaklis (Gre), Ch. Maroudis (Gre), L. Berdica (Al)], u trajtuan disa sëmundje të mitrës dhe të vezoreve, me ndikim në zhvillimin e fetusit dhe lindjen e femijës, si dhe trajtimi kirurgjikal i disa keqformimeve kongjenitale të femijeve të porsalindur.

Në sesiionin e sëmundjeve të brendshme 1 [moderator: B. Zllami (Al), J. Kruja (Al), Chiribelli (It) G. Marcianno (It)], u trajtua një tematikë e gjërë problemesh me interes në praktiken mjekësore, çka u karakterizua me pjesëmarrje të gjërë mjekësh nga Shqipëria dhe Kosova. U prezantuan të dhenat e reja mbi klasifikimin e epilepsive, metoda ROSE e bronkoskopisë për diagnozën e shpejtë të sëmundjeve të mushkërive, trajtimi bashkëkohor i vaskulitit i shoqëruar me antitruapat ANCA, përvoja në përdorimin nga goja të antikoagulantëve, një rast me melanoma e stomakut, screening i tiroides etj. Në sesiionin e sëmundjeve të brendshme 2 [modera-

tor: P. Marchetti (It), M. Mondelli (It)], E. Puca (Al), A. Ylli (Al)], u prezantuan referate shkencore me rezultatet në mjekimin e hepatitit C, disa punime rreth diabetit të sheqerit te tipit 2, për sëmundjet imunitare, për infarktën e trurit etj.

Në sesiionin e okulistikës [moderator: U. De Sanctis (It), M. Jacobbi (It)], T. Haveri (Al), N. Bardhi (Al)], u prezantuan rezultatet në transplantin e kornesë, ne trajtimin e disa sëmundjeve që lëndojnë retinën dhe të disa neoplazive të syrit etj. Në symposium-in "zhvillimet në urologji" [moderator: F. Daneshgari USA], u prezantuan referime shkencore nga studiues amerikanë dhe anglezë. Pjesëmarrësit ndoqen me interes të dhënat e reja në fushën e urologjisë, kriteret në trajtimin e infeksioneve urinare dhe aplikimin e kirurgjisë robotike në patologjitë joneoplazike të traktit urinar. Në sesiionin nefrologji – urologji [moderator: L. Alia (It), Sh. Telegrafi (USA)], Xh. Çuni (Kos), A. Strakosha (Al), F. Tartari (Al)], u prezantuan studime, që evidencuan risit në diagnozën e herëshme të sëmundjeve të traktit urinar, trajtimin e infeksioneve të vijave urinare, të neoplazive të prostatës, rezultatet inkurajuese të transplantit të veshkave, si dhe trajtimin e ndërlikimeve të sëmundjeve renale dhe të vijave urinare. Forumi i kujdesit infermieristik 1 [moderator: N. Xhabija (Al), S. Nela (UK)], E. Çako (Al)] dhe Forumi i kujdesit infermieristik 2 [moderator: B. Zllami (Al), E. Çako (Al)], u karakterizuan me pjesëmarrje të gjërë dhe me interesim të madh nga personeli infermier dhe operatorët sanitar. Me shumë të drejte, komiteti organizativ dhe komiteti shkencor, programuan këto dy aktivitete shkencore me infermjeret, sepse në ditët e sotme është rritur koncepti dhe roli i infermjereve ne sherbimet e kujdesese shëndetësore dhe mjekësore.

## SESIONI I SHKENCAVE INFERMIJERISTIKE

Profesioni universal i infermjerit, shumë i respektuar dhe i nderuar nga te gjithë, historikisht është parë si mision humanitar në sherbim te individit dhe te kolektivit, i ushtruar me art, kulturë dhe shkencë për të sëmurët e shtruar në spitale dhe jasht spitalëve, gjithmonë pranë dhe në ndihmë të atyre që vuajnë nga sëmundjet. Infermjeret, në kryerjen e kujdesit infermieror, aplikojnë kapacitetin profesional, formimin kulturor dhe ndjeshmerinë shpirtërore, duke i vënë në sherbim të atyre që kanë nevojë për ndihmë jo vetëm mjekësore por edhe shpirtërore, psikologjike dhe morale. Sa më të përgatitura profesionalisht dhe shkencërisht të jenë infermjeret, aq më i kualifikuar dhe rezultativ është shërbimi, aq me te medha jane perfitimet mjekësore ne institucionet spitalore dhe ambulatore, ashtu si dhe perfitimet shëndetësore, shpirtërore e morale per te semurin. Roli i mjekut është i rendesishem ne diagnozen dhe kurimin e te semurit, por sukcesi i punes se tij varet nga aktiviteti profesional i infermjereve.

Keto vlera e dimensione te profesionit infermieror, shtrijne si detyre, që infermjeri te vihete ne vendin dhe ne funksionin qe i takon, jo vetem ne sherbimin shëndetësor, por gjeresisht ne shoqëri. Kush pati fatin t'i ndiqte referimet e infermjereve në këto dy forume, sigurisht do të entuziazmohej me aktivitetin profesional që kryejnë dhe me nivelin shkencor të punes, të prezantuar me elegancë dhe me modesti në këto dy aktivitete shkencore. Gjatë ditëve të kongresit, u organizuan dhe tre workshope, aktivitete shkencore të preferuara si për tematikën e fokusuar në problematikë të ngushtë, ashtu dhe për mundësitë e pjesëmarrjes ne diskime dhe ne shkëmbimin e eksperiencës klinike dhe shkencore. Në Workshopin e dermatologjisë, [moderator: Antonio Ortega Gomez (Al), Irena S. Jorgaçi (Al)], u bashkëbisedua rreth aritjeve të mjekësisë estetike në vendim tonë.

Në Workshopin dedikuar simulimit te traumes [moderator: S. Nela (UK), Ch. Downing (UK)], u referua dhe u bashkëbisedua për mënyrat e menaxhimit të pacientit te traumatizuar, nga nje ekip multidisciplinar, duke perdorur kriteret e standartizuara, të cilat u praktikuan direkt në auditor. Në Workshopin dedikuar nutricionit [moderator: A. Daka (Al), C. Rizzo (It)], u trajtuan aspektet themelore të ushqyeshmërisë gjate shtatzanise, çrregullimet e metabolizmit te kriprave minerale gjate autizmit etj. Merita në organizimin dhe zhvillimin e punimeve të kongresit, i takojnë dhe sekretarisë te drejtuar nga Albana Mehmeti dhe stafit operativ të hosteve, një grup vajzash të sjellëshme e të kulturuar, që të impononin respekt e nderim për aftësitë e tyre të admirueshme. Në pasditen e 18 nëntorit, u zhvillua ceremonia e mbylljes me sukses të punimeve të Kongresit të 3° Ndërkombëtar të Mjekësisë, aktivitet shkencor multidisiplinor i organizuar nga Spitali Amerikan – Tiranë dhe njëkohësisht u njoftuan pjesëmarrësit, per organizimin e Kongresit 4° vitin e ardhshëm.